



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 130

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 29 korrik 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 67/2024, datë 4.7.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar..... 15949
Dekret i Presidentit nr. 258, datë 24.7.2024	Për shpallje ligji..... 15950
Ligj nr. 69/2024, datë 4.7.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar..... 15950
Dekret i Presidentit nr. 259, datë 24.7.2024	Për shpallje ligji..... 15950
Ligj nr. 70/2024, datë 4.7.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar..... 15951
Dekret i Presidentit nr. 260, datë 24.7.2024	Për shpallje ligji..... 15955
Rezolutë e Kuvendit datë 25.7.2024	Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2023..... 15956
Rezolutë e Kuvendit datë 25.7.2024	Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2023..... 15957
Rezolutë e Kuvendit datë 25.7.2024	Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2023..... 15959
Rezolutë e Kuvendit datë 25.7.2024	Për vlerësimin e veprimtarisë së Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2023..... 15960
Rezolutë e Kuvendit datë 25.7.2024	Për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2023..... 15961

Rezolutë e Kuvendit datë 25.7.2024	Për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2023.....	15962
Rezolutë e Kuvendit datë 25.7.2024	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2023.....	15964
Rezolutë e Kuvendit datë 25.7.2024	Për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2023.....	15965
Rezolutë e Kuvendit datë 25.7.2024	Për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Statistikave për vitin 2023...	15967
Rezolutë e Kuvendit datë 25.7.2024	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2023.....	15969
Rezolutë e Kuvendit datë 25.7.2024	Për vlerësimin e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë për vitin 2023.....	15970
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 479, datë 24.7.2024	Për miratimin e dokumentit të metodologjisë dhe standardet teknike për përdorimin e inteligjencës artificiale në Republikën e Shqipërisë.....	15973
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 554, datë 22.7.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pestës së ruminantëve të vegjël të shfaqur në shtetin e Greqisë.....	15985
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 555, datë 22.7.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pestës së ruminantëve të vegjël të shfaqur në shtetin e Rumanisë.....	15986
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 556, datë 22.7.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pestës së ruminantëve të vegjël të shfaqur në shtetin e Turqisë.....	15987
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 50, datë 20.6.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-2152 (281), datë 3.5.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	15988
Udhëzim i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nr. 1318, datë 18.7.2024	Modeli dhe mënyra e plotësimit të dokumentacionit teknik	15995
Udhëzim i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nr. 1320, datë 18.7.2024	Për miratimin e dokumentacionit hartografik që hartohet për objektet pa titull pronësie, truallit të tyre funksional dhe të oborreve në përdorim.	16004



LIGJ
Nr. 67/2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 10 440, DATË 7.7.2011,
“PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË
MJEDIS”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 26 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Shkeljet e këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) zhvilluesi i një projekti, i cili listohet në shtojcat I dhe II të këtij ligji, nëse operon pa u pajisur me vendim për VNM-në paraprake, sipas parashikimit të nenit 8 të këtij ligji, ose me deklaratë mjedisore, sipas parashikimit të nenit 9 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 65 000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë deri në 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe me pezullimin e punimeve;

b) mospërmblidhja dhe mosrespektimi i kushteve nga zhvilluesi i projektit:

i. për vendimin për VNM-në paraprake dënohet me gjobë nga 65 000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë deri në 260 000 (dyqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë;

ii. për deklaratë mjedisore dënohet me gjobë nga 65 000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë deri në 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Gjopa e vendosur në zbatim të këtij neni përbën titull ekzekutiv pas shterimit të ankimit administrativ, sipas përcaktimeve në Kodin e Procedurave Administrative. Gjopa paguhet brenda

10 ditëve kalendarike nga data kur është njoftuar kundërvajtësi për vendimin e dënimit me gjobë që përbën titull ekzekutiv. Në rast mosekzekutimi vullnetar, për ekzekutimin e saj ngarkohet zyra e përmbartimit, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurave Civile dhe në ligjin për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 2

Pas nenit 30 shtohet neni 30/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 30/1

“1. Aktet e emërtuara “Vendim për VNM paraprake”/“Vendim për VNM të thelluar”/“Deklaratë mjedisore”, për të cilat aplikimi është kryer në Qendrën Kombëtare të Licencimit, në zbatim të vendimit nr. 13, datë 4.1.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis”, të shfuqizuar, dhe rezultojnë të regjistruara aktive në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave, shfuqizohen për shkak të moskategorizimit si leje, licencë apo autorizim, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Biznesit identifikojnë aktet e emërtuara si “Vendim për VNM paraprake”/“Vendim për VNM të thelluar”/“Deklaratë mjedisore”, të regjistruara si leje mjedisore, dhe kalimi në statusin “shfuqizuar për shkak të ligjit” bëhet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 4.7.2024.

Shpallur me dekretin nr. 258, datë 24.7.2024,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.



DEKRET
Nr. 258, datë 24.7.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 67/2024, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 440, datë 7.7.2011, ‘Për vlerësimin e ndikimit në mjedis’, i ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

LIGJ
Nr. 69/2024

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 9587, DATË 20.7.2006,
“PËR MBROJTJEN BIODIVERSITETIT”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 54 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Kudo në këtë nen fjalët “Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit” zëvendësohen me fjalët “Struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit për kundërvajtjet administrative të parashikuara në pikën 2 të këtij neni jep dënimin kryesor me gjobë:

a) për shkeljet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “ë” dhe “j” nga 390 000 (treqind e nëntëdhjetë mijë) lekë deri në 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë;

b) për shkeljet e përcaktuara në shkronjat “ç”, “e”, “g”, “gj”, “h” dhe “i” nga 13 000 (trembëdhjetë mijë) lekë deri në 390 000 (treqind e nëntëdhjetë mijë) lekë.”.

3. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Gjopa e vendosur në zbatim të këtij neni përbën titull ekzekutiv pas shterimit të ankimit administrativ, sipas përcaktimeve në Kodin e Procedurave Administrative. Gjopa paguhet brenda 10 ditëve kalendarike nga data kur është njoftuar kundërvajtësi për vendimin e dënimit me gjobë, që përbën titull ekzekutiv. Në rast mosekzekutimi vullnetar, për ekzekutimin e saj ngarkohet zyra e përmbarrimit sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurave Civile dhe në ligjin për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 4.7.2024.

**Shpallur me dekretin nr. 259, datë 24.7.2024,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**

DEKRET
Nr. 259, datë 24.7.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 69/2024, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, ‘Për mbrojtjen e biodiversitetit’, i ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**



LIGJ
Nr. 70/2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 10 463, DATË 22.9.2011,
“PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË
MBETJEVE”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Kudo në tekstin e ligjit fjalët “Inspektorati/t për Mjedisin”, “Inspektorati që mbulon fushën për mbrojtjen e mjedisit” zëvendësohen me fjalët “struktura/strukturës përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit”.

Neni 2

Në nenin 3 pas pikës 14 shtohet pika 14/1 me këtë përmbajtje:

“14/1. “Individ” është çdo njeri që hedh, gropos, djeg, braktis, shkarkon apo asgjëson mbetje.”.

Neni 3

Neni 62 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 62

Kundërvajtjet dhe sanksionet

Shkeljet e këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

1. Çdo person, që përzier mbetje në kundërshtim me nenin 17, pika 2, dhe 24 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një

milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

2. Çdo person, që asgjëson mbetje jo në përputhje me nenin 19 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

3. Çdo krijues apo mbajtës mbetjesh, që trajton vetë mbetjet e veta jo në përputhje me këtë ligj dhe në kundërshtim me nenin 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë deri në 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë.

4. Çdo krijues apo mbajtës mbetjesh, që transferon mbetje te një person tjetër, i cili nuk është i autorizuar të marrë atë mbetje, në kundërshtim me nenin 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë deri në 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë.

5. Çdo person, që grumbullon apo transporton mbetje dhe nuk e dërgon atë në një instalim trajtimi të përshtatshëm, në kundërshtim me nenin 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

6. Çdo person, që transferon mbetje jo të rrezikshme apo që merr mbetje jo të rrezikshme pa një dokument transferimi mbetjesh, në kundërshtim me nenin 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

7. Çdo person, që transferon mbetje jo të rrezikshme apo që merr mbetje jo të rrezikshme, që nuk është në përputhje me dokumentin e transferimit të mbetjes, në kundërshtim me nenin 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

8. Çdo person, që angazhohet në transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe që nuk ruan dokumentet në përputhje me nenin 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 390 000 (treqind e nëntëdhjetë mijë) lekë deri në 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

9. Çdo person, që angazhohet në transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe që nuk ua vë dokumentet në dispozicion autoriteteve përkatëse, në përputhje me nenin 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 390 000 (treqind e nëntëdhjetë



mijë) lekë deri në 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

10. Çdo person, që angazhohet në transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe që nuk dërgon informacion në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, në përputhje me nenin 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 390 000 (treqind e nëntëdhjetë mijë) lekë deri në 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

11. Mungesa e kushteve dhe e standardeve të menaxhimit të integruar të mbetjeve, që krijohen brenda territorit të njësive të qeverisjes vendore jo në përputhje me kërkesat e pikës 12 të nenit 21 të këtij ligji, ngarkon me përgjegjësi drejtuesit e këtyre njësive, të cilët dënohen me gjobë në vlerën nga 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë deri në 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë.

12. Çdo person, që importon mbetje, të cilat destinohen për incenerim jo në përputhje me nenin 22 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

13. Çdo person, që prodhon, grumbullon, transporton, magazinon apo trajton mbetje të rrezikshme jo në përputhje me nenin 23 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

14. Çdo person, që transporton mbetje të rrezikshme me automjete, që nuk janë në përputhje me nenin 23 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

15. Çdo person, që grumbullon, transporton apo magazinon mbetje të rrezikshme, që nuk janë ambalazhuar apo etiketuar në përputhje me nenin 25 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

16. Çdo person, që transferon mbetje të rrezikshme apo që merr në dorëzim mbetje të rrezikshme pa një dokument dorëzimi, në kundërshtim me nenin 26 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

17. Çdo person, që transferon mbetje të rrezikshme apo që merr në dorëzim mbetje të rrezikshme, që nuk është në përputhje me

dokumentin e dorëzimit, në kundërshtim me nenin 26 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

18. Çdo person, që angazhohet në transferimin e mbetjeve të rrezikshme dhe që nuk ruan dokumentet në përputhje me nenin 26 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë deri në 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë.

19. Çdo person, që angazhohet në transferimin e mbetjeve të rrezikshme dhe që nuk ua vë dokumentet në dispozicion autoriteteve përkatëse, në përputhje me nenin 26 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë deri në 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë.

20. Çdo person, që angazhohet në transferimin e mbetjeve të rrezikshme dhe që nuk dërgon informacion në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, në përputhje me nenin 26 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë deri në 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë.

21. Çdo person, që trajton vavra të përdorura pa leje mjedisi, në kundërshtim me nenin 27 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

22. Çdo person, që trajton vavra të përdorura jo në përputhje me lejen e mjedisit, në kundërshtim me nenin 27 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

23. Çdo person, që përzien vavra të përdorura jo në përputhje me lejen e mjedisit, në kundërshtim me nenin 27 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

24. Çdo person, që hedh në treg ambalazhe jo në përputhje me nenin 30 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

25. Çdo person, që angazhohet në menaxhimin e mbetjeve të ambalazheve të ndryshme nga ato të përcaktuara në nenin 29 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind



mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

26. Çdo person, që hedh në treg, prodhon, importon ose fut në territorin e Republikës së Shqipërisë qese plastike mbajtëse, si dhe qese plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo të oxo-biodegradueshme, sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit 29 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe sekuestrimin e qeseve plastike të ndaluara.

Kur personi, i cili është dënuar me gjobë në vlerën 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe sekuestrimin e qeseve plastike të ndaluara, konstatohet se hedh në treg, prodhon, importon ose fut në territorin e Republikës së Shqipërisë qese plastike mbajtëse, si dhe qese plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo të oxo-biodegradueshme, sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit 29 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe sekuestrimin e qeseve plastike të ndaluara.

Kur personi, i cili është dënuar me gjobë në vlerën 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe sekuestrimin e qeseve plastike të ndaluara, konstatohet se hedh në treg, prodhon, importon ose fut në territorin e Republikës së Shqipërisë qese plastike mbajtëse, si dhe qese plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo të oxo-biodegradueshme, sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit 29 të këtij ligji, dënohet me revokimin e lejes/licencës së prodhimit dhe sekuestrimin e qeseve plastike të ndaluara.

27. Çdo person, që asgjëson ose menaxhon NOQ jo në përputhje me nenin 30 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

28. Çdo person, që hedh në treg bateri apo akumulatorë jo në përputhje me nenin 31 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

29. Çdo person, që grumbullon, trajton, riciklon apo asgjëson mbetje baterish dhe akumulatorësh jo në përputhje me nenin 31 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

30. Çdo person, që angazhohet me automjetet në fund të jetës jo në përputhje me nenin 32 të këtij ligji,

dënohet me gjobë në vlerën nga 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë deri në 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë.

31. Çdo person, që hedh në treg pajisje elektrike dhe elektronike jo në përputhje me nenin 33 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

32. Çdo person, që angazhohet me mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike jo në përputhje me nenin 33 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

33. Çdo person, që përdor llumrat e ujërave të zeza në bujqësi jo në përputhje me nenin 34 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

34. Çdo person, që angazhohet me mbetjet spitalore jo në përputhje me nenin 35 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

35. Çdo person, që angazhohet me nënproduktet e kafshëve jo në përputhje me nenin 36 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë deri në 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë.

36. Çdo person, që angazhohet me mbetjet inerte jo në përputhje me nenin 37 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

37. Çdo person, që angazhohet me mbetjet nga industria nxjerrëse jo në përputhje me nenin 38 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 2 600 000 (dy milionë e gjashtëqind mijë) lekë.

38. Çdo person, që angazhohet me mbetjet nga industria e dyoksidit të titanit jo në përputhje me nenin 39 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

39. Çdo person, që angazhohet me mbetjet e gjeneruara nga anijet dhe ngarkesat jo në përputhje me nenin 40 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në



1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

40. Çdo person që angazhohet me mbetjet nga gomat e përdorura jo në përputhje me nenin 41 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

41. Çdo person, që vepron në kundërshtim me kërkesat e nenit 42 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

42. Çdo person, që asgjëson mbetje në një landfill, që nuk është klasifikuar për atë mbetje, në kundërshtim me nenin 43 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

43. Çdo person, që asgjëson në landfill mbetje që nuk janë trajtuar, në kundërshtim me nenin 43 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

44. Çdo person, që pranon mbetje në një landfill, që nuk plotëson kriteret e pranimit në landfill, në kundërshtim me nenin 43 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

45. Çdo person, që pranon mbetje të përjashtuara apo që asgjëson në landfill mbetje të përjashtuara, në kundërshtim me nenin 44 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

46. Çdo person, që operon një landfill jo në përputhje me lejen e mjedisit apo jo në përputhje me nenin 45 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

47. Çdo person, që operon një landfill pa një garanci financiare, në kundërshtim me nenin 46 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë deri në 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë.

48. Çdo person, që incineron mbetje jo në përputhje me lejen e mjedisit apo jo në përputhje me nenin 47 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në

1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

49. Çdo person, që importon mbetje të rrezikshme dhe jo të rrezikshme në Republikën e Shqipërisë, sipas nenit 48 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë deri në 2 600 000 (dy milionë e gjashtëqind mijë) lekë.

50. Çdo person, që transiton mbetje të rrezikshme përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 48 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë deri në 2 600 000 (dy milionë e gjashtëqind mijë) lekë.

51. Çdo person, që importon mbetje jo të rrezikshme për ruajtje apo asgjësim, sipas nenit 48 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë deri në 2 600 000 (dy milionë e gjashtëqind mijë) lekë.

52. Çdo person, që transiton mbetje jo të rrezikshme përmes territorit të Republikës së Shqipërisë pa autorizim apo në kundërshtim me autorizimin, jo në përputhje me nenin 50 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë deri në 2 600 000 (dy milionë e gjashtëqind mijë) lekë.

53. Çdo person, që eksporton mbetje jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pa autorizim apo në kundërshtim me autorizimin, jo në përputhje me nenin 51 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

54. Çdo person, që kryen veprimtari për trajtimin e mbetjeve pa leje mjedisi në kundërshtim me nenin 53 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

55. Çdo person, që kryen veprimtari për trajtimin e mbetjeve jo në përputhje me lejen e mjedisit, në kundërshtim me nenin 53 apo 54 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

56. Çdo person, që nuk ruan dokumentet apo nuk ua vë ato në dispozicion autoriteteve përkatëse, në kundërshtim me nenin 55 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë deri në 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë.



57. Çdo person, që transporton mbetje pa licencë apo jo në përputhje me licencën, në kundërshtim me nenin 57 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë deri në 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë.

58. Çdo person, që vepron si agjent apo tregtar mbetjesh pa licencë apo jo në përputhje me licencën, në kundërshtim me nenin 58 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

59. Hedhja apo groposja e mbetjeve në kundërshtim me shkronjat “a”, “b” dhe “c” të nenit 61 të këtij ligji, dënohet me gjobë:

a) për personin fizik ose juridik në vlerën nga 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë deri në 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë;

b) për individin në vlerën nga 65 000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë deri në 130 000 (njëqind e tridhjetë mijë) lekë.

60. Djegia e mbetjeve në kundërshtim me nenin 61 të këtij ligji, dënohet me gjobë:

a) për personin fizik ose juridik në vlerën nga 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë deri në 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë;

b) për individin në vlerën nga 65 000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë deri në 130 000 (njëqind e tridhjetë mijë) lekë.

61. Braktisja, shkarkimi apo asgjësimi i mbetjeve në mënyrë të pakontrolluar në kundërshtim me nenin 61 të këtij ligji, dënohet me gjobë:

a) për personin fizik ose juridik në vlerën nga 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë deri në 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë;

b) për individin në vlerën nga 65 000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë deri në 130 000 (njëqind e tridhjetë mijë) lekë.

62. Çdo operator i një venddepozitimi/landfill-i ekzistues, që nuk plotëson kërkesat e nenit 64 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

Gjoha, në zbatim të këtij neni, vendoset nga struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit për personin fizik dhe juridik dhe nga struktura konstatuese në bashki në rastet kur shkeljet e parashikuara në pikat 59, 60 dhe 61 të këtij neni kryhen nga individit në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin.”.

Neni 4

Në nenin 63/1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Gjoha e vendosur në zbatim të nenit 62 të këtij ligji përbën titull ekzekutiv pas shterimit të ankimit administrativ, sipas përcaktimeve në Kodin e Procedurave Administrative. Gjoha paguhet brenda 10 ditëve kalendarike nga data kur është njoftuar kundërvajtësi për vendimin e dënimit me gjobë që përbën titull ekzekutiv. Në rast mosekzekutimi vullnetar, për ekzekutimin e saj ngarkohet zyra e përmbarimit, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurave Civile dhe në ligjin për kundërvajtjet administrative.”.

2. Në pikën 4 fjalët “apo të revokojë” zëvendësohen me fjalët “apo të shfuqizojë”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 4.7.2024.

Shpallur me dekretin nr. 260, datë 24.7.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 260, datë 24.7.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 70/2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011, ‘Për menaxhimin e integruar të mbetjeve’, i ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**



REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
PËR VITIN 2023****Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke mbajtur në konsideratë rolin e prokurorisë në ushtrimin e ndjekjes penale, hetimin, përfaqësimin e akuzës në gjyq, ekzekutimin e vendimeve penale dhe kryerjen e detyrave të tjera të ngarkuara me ligj;

Duke vlerësuar rëndësinë e raportimit të Prokurorit të Përgjithshëm në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit, për zbatimin e rekomandimeve prioritare të Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit dhe për efektivitetin e ndjekjes penale;

Duke vlerësuar rolin e Prokurorit të Përgjithshëm në nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme për prokurorët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, për oficerët e Policisë Gjyqësore, si dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre, si dhe kujdeset për ushtrimin e kompetencave ligjore dhe kushtetuese të prokurorisë;

Duke vlerësuar angazhimin në procesin e zbatimit të hartës së re gjyqësore, me synim garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit, me theks të veçantë tek e drejta e aksesit në drejtësi;

Duke vlerësuar angazhimin për zbatimin e rekomandimeve të Grupit të Shteteve të Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit (GRECO) dhe përmbushjen e detyrimeve për realizimin e Planit të Veprimit ICRG/FATF;

Për veprimtarinë e Prokurorit të Përgjithshëm për vitin 2023 vlerëson se:

Është rritur numri i procedimeve penale të filluara kryesisht.

Është rritur cilësia e hetimeve për veprat penale të dhunës në familje dhe veprave penale ndaj të miturve. Ndaj të miturve në konflikt me ligjin është kujdesur të merren masa alternative dënimi, si: shmangia, ndërmjetësimi, këshillimi për të miturin apo familjen dhe paralajmërimi me shkrim.

Janë normuar masa administrative dhe procedurale për nxitjen e rolit aktiv dhe ushtrimin sistematik të kontrollit efektiv nga ana e prokurorëve dhe drejtuesve ndaj oficerëve të Policisë Gjyqësore në drejtim të ecurisë së hetimit të procedimeve.

Është konsoliduar bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstitucional me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese palë në marrëveshje dy ose shumëpalëshe, me synim shtimin e burimeve dhe partnerëve për rritjen e cilësisë dhe efektivitetit në kryerjen e hetimeve në drejtëmet prioritare të luftës kundër kriminalitetit.

Është konsoliduar bashkëpunimi dhe koordinimi në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet gjyqësore të huaja nëpërmjet zyrës së Prokurorit Ndërlidhës të Shqipërisë në Eurojust, veçanërisht në rritjen e numrit të skuadrave të përbashkëta hetimore dhe goditjen e krimit.

Është angazhuar në plotësimin e detyrimeve institucionale në zbatim të Planit të Veprimit të ICRG/FATF për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit duke e konsideruar si një objektiv të sajin prioritar, duke kontribuar që Shqipëria të dalë nga lista e juridiksioneve nën monitorim të shtuar, “lista gri”.

Vijojnë përpjekjet për të mundësuar zhvillimin e programit statistikor PRESTO për administrimin elektronik të regjistrave proceduralë dhe përfitim të një sistemi statistikor fleksibël në kohë reale dhe me të dhëna gjithëpërfshirëse për periudhën tranzitore deri në ngritjen e sistemit të ri (CAMS);

Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2024, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet në këto drejtime:

1. Të rrisë numrin e hetimeve proaktive, përdorimin e teknikave të veçanta të hetimit dhe të zhvillojë përdorimin e teknikave të reja.

2. Të rrisë numrin e kërkesave për inspekte tematike në bashkëpunim me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për arritjen e standardeve të unifikuara në zbatimin e ligjit gjatë ushtrimit të funksionit, veçanërisht zbatimin e udhëzimeve me karakter të përgjithshëm për respektimin e garancive procedurale në procesin penal.

3. Të vijojë punën për marrjen e masave efektive për mbrojtjen e viktimave të veprave penale ndaj të miturve dhe veprave penale të dhunës në familje dhe të bashkëpunojë me institucionet shtetërore që ngarkohen me përgjegjësi për mbrojtjen e këtyre kategorive sipas legjislacionit në fuqi.

4. Të nxisë aplikimin e masave alternative të sigurimit (krahas masës së sigurimit arrest me burg) duke përfshirë masat shtrenguese me karakter



pasuror (garancia pasurore) për veprat penale dhe/ose autorët me rrezikshmëri të ulët shoqërore.

5. Të rritet angazhimi institucional në drejtim të zbulimit, gjurmueshmërisë dhe ndjekjes penale në rastet e krimit kibernetik dhe mashtrimit në internet, me fokus të miturit.

6. Të vijojë punën për ngritjen e sistemit të menaxhimit të çështjeve, si dhe ndërlidhjes duke bashkëpunuar me Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

7. Të vijojë punën për zhvillimin dhe përfundimin e sistemit elektronik PRESTO për administrimin elektronik të regjistrave procedurale dhe përfitim të statistikave.

8. Në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, si dhe partnerë të tjerë vendas dhe të huaj të nxiten e mbështeten trajnimet e prokurorëve dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore sipas specializimit të tyre, me fokus të veçantë në krimin kibernetik, hetimin financiar, dhunën në familje dhe atë me bazë gjinore.

9. Të plotësojë angazhimet institucionale që dalin nga rekomandimet e Këshillit të Ministrave apo raportet e organizmave të tjerë ndërkombëtarë, të cilat kërkojnë një nivel më të lartë bashkëpunimi institucional mes drejtuesve të prokurorive në Prokuroritë e Shkallës së Parë dhe Apeleve me Prokurorinë e Përgjithshme.

10. Të vijojë angazhimin në sigurimin e aplikimit të uniformizuar të standardeve të hetimit dhe ndjekjes penale në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut, barazisë para ligjit dhe parimit të proporcionalitetit.

11. Të angazhohet në përmbushjen me efektivitet të detyrimeve institucionale në kuadër të raportimeve gjatë procesit të integritetit në Bashkimin Evropian.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 25.7.2024.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR PËR VITIN 2023

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rëndësinë e rolit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në sigurimin e pavarësisë, përgjegjshmërisë dhe mbarëvajtjes së pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë;

Duke mbajtur parasysh rolin e Këshillit të Lartë Gjyqësor në emërimin, caktimin në pozicion, transferimin, ngritjen në detyrë, komandimin dhe riemërimin, vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin e gjyqtarëve të të gjitha niveleve;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor me Shkollën e Magjistraturës, sidomos për trajnimin vazhdues të gjyqtarëve dhe emërimin e gjyqtarëve pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës;

Duke theksuar rëndësinë e rolit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në drejtimin dhe kujdesjen për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave me fokus hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të politikave për administrimin gjyqësor, monitorimin dhe menaxhimin e ngarkesës së gjyqtarëve dhe të gjykatave, kohëzgjatjen e çështjeve dhe miratimin e rregullave të brendshme standarde të gjykatës;

Duke mbajtur në konsideratë nevojat e Këshillit për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor;

Duke mbajtur parasysh rëndësinë e informimit të publikut dhe Kuvendit për gjendjen e sistemit gjyqësor;

Bazuar në analizën e të dhënave të vitit 2023, të referuara në raportin e paraqitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, konstaton:

Zhvillimin e 80 mbledhjeve plenare dhe miratimin e 743 vendimeve (24% më shumë se 1 vit më parë), nga të cilat 27 akte nënligjore, 506 akte individuale, 162 akte kolektive, 47 akte rregulla të brendshme dhe 1 udhëzim.

Implementimin dhe zbatimin e Hartës së Re Gjyqësore përmes hartimit të një pakete prej 60 aktesh administrative dhe individuale.

Plotësimin e vakancave në Gjykatën e Lartë me 19 anëtarë, përmes procedurës së ngritjes në detyrë të magjistratëve.



Unifikimin e standardeve të administrimit të brendshëm gjyqësor përmes miratimit të rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë nëpër gjykata.

Miratimin e kuotave për ndihmës ligjorë dhe magistratë “profili gjyqtar” për vitin akademik 2023- 2024 në Shkollën e Magistraturës.

Zhvillimin dhe përfundimin e procedurave për verifikimin e 7 kancelarëve në detyrë.

Verifikimin dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor për 4 nëpunës civilë gjyqësorë, 3 ndihmës ligjorë në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apeleve dhe 1 këshilltar ligjor pranë njësisë së shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

Emërimin e 41 magistratëve, të cilët kanë përfunduar programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magistraturës në vitin akademik 2022-2023.

Verifikimin e kriterëve dhe kushteve formaloligjore, si dhe të pasurisë dhe figurës për 46 kandidatë.

Ushtrimin e kompetencave lidhur me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve, me qëllim vetëpastrimin e sistemit gjyqësor duke zhvilluar 6 procedime disiplinore.

Plotësimin e trupave gjyqësore në gjykata, duke trajtuar përkatësisht 169 kërkesa, dhe caktuar 208 gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, si dhe duke përfshirë në skemë delegimi 5 gjyqtarë dhe transferuar 33 gjyqtarë.

Vazhdimin e vlerësimeve etike-profesionale të gjyqtarëve, duke hartuar dhe miratuar 57 raporte vlerësimi. Në periudhën 4-vjeçare janë vlerësuar vetëm rreth 37% të gjyqtarëve që ndodhen efektivisht në detyrë.

Vijimin e angazhimit në funksion të rritjes së transparencës dhe eficiencës për përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm të sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Përfundimin e digjitalizimit të arkivit për 8 nga 20 gjykata që ka aktualisht.

Miratimin e udhëzuesit standard, si dhe rritjen e numrit të gjyqtarëve të medias nga 8 në 17 të tillë, që mbulojnë juridiksionin e përgjithshëm dhe të posaçëm për të dyja nivelet e gjykimit.

Rritjen e kapaciteteve profesionale për gjyqtarët dhe stafin administrativ nëpërmjet trajnimit të 209 gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht detyrën, 103

nëpunës civilë gjyqësorë dhe 15 punonjës të KLGJ-së, në bashkëpunim të ngushtë me Shkollën e Magistraturës, projektet e asistencës së huaj dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.

Kuvendi i Shqipërisë i rekomandon Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2024, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të vijojnë me prioritet procedurat për plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

2. Brenda muajit dhjetor 2024 të informojë Kuvendin me të dhëna statistikore për performancën e sistemit gjyqësor pas zbatimit të hartës së re gjyqësore, si dhe për problematikat në lidhje me të.

3. Të vazhdojë puna për hartimin dhe miratimin e kuadrit nënligjor për planifikimin strategjik, administrimin dhe buxhetin e sistemit gjyqësor, veprimtarinë dhe mirëfunksionimin e gjykatave, si dhe për mirëfunksionimin e administratës civile gjyqësore në zbatim të reformës për nëpunësin civil gjyqësor.

4. Të hartojë dhe të miratojë aktet për përcaktimin e standardeve minimale kohore dhe sasiore për gjykimin e çështjeve

5. Të përshpejtojë procesin e plotësimit të vakancave në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

6. Të vijojë nxitja e Gjykatës së Lartë për njësimin e praktikave gjyqësore, me qëllim vendosjen e standardeve të njëjta në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut në procesin penal, parimit të proporcionalitetit, veçanërisht për zbatimin e masave të sigurimit personal, aplikimin e gjykimeve të posaçme dhe veprave penale të dhunës në familje.

7. Të vijojë puna për trajtimin me prioritet të procesit të vlerësimeve etike dhe profesionale të gjyqtarëve në përputhje me programin e miratuar, si dhe të paraqesë në shtator 2024 në mënyrë të strukturuar tabelare bilancin e vlerësimeve të kryera, si dhe evidenca progresive për të gjithë trupën subjekt vlerësimi, si dhe kohën që ka marrë përfundimi i secilit vlerësim nga institucioni.

8. Të ndërmarrë angazhime konkrete për sa i takon Këshillit bazuar në kompetencat e tij ligjore dhe të përmbyllë në një kohë sa më të shkurtër ngritjen dhe bërjen funksional të sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore për të përmbushur



detyrimin ligjor, si dhe të njoftojë periodikisht Kuvendin për ecurinë dhe proble-matikat.

9. Të vijojë me digjitalizimin e arkivave të gjykatave në mënyrë progresive dhe të shpejtë, për të përmirësuar shërbimet publike në gjyqësore deri në ofrimin e tyre në kohë reale.

10. Të marrë masa në rritjen e transparencës dhe komunikimit me mediet dhe publikun nëpërmjet publikimit të raporteve të veçanta në faqen zyrtare, të përmbledhura, në paraqitje tabelare të fakteve dhe rezultateve, si dhe të evidentojë rastet e mosmarrjes pjesë në vendimmarrje të anëtarëve të Këshillit në zbatim të dispozitave ligjore për konfliktin e interesit dhe rezultatet e votimit. Në veçanti ky angazhim duhet fokusuar për vendimmarrjet me objekt emërimin, transferimin dhe ngritjen në detyrë të magistratëve.

11. Të marrë masa për përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

12. Të vijojë me dhënien e kontributit në adresimin e problematikave të konstatuara në progresraportin e Bashkimit Evropian të vitit 2023 lidhur me aktivitetin e Këshillit.

13. Të angazhohet në përmbushjen me efektivitet të detyrimeve institucionale në kuadër të raportimeve gjatë procesit të integritetit në Bashkimin Evropian.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 25.7.2024.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË PËR VITIN 2023

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke mbajtur parasysh rolin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në garantimin e pavarësisë, llogaridhënies, disiplinës, statusit dhe karrierës së prokurorëve të Republikës së Shqipërisë;

Duke nënvizuar rolin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në emërimin, vlerësimin, ngritjen në detyrë, transferimin dhe vendosjen e masave disiplinore, si dhe pezullimin e prokurorëve të të gjitha niveleve;

Duke mbajtur në konsideratë rolin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në miratimin e standardeve të

etikës së prokurorëve dhe të rregullave të sjelljes së prokurorëve, si dhe për mbikëqyrjen e respektimit të tyre;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë me Shkollën e Magistraturës për trajnimin vazhdues të prokurorëve dhe emërimin e prokurorëve pas diplomimit në Shkollën e Magistraturës;

Duke mbajtur parasysh rëndësinë e rolit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorit;

Për veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2023 konstaton se:

Këshilli i Lartë i Prokurorisë është angazhuar në kuadër të procedurës së ngritjes në detyrë të drejtuesve të zyrave të prokurorëve të juridiksionit të përgjithshëm dhe të përzgjedhjes së prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme.

Ka trajtuar brenda afateve ligjore çështjet e paraqitura për trajtim nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka miraturar Rregulloren për Vlerësimin Etik dhe Profesional të Prokurorëve, programin që përcakton listën e prokurorëve për të cilët do të kryhet vlerësimi, planin tremujor të vlerësimit dhe ka caktuar me short relatorët dhe këshilltarët ligjorë përgjegjës për procedurën e vlerësimit të prokurorëve dhe pritjet fillimi i procesit të vlerësimit.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë kërkon që Këshilli i Lartë i Prokurorisë për vitin 2024, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të përfundojë vlerësimin vjetor profesional të prokurorëve, duke hartuar raportet analitike të vlerësimit dhe të raportoje për mbarëvajtjen e procesit të hartimit të raporteve analitike të vlerësimit etik dhe profesional brenda muajit dhjetor 2024.

2. Të angazhohet maksimalisht në plotësimin e vakancave të përkohshme dhe të përhershme të prokurorëve në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm dhe atë të posaçme.

3. Të unifikojë raportimet dhe hedhjen e të dhënave (duke marrë shkas nga vështirësitë e hasura për plotësimin e formateve të reja mbi të dhënat statistikore për vlerësimin profesional dhe etik të prokurorëve), duke koordinuar përpjekjet për unifikimin e raportimeve dhe hedhjen e të dhënave



në të gjitha sistemet e administrimit, përfshirë regjistrat elektronikë dhe manualë.

4. Të hartohen indikatorët e performancës së prokurorëve të juridiksionit të përgjithshëm bazuar në të dhënat e aneksit nr. 2 të Rregullores, si dhe të përcaktohen indikatorët e performancës së prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme, bazuar në aktet në fuqi.

5. Të bashkërendojë punën me Këshillin e Lartë Gjyqësor, duke intensifikuar takimet për të adresuar problematikat e përbashkëta dhe për të siguruar një qasje të përbashkët në sfidat që lidhen me sistemin e drejtësisë; me fokus në plotësimin e vakancave në gjykata, prokurori dhe ILD, si dhe në zhvillimin e sistemeve teknologjike.

6. Të hartohet një metodologji dhe të ndërmerren hapa konkretë për të zvogëluar stokun e prapambetur në të gjitha nivelet.

7. Të hartohet një raport mbi problematikat e evidentuara gjatë kohës së funksionimit të Këshillit e të paraqitet në Kuvend deri në dhjetor 2024.

8. Të rritet bashkëpunimi me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë sa i përket identifikimit të inspektimeve tematike, komandimit të inspektorëve magjistratë, si dhe të krijohen mekanizma për të përmirësuar komunikimin dhe koordinimin për të adresuar çështjet disiplinore dhe etike në sistemin e prokurorisë.

9. Të vijojë bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës për emërimin dhe caktimin në detyrë të prokurorëve të rinj, verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve që aplikojnë për t'u pranuar në Programin e Formimit Fillestar dhe miratimin e kalendarëve të trajnimeve vazhdues të prokurorëve.

10. Të merren masa për digjitalizimin e arkivave të sistemit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe të bashkëpunojë me Prokurorin e Përgjithshëm për ruajtjen, sistemin dhe digjitalizimin e arkivave të sistemit të prokurorisë në tërësi.

11. Të angazhohet në përmbushjen me efektivitet të detyrimeve institucionale në kuadër të raportimeve gjatë procesit të integritetit në Bashkimin Evropian.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 25.7.2024.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË STRUKTURËS SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR PËR VITIN 2023

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Prokurorisë së Posaçme në ushtrimin e ndjekjes penale, hetimin, përfaqësimin e akuzës në emër të shtetit para Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Gjykatës së Lartë;

Duke vlerësuar pavarësinë institucionale të Prokurorisë së Posaçme në drejtim të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar;

Duke vlerësuar rritjen e besimit të publikut dhe të institucioneve ndërkombëtare ndaj Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;

Vlerëson veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2023 për përmbushjen e funksioneve në këto drejtime:

Përmirësimin të treguesve statistikorë të hetimeve të ndërmarra nga Prokuroria e Posaçme, veçanërisht për hetimet e nisura kryesisht, të interceptimit me pajisje fundore dhe të kërkesave për ndihmë juridike nga jashtë vendit, të cilat në krahasim me vitin 2022 kanë shënuar rritje të numrit respektivisht me 139%, 91% dhe 95%.

Rritjes së numrit dhe përmirësimin të hetimeve dhe konfiskimeve të pastrimit të parave, si rezultat i të cilave u miratua vendimi për daljen e Shqipërisë nga lista e juridiksioneve nën monitorim të shtuar, njohur ndryshe si “lista gri” e MONEYVAL-it.

Bashkëpunimit të mirë e të vazhdueshëm me agjencitë ligjzbatuese të BE-së, përfshirë Europolin dhe Eurojust-in duke marrë pjesë në një sërë operacionesh ndërkombëtare të zbatimit të ligjit.

Progresit të shënuar në sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të lidhura me krimin e organizuar, ku për vitin 2023 vlera e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara së bashku është përlogaritur në rreth 41.5 milionë euro.

Sigurimit dhe forcimit të etikës në punë nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore konkrete, si dhe avancimit të mëtejshëm të punës për plotësimin



e kuadrit rregullator për vlerësimin e riskut të brendshëm lidhur me luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Fuqizimit të kapaciteteve hetimore kryesisht në hetimet financiare dhe pasurore me veprime komplekse brenda dhe jashtë vendit, ku përfshihen edhe veprimet me kriptovaluta.

Përmirësimit të bazës logjistike në drejtim të ekspertimit të provave digjitale dhe përditësimit të laboratorit ekzistues me programet e fjalës së fundit.

Përfundimit të verifikimeve të plota nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës për Prokurorinë dhe GJKKO-në për 60 kandidatë për personel administrativ në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si dhe vazhdimin e procesit për 13 kandidatë për gjyqtarë në GJKKO.

Informimit të publikut për punën e Prokurorisë së Posaçme nëpërmjet administrimit të përgjigjeve për 128 kërkesat për informacion të paraqitura për vitin 2023, ku interes më të shtuar kanë paraqitur ato lidhur me hetimet në kuadër të veprave penale të krimit të organizuar, si dhe ato për qëllime terroriste, korrupsionin aktiv dhe pasiv të funksionarëve që ushtrojnë funksione publike.

Kuvendi kërkon që Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2024 të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të hartohet një strategji e posaçme për priorizimin e çështjeve dhe procedimeve të mbartura.

2. Të intensifikohen hetimet paralele financiare për rastet e krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm, terrorizmit dhe pastrimit të parave.

3. Të vijojë angazhimin në sigurimin e aplikimit të uniformizuar të standardeve të hetimit dhe ndjekjes penale, duke garantuar barazinë para ligjit.

4. Të vijohet me forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknike me fokus hetimet financiare e të kriptovalutave.

5. T'u kushtohet vëmendje krimeve zgjedhore, veçanërisht fakteve të bëra publike në media para, gjatë dhe pas procesit zgjedhor, për të filluar hetimin kryesisht në rastet kur ka njoftime publike për kryerjen e një vepre penale.

6. Të tregohet një vëmendje e shtuar ndaj denoncimeve që vijnë nga publiku, si dhe të rritet numri i hetimeve të kryera nga prokurorët e

Prokurorisë së Posaçme për çështje me ndjeshmëri të lartë publike.

7. Të angazhohet në plotësimin e vakancave me qëllim funksionimin me eficiencë të plotë të Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit.

8. Të përmbyllë procesin e hartimit dhe miratimit të akteve të tjera nënligjore, të cilat rezultojnë të pamiratuara, për të përfunduar plotësimin e kornizës strategjike institucionale.

9. Të angazhohet në pilotimin dhe testimin e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve, me qëllim vënien në eficiencë brenda vitit 2024 duke pasur parasysh rëndësinë e këtij sistemi në punën e prokurorëve dhe hetuesve të strukturës.

10. Të angazhohet në përmbylljen me efektivitet të detyrimeve institucionale në kuadër të raportimeve gjatë procesit të integritetit në Bashkimin Evropian.

Miraturar në datën 25.7.2024.

KRYETARE
Lindita Nikolla

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR VITIN 2023

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë;

Duke mbajtur parasysh rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në hetimin e shkeljeve të dyshuara nëpërmjet ankesave të paraqitura nga çdo person fizik ose juridik, por edhe kryesisht bazuar në të dhëna publike ose të siguruar në kuadër të inspektimeve institucionale e tematike;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë,



Prokurorin e Përgjithshëm dhe Ministrinë e Drejtësisë në kuadër të inspektimeve tematike dhe përmbushjes së detyrave të tjera funksionale;

Vlerëson veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjatë vitit 2023 në këto drejtime:

Trajtimit dhe përfundimit të plotë të shqyrtimit të 2104 ankesave të trashëguara nga organet kompetente gjatë periudhës kalimtare (*backlog*) në mënyrë të paanshme dhe duke ndjekur parimin e proporcionalitetit, ku vetëm për vitin 2023 janë shqyrtuar më shumë se 50% e këtyre ankesave.

Miratimit të 18 vendimeve për hetim disiplinor në të cilat janë hetuar shkeljet e pretenduara për 25 magjistratë, nga të cilët 4 prokurorë dhe 21 gjyqtarë, kryesisht për shkelje të pretenduara në lidhje me vonesa të përsëritura dhe zvarritje të pajustificuara të akteve procedurale, si dhe veprime ose mosveprime që sjellin përfitime të padrejta ose dëme për palët në proces gjyqësor.

Përfundimit të dy inspektimeve tematike për të cilat janë lënë rekomandime të karakterit legjislativ, organizativ dhe mirëfunksionimit, duke ndikuar drejtpërsëdrejti në rritjen si të ndërgjegjësisë, ashtu dhe të eficiencës së veprimtarisë së organit të inspektuar.

Fillimit të procesit për vlerësimin etiko-profesional të inspektorëve dhe përfundimin e vlerësimit për njërin prej tyre, duke i hapur rrugë ngritjes së komisioneve përkatëse për vlerësimin e inspektorëve, emërimin e inspektorëve jomagjistratë dhe zgjedhjen e zëvendësinspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Rritjes së bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve dhe shkëmbimit të praktikave më të mira të punës, ku mund të veçohet anëtarësimi me të drejta të plota në Rrjetin Evropian të Shërbimeve të Drejtësisë dhe angazhimi në projektin e nisur nga Komisioni Evropian “Bashkëpunimi për mbrojtjen e mjedisit nga Autoritetet Kombëtare të Inspektimit të Drejtësisë”.

Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Inspektori i Lartë i Drejtësisë për vitin 2024 të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të adresojë nëpërmjet instrumenteve që i jep ligji problematikat e ndjeshme për publikun, si institucion garantues i sistemit të drejtësisë, me qëllim fuqizimin e mëtejshëm të besimit të publikut

jo vetëm për ILD-në, por për të gjitha institucionet e sistemit të drejtësisë.

2. T’i kushtohet vëmendje e veçantë plotësimit të vakancave në pozicionet e inspektorit magjistrat dhe të inspektorit jomagjistrat.

3. Të ndërmarrë masa të rregullta për kontrollin e figurës dhe të pasurisë/integritetit në përputhje me standardet e larta të procesit të rivlerësimit, veçanërisht për inspektorët jomagjistratë.

4. Të rritet numri i inspektimeve institucionale me objektiv të qartë dhe të përcaktuar, të fokusuara në aspektet specifike të veprimtarisë së gjykatave dhe zyrave të prokurorisë për menaxhimin e çështjeve dhe administrimin gjyqësor dhe hetimor.

5. Të përfundojë vlerësimin etiko-profesional të inspektorëve në një kohë të arsyeshme dhe rezultatet e vlerësimit të përdoren për të zhvilluar programe trajnimi në drejtim të përmirësimit të performancës institucionale.

6. Të angazhohet për të rritur bashkëpunimin me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë dhe Ministrinë e Drejtësisë në drejtim të shkëmbimit të informacionit, bashkëpunimit në hetime dhe inspektime tematike, si dhe koordinimin e veprimeve për të adresuar çështje të përbashkëta.

7. Të përmirësojë treguesit e transparencës dhe aksesueshmërinë e publikut, duke publikuar informacione periodike, raporte dhe çdo të dhënë tjetër që reflekton veprimtarinë institucionale.

8. Të angazhohet në përmbushjen me efektivitet të detyrimeve institucionale në kuadër të raportimeve gjatë procesit të integritetit në Bashkimin Evropian.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 25.7.2024.

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË
SË AVOKATIT TË POPULLIT
PËR VITIN 2023**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin dhe rëndësinë e organeve të barazisë në një shoqëri demokratike, ku të drejtat dhe liritë themelore të çdo individi duhet të respektohen;



Duke vlerësuar rolin e Avokatit të Popullit si institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike;

Duke vlerësuar angazhimin e Avokatit të Popullit për të kryer funksionin e tij në përputhje me legjislacionin kombëtar, por edhe me atë ndërkombëtar (veçanërisht Parimet e Parisit dhe të Komisionit të Venecias);

Shqyrtoi veprimtarinë e Avokatit të Popullit për vitin 2023 në drejtim të:

Intensifikimit të reagimit institucional me vizibilitet më të shtuar në publik për rekomandimet që nuk zbatohen apo në rast mosbashkëpunimi nga autoritetet publike, me qëllim rritjen e besimit të publikut ndaj këtij institucioni kushtetues.

Rolit aktiv në inspektimin e kushteve në të cilat trajtohen shtetasit në përgjithësi dhe të miturit në veçanti në institucionet e privimit të lirisë dhe adresimin e rekomandimeve përkatëse në institucionet përgjegjëse.

Organizimit të veprimtarive promovuese me tipologji të ndryshme, me qëllim përmirësimin e njohurive të nxënësve për të drejtat e tyre themelore dhe punën e Avokatit të Popullit në mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Hartimit të rekomandimeve ndaj strukturave të Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit, si rrjedhojë e konstatimeve të vazhdueshme të mosrespektimit të të drejtave themelore të shtetasve.

Thellimit të bashkëpunimit me organet e pushtetit vendor, duke realizuar aktivitete të ndryshme promovuese dhe ditë të hapura në disa bashki të vendit.

Zhvillimit të procedurave në kuadër të përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatëve dhe shoqërisë civile.

Monitorimit në zonat kufitare dhe angazhimin me Policinë e Kufirit dhe Migracionit lidhur me gjetjet e tyre, që përforcon qasjen e Shqipërisë bazuar në të drejta ndaj azilkërkuësve.

Zhvillimit të aktiviteteve për përmirësimin dhe konsolidimin e njohurive të nxënësve për edukimin ligjor për të drejtat themelore të njeriut, veçanërisht të fëmijëve dhe punën e Avokatit të Popullit për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Bashkëpunimit me organet e administratës publike, shoqërinë civile, institucionet ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit, qarqet akademike e medien, me qëllim rritjen e njohurive dhe vetëdijes së publikut rreth të drejtave të tij.

Inicimit të ngritjes së Observatorit për Femicidin për të analizuar të dhënat, shkaqet përse ndodh femicidi dhe analizimi i veprimeve të kryera nga institucionet sa u përket të drejtave të grave dhe barazisë gjinore pasi konstatohet se gratë dhe vajzat përjetojnë situata dhune, pabarazie dhe diskriminimi.

Dhënies së opinionit “Amicus Curiae” nga Avokati i Popullit për çështje të paraqitura në Gjykatën Kushtetuese dhe marrjen parasysht të qëndrimit të tij.

Rritjes të numrit të rekomandimeve nga të gjitha seksionet krahasuar me vitin paraardhës.

Adresimit të problematikave, si dhe bashkëpunimit me strukturat e Ministrisë së Drejtësisë dhe ato të burgjeve, me qëllim garantimin e të drejtave kushtetuese e ligjore të qytetarëve nga veprimet apo mosveprimet e kundërligjshme të punonjësve të policisë.

Zhvillimit të aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe informuese në zyrat rajonale, me qëllim promovimin dhe nxitjen e respektimit të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individëve dhe promovimit të mekanizmave mbrojtës të tyre.

Trajtimit të një numri më të lartë të ankesave/kërkesave krahasuar me një vit më parë.

Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Avokati i Popullit për vitin 2024, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të rrisë hetimin me iniciativë të problematikave sistemike që lidhen me të drejtat e njeriut dhe të hartojë rekomandime përgjithësuese e strategjike, me qëllim vendosjen e bashkëpunimit dhe bashkërendimit institucional me administratën publike.

2. Të ushtrojë të drejtën për të adresuar propozime ligjore në kuadër të harmonizimit të legjislacionit kombëtar me atë të BE-së dhe t'ia paraqesë Kuvendit.

3. Të përditësojë në vijimësi dhe të publikojë në faqen zyrtare në mënyrë të vazhdueshme informacionin, si dhe statistikën në kuadër të organizimit dhe funksionimit të institucionit, me



qëllim rritjen e mëtejshme të transparencës dhe komunikimit me publikun.

4. Të adresojë rekomandime, sugjerime për përmirësime pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë, me qëllim rritjen e besimit të publikut tek drejtësia, garantimin e zbatimit të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, si dhe garancive procedurale.

5. Të hartojë një strategji komunikimi gjithëpërfshirëse dhe me tregues të qartë për të rritur vizibilitetin dhe për të promovuar rolin e tij në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe të nisë procesin e hartimit të një Plani të ri Strategjik dhe Planit të Veprimit në zbatim të tij.

6. Të vijojë aktivitetet promovuese dhe ndërgjegjësuere me fëmijët në institucionet e arsimit parauniversitar, si dhe në shkollat speciale të vendit, ku ndjekin mësimin fëmijë me aftësi ndryshe.

7. Të vijojë bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve duke synuar informimin në kohë reale, zbatimin e rekomandimeve, si dhe të rrisë edhe më tej rolin aktiv në ndërgjegjësimin dhe trajnimin e punonjësve të policisë dhe punonjësve në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP).

8. Të vijojë më tej zhvillimin e inspektimeve/monitorimeve të Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, si dhe i seksioneve informuese/promovuese në rang vendi, me qëllim mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të fëmijëve.

9. Të integrojë në raportet vjetore dhe periodike shkallën e përmbushjes së rekomandimeve të progresraportit të BE-së të adresuara drejtpërdrejt për institucionin e Avokatit të Popullit sipas përcaktimeve të vendimit nr. 134/2018, “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”.

10. Të angazhohet në përmbushjen me efektivitet të detyrimeve institucionale në kuadër të raportimeve gjatë procesit të integritetit në Bashkimin Evropian.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 25.7.2024.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT PËR VITIN 2023

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Autoritetit në përmbushje të misionit të tij për dhënien e informacionit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në mënyrë që të edukojë publikun e të mbështesë vlerat demokratike të drejtësisë, të vërtetën, pajtimin e përgjegjësinë për brezat e ardhshëm;

Duke konsideruar se veprimtaria e Autoritetit është udhëhequr nga parimi i ligjshmërisë, mbrojtjes së të dhënave personale, dhënies së informacionit publikut, institucioneve dhe medias në kohë dhe me cilësi;

Duke vlerësuar bashkëpunimin e Autoritetit me institucione të tjera vendase dhe institucione homologe ndërkombëtare për shkëmbimin e informacionit e të përvojës lidhur me objektin e punës së Autoritetit,

Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2023 në drejtim të:

Zhvillimit të tryezave ndër-institucionale në lidhje me hartimin e akteve nënligjore që do të përcaktojnë autoritetet përgjegjëse dhe mënyra e mbrojtjes dhe ruajtjes së vendvarrimeve të identifikuar ose të dyshuara.

Angazhimit për procesin e digjitalizimit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit të mbledhura nga institucionet arkivore në vend në arkivin e vetëm të Autoritetit.

Angazhimit për evidentimin e të vrarëve apo të vdekurve në tentativë për të kaluar kufirin gjatë regjimit komunist, identifikimin e vendvarrimeve të mundshme të të zhdukurve në territorin administrativ të Kolonjës dhe vënien në mbrojtje dhe mbikëqyrje të posaçme, për t'i ruajtur nga tjetërsimi i mundshëm.

Verifikimit administrativ për gjetjen e eshtrave dhe qartësimin e fatit të të zhdukurve gjatë periudhës komuniste, si të burgosurve të ekzekutuar, të vrarë, apo të vdekur në burg, gjatë vuajtjes së dënimit në burgun e Spaçit.

Shkurtimin e afateve kohore të trajtimit të kërkesave studimore dhe medietike mbi



dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe garantimin e publikatave të tyre të kërkuar brenda afateve kohore të përcaktuara në aktet nënligjore.

Ndërtimin e platformës “Mësojmë nga e kaluara, burime arsimore të hapura 1944–1991”, një platformë interaktive në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, e cila parashikon të rrisë ndjeshmërinë e institucioneve përgjegjëse për rëndësinë që ka edukimi për qytetari demokratike, njohjen me veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit, por edhe me mbijetesën, qëndresën dhe solidaritetin e atyre që vuajtën në sajë të kësaj veprimtarie.

Kuvendi kërkon që Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2024 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të vijojë angazhimin për qartësimin e fatit të të zhdurve në komunizëm, në komunikimin me familjet, grupet e interesit, pushtetin lokal, organizatat ndërkombëtare dhe institucionet e ngarkuara për këtë qëllim.

2. Të vijojë angazhimin për krijimin e një baze të vetme të dhënash për personat e zhdur dhe ta bëjë atë publike e të aksesueshme për publikun.

3. Të intensifikojë bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike për verifikim të figurës së zyrtarëve të pajisur më parë me certifikatë pastërtie nga komisionet “Bezhan” e “Mezini”.

4. Të bashkëpunojë me KQZ-në për ndryshimet e nevojshme të kuadrit ligjor ekzistues lidhur me integritetin e zyrtarëve, Kodit Zgjedhor, apo ligjit për parti të politike në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të angazhohet për verifikimin e të gjithë kandidatëve në zgjedhje.

5. Të intensifikojë bashkëpunimin me institucionet publike për marrjen e materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit dhe dokumenteve arkivore sipas përkufizimit të nenit 3, pika 5, të ligjit nr. 45/2015, i ndryshuar, si dhe t'i raportojë Kuvendit për të adresuar problematikat e hasura gjatë procesit.

6. Të angazhohet në përmirësimin e procedurave për ta bërë procesin e verifikimit të subjekteve lehtësisht të kuptueshëm për palët e interesuara dhe plotësisht të realizueshëm, si dhe të krijojë bazën e të dhënave me emrat e subjekteve të verifikuara, informacionet për strukturat operative ose bashkëpunëtorët e ish-Sigurimit të Shtetit.

7. Të rrisë aktivitetin ndërgjegjësues përmes përdorimit të medieve dhe formave të komunikimit

virtual, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin për rolin e AIDSSH-së për informimin e individëve mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

8. Të angazhohet për një marrëveshje bashkëpunimi me ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor me qëllim zbatimin korrekt të ligjit për kryerjen e procesit të verifikimit të figurës së personave që propozohen për dekorim, tituj nderi, apo propozimeve për emërtimin e hapësirave publike me emra personalitetesh, trajtimin e vendvarrimeve të dyshuara të ekzekutimeve, varreve të pashënuara, trajtimin e vendeve të kujtesës, strukturat e arsimit, bibliotekat e muzetë lokale.

Miraturar në datën 25.7.2024.

KRYETARE
Lindita Nikolla

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE PËR VITIN 2023

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke besuar në objektivat dhe përpjekjet e vendit tonë për intensifikimin e luftës kundër korrupsionit, si kusht dhe detyrim thelbësor në kuadër të procesit të integritetit dhe anëtarësimit në Bashkimin Evropian;

Duke theksuar rëndësinë e koordinimit dhe forcimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse ligjzbatuese në vend dhe institucioneve të pavarura për rritjen e efikasitetit të hetimeve penale apo administrative, si dhe ndëshkimin e praktikave korruptive, me qëllim arritjen e rezultateve konkrete dhe të prekshme në parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit;

Duke vlerësuar gjetjet në raportin për Shqipërinë për vitin 2023 të Komisionit Evropian për progresin e shënuar nga Inspektorati, si dhe mbështetjen e vazhdueshme nga partnerët ndërkombëtarë për përmbushjen e objektivave prioritarë të institucionit;

Duke inkurajuar e mbështetur Inspektoratin për forcimin e kapaciteteve administrative, teknike, financiare dhe të instrumenteve ligjore, me qëllim përmbushjen e misionit institucional për zbulimin e



pasurimit korruptiv dhe praktikave të ngjashme me të, në parandalimin e konfliktit të interesave për të gjithë kategoritë e zyrtarëve, subjekteve të ligjit dhe personave të lidhur, si dhe inkurajimin për denoncimin e tyre;

Vlerëson veprimtarinë e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2023 në drejtim të:

Progresit të shënuar në funksionimin tërësor institucional dhe në veçanti në përmbushjen e të gjitha rekomandimeve të lëna në rezolutën e Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2022”.

Angazhimit në procesin e integritetit të vendit në Bashkimin Evropian nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë, me qëllim mbështetjen e proceseve raportuese, dhënien e kontributit për nënkomitetet, progresraportin, apo proceset e takimeve dypalëshe *screening* për kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”.

Garantimit të funksionalitetit të plotë të Sistemit të Elektronik të Deklarimit të Interesave Privatë, ku ka vijuar puna për implementimin e masave shtesë të sigurisë në këtë Sistem, nga nevoja e shtuar e sulmeve kibernetike, si dhe angazhimit në zhvillimin e aktiviteteve trajnuese për 329 përfaqësues të institucioneve publike, përgjegjës për menaxhimin e procesit të deklarimit të interesave privatë.

Zbulimit të rasteve të fshehjeve të pasurisë, si dhe shkeljeve të ndryshme të ligjit për deklarimin e interesave privatë, duke administruar një numër total prej 4070 deklaratah të interesave privatë, duke kaluar në kontroll të plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e pasurisë dhe të interesave privatë 636 subjekte deklarues, duke ndëshkuar me masën administrative “gjobë” për rastet e refuzimeve për deklarim, rastet e mos deklarimeve dhe rastet e konfliktit të interesit 113 zyrtarë, si dhe duke paraqitur pranë prokurorisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Policisë së Shtetit dhe strukturave të hetimit tatimor 16 raste referimesh penale.

Mbështetjes së procesit reformues të sistemit të drejtësisë, me fokus të veçantë forcimin e bashkëpunimit me organet e rivlerësimit dhe ONM-

në nëpërmjet trajtimit me përparësi të 53 kërkesave të ardhura nga këto institucione, si dhe në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe ligjit për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme, nga Inspektorati është ushtruar kontroll i plotë për 187 kandidatë në organet e ndryshme të sistemit të drejtësisë.

Vlerësimit kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, në cilësinë e organit ndihmës për komponentin e verifikimit të pasurisë duke bashkëpunuar me Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore për kontrollin e plotë të deklaratave të interesave privatë për 35 subjekte të shortuar nga kjo Agjenci.

Administrimit dhe analizimit të 455 raportimeve të dërguara nga njësitë përgjegjëse të ngritura në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, nga të cilat 172 i përkasin sektorit publik dhe 283 sektorit privat, si dhe përditësimit të të dhënave të regjistrave kombëtarë të këtyre njësive.

Shkëmbimit të eksperiencave rajonale në fushën e sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve, si dhe angazhimit me palët e tjera të përfshira në proces, në vlerësimin e përputhshmërisë së kuadrit ligjor në fuqi, me Direktivën e BE-së, për mbrojtjen e personave që sinjalizojnë, si pjesë masave të përcaktuara për t’u përmbushur edhe në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës.

Bashkëpunimit me institucionet e tjera përgjegjëse për zbatimin e pjesës tjetër të rekomandimeve të vlerësuara si të zbatuara pjesërisht në raportin e Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit të Këshillit të Evropës (GRECO) në raundin V, me qëllim marrjen e vlerësimeve pozitive për këto rekomandime në raportim e ardhshëm që është në qershor të këtij viti.

Angazhimit të kapaciteteve administrative në dhënien e asistencës së nevojshme, përfshirë udhëzimet specifike, këshillat dhe trajnimet e organeve përgjegjëse të institucioneve shtetërore për zbatimin e saktë të dispozitave në identifikimin apo trajtimin e situatave të konfliktit të interesave, ku numri i kërkesave të trajtuara gjatë vitit ka rezultuar të jetë 22.

Konsolidimin e marrëdhënieve me organet e sistemit të drejtësisë në verifikimin brenda afateve



ligjore të deklaratave të pasurive dhe interesave privatë për kandidatët për pozicione të ndryshme të këtyre organeve.

Intensifikimin e bashkëpunimit të ndërsjellë ndaj luftës kundër korrupsionit, me qëllim shkëmbimin e informacionit ndërmjet palëve, ku për 23 raste ILDKPKI-ja ka vendosur në dispozicion të SPAK-ut të gjithë informacionin e nevojshëm të administruar.

Nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar, ku krahas vijimit të marrëdhënieve të ngushta dhe të frytshme me Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri, Këshillin e Evropës në Shqipëri, Zyrën e OSBE-së në Tiranë, Agjencitë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si USAID-i, u intensifikua komunikimi me zyrat homologe dhe agjencitë antikorrupsion në rajon dhe më gjerë. Gjithashtu, vlen të përmendet anëtarësimi në Rrjetin për Integritet (*Network for Integrity*), si një forum i rëndësishëm për shkëmbimin e përvojave të institucioneve të ndryshme në rritjen e instrumenteve të integritetit, transparencës dhe etikës, si një mjet për të nxitur më tej besimin e publikut ndaj institucioneve publike.

Ndjekjes së një politike të hapur me qytetarët e shoqërinë civile, si dhe forcimin e bashkëpunimit me medien investigative në veçanti, duke trajtuar me përparësi, korrektësi dhe brenda afateve ligjore 37 kërkesat e publikut në lidhje me publikimin e deklaratave të interesave privatë.

Kuvendi kërkon që Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2024 të vazhdojë punën në këto drejtime:

1. Të bashkëpunojë me Ministrinë e Drejtësisë për përafrimin e kuadrit ligjor për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, jo vetëm me direktivën përkatëse të BE-së, por edhe me praktikat më të mira të vendeve të ndryshme.

2. Të angazhohet në bashkëpunim edhe me shoqërinë civile për rritjen e ndërgjegjësimit publik, veçanërisht të rinjve, për rëndësinë e sinjalizimit përmes një fushate rajonale.

3. Të bashkërendojë punën me Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore në avancimin më tej të procesit të vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme.

4. Të vazhdojë kontributin e dhënë në kuadër të procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, veçanërisht në adresimin e gjetjeve të paraqitura nga Komisioni Evropian në raportin *screening* për Shqipërinë për sa i përket kapitullit 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”.

5. Të angazhohet për përmirësimin e treguesve të transparencës jo vetëm në vënien në funksionalitet të plotë të sistemit nëpërmjet bërjes publike të deklaratave të interesave privatë, por edhe me pasurimin e faqes zyrtare në internet me të dhëna statistikore për veprimtarinë institucionale në zbatim të ligjeve për parandalimin e konfliktit të interesit dhe sinjalizimin e mbrojtjen e sinjalizuesve.

6. Të intensifikojë bashkëpunimin me organet ligjzbatuese në drejtim të garantimit të sigurisë dhe efektivitetit të kontrolleve dhe hetimeve administrative për ruajtjen e standardeve në luftën kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 25.7.2024.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUTIT TË STATISTIKAVE PËR VITIN 2023

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur INSTAT-in si prodhuesin kryesor të statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë, misioni i të cilit është të prodhojë statistika asnjëansë, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve për proceset e zhvillimit dhe transformimit në fushat ekonomiko-sociale të vendit;

Duke vlerësuar se censi i popullsisë dhe i banesave, i realizuar gjatë vitit 2023, ka një rëndësi të veçantë në planifikimin e politikave publike, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e programeve që synojnë përmirësimin e jetës së qytetarëve;

Duke vlerësuar se përdorimi i teknologjisë së informacionit është i rëndësishëm për të përmirësuar proceset e prodhimit statistikor, si dhe në të njëjtën kohë ndihmon në integrimin e burimeve të ndryshme të të dhënave dhe përmirësimin e përpunimit të tyre;



Duke vlerësuar se statistikët zyrtarë shpërndahen duke respektuar parimet statistikore të përcaktuara në ligj, duke mbrojtur konfidencialitetin statistikor dhe duke siguruar akses të barabartë për të gjithë përdoruesit;

Vlerëson për vitin 2023:

Punën e bërë nga INSTAT-i në realizimin e censit të popullsisë dhe të banesave 2023, si aktiviteti më i rëndësishëm statistikor, i cili u përmyll më 15 nëntor 2023, pas një pune të gjatë përgatitore në kuadër të menaxhimit të cilësisë së proceseve dhe cilësisë së të dhënave.

Punën e bërë nga INSTAT-i në zbatimin e strategjisë së komunikimit për promovimin e censit të popullsisë dhe banesave, veçanërisht aktivitetet e shumta sensibilizuese për rritjen e besueshmërisë dhe pjesëmarrjen e popullatës në këtë proces shumë të rëndësishëm.

Punën e bërë nga INSTAT-i për aplikimin e metodave bashkëkohore të mbledhjes së të dhënave, në përputhje me standardet e kërkuara nga Eurostat, metoda të cilat rrisin cilësinë, efikasitetin dhe besueshmërinë e statistikave të prodhuara.

Punën e bërë nga INSTAT-i për zgjerimin e Sistemit Kombëtar Statistikor dhe përfshirjen si agjenci statistikore e AKBN-së (Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore), e cila, duke u mbështetur nga INSTAT-i, do të prodhojë statistika të rëndësishme lidhur me energjinë, naftën gazin, etj.

Punën e bërë nga INSTAT-i në draftimin e projektligjit të censit të ekonomive bujqësore, si dhe përgatitjen e dokumenteve të tjera mbështetëse lidhur me këtë census të rëndësishëm, i cili do të kontribuojë në sigurimin e të dhënave bazë të qëndrueshme në kohë, si demografike, ashtu edhe social-ekonomike, në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.

Punën e bërë nga INSTAT-i si anëtar i grupit negociator, përgjegjës për kapitullin 18 “Statistikat”, në kuadër të integritetit evropian.

Punën e bërë nga INSTAT-i në transmetimin e të dhënave në Fondin Monetar Ndërkombëtar (*Enhanced General Data Dissemination System* (eGDDS), si standardi minimal për shpërndarjen e të dhënave.

Kuvendi i Shqipërisë i rekomandon INSTAT-it për vitin 2024:

1. Pas përpunimit të të dhënave me cilësi dhe profesionalizëm të censit të popullsisë dhe të banesave 2023, të publikojë brenda afateve të

përcaktuara rezultatet përfundimtare të censit, por edhe publikime të tjera gjeoreferenciale dhe me karakter social, sipas kalendarit të shpallur, të cilat do të shërbejnë si një bazë e fortë për planifikimin e politikave publike dhe do të ndihmojnë në zhvillimin e programeve që synojnë përmirësimin e jetës së qytetarëve.

2. Të ndërmarrë iniciativa që të përdorë të dhënat e censit për të përditësuar platformën e SDG/OZHQ për të gjithë treguesit dhe nëntreguesit, që tashmë janë pjesë e platformës.

3. Të marrë masat e nevojshme për të bërë të mundur realizimin me cilësi dhe në kohë të censit të ekonomive bujqësore në përputhje me *acquis* të BE-së dhe standardet ndërkombëtare, si dhe bazuar në vizionin dhe objektivat strategjikë për kryerjen e tij.

4. Në kuadër të rritjes së sigurisë kibernetike, të marrë masat e nevojshme për përditësimin dhe përmirësimin e sistemeve *hardware* dhe *software* të institucionit, si dhe të bashkëpunojë me AKCESK për të forcuar më tej sigurinë ndaj sulmeve të mundshme kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave statistikore, si dhe informacionit konfidencial.

5. Në kuadër të transparencës dhe plotësisimit më të mirë të nevojave të përdoruesve, të marrë masat e nevojshme për të bërë sa më shpejt aktive përgjatë 24 orëve faqen web të INSTAT.

6. Për të përmirësuar transparencën dhe besueshmërinë e të dhënave tona kombëtare, të rrisë nivelin e transmetimit të të dhënave në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), duke ndjekur Standardin Special të Shpërndarjes së të Dhënave (*Special Data Dissemination Standard* (SDDS). Përmbushja e standardeve të SDDS-së do të rrisë më shumë transparencën dhe besueshmërinë e të dhënave, të cilat janë thelbësore për vendimmarrje të informuar drejt nxitjes së rritjes ekonomike.

7. Në zbatim të objektivit strategjik për forcimin e Sistemit Kombëtar Statistikor, të luajë një rol pro aktiv duke komunikuar me institucionet publike të vendit për ngritjen e strukturave të dedikuara për statistikët zyrtarë, duke i konsideruar ato si shumë të rëndësishme për burimet administrative të të dhënave, për planifikimin e politikave publike në zhvillimin dhe transformimin ekonomiko-social të vendit.

8. Të rrisë prodhimin dhe transmetimin e të dhënave në kohë dhe me cilësi të lartë për shpërndarje (publikim) nga Eurostat, si dhe të vërë në dispozicion të publikut të dhënat lidhur me



statistikat financiare të qeverisë, siç theksohet edhe në progresraportin e KE-së.

9. Me gjithë përmirësimet e bëra, duhet të rrisë përpjekjet për të ulur numrin e punonjësve që largohen nga institucioni, përmes përmirësimit të procesit të rekrutimit, shpërblimit të punonjësve dhe trajnimit të tyre, krijimit të një ambienti konkurrues, transparent për rritjen në detyrë të tyre, duke bërë të mundur krijimin e një stafi, i cili ka eksperiencën dhe profesionalizmin e nevojshëm për përballimin e sfidave me të cilat përballlet institucioni.

10. Të hartojë dhe të zbatojë një strategji të dedikuar komunikimi për censin e ekonomive bujqësore, e cila të ketë si synim rritjen e ndërgjegjësimit dhe evidentimin e rëndësisë së censit për audiencën përkatëse.

11. Duke i konsideruar statistikat zyrtare si një të mirë publike në drejtim të prioritetëve kombëtare për zhvillim dhe integrim, të rrisë përpjekjet për zbatimin e metodave inovative dhe bashkëkohore në prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare, të intensifikojë përdorimin e teknologjisë së informacionit në funksion të përmirësimit të proceseve të prodhimit statistikor, të integritetit të burimeve të ndryshme të të dhënave dhe përmirësimit të përpunimit të tyre, duke rritur përdorimin e të dhënave, që janë pjesë përbërëse e platformave të ndërveprimit qeveritar.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 25.7.2024.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS PËR VITIN 2023

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Autoritetit të Konkurrencës në sigurimin e një konkurrence të lirë dhe efektive në treg në zbatim të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar;

Duke vlerësuar rolin e Autoritetit të Konkurrencës për mbrojtjen dhe promovimin e konkurrencës së lirë dhe efektive, si dhe veprimtarinë e tij në monitorimin, hetimin dhe

analizimin e tregjeve me ndikim të madh në mirëqenien e konsumatorëve shqiptarë;

Duke vlerësuar punën e Autoritetit të Konkurrencës sa i përket diversitetit të tregjeve të monitoruara, duke mbuluar një gamë të gjerë tregjesh, nga ushqimet bazë dhe shërbimet publike deri te shërbimet digjitale dhe ato të transportit;

Duke njohur hapat e ndërmarrë për përafrimin e veprimtarisë dhe kuadrin ligjor me standardet dhe praktikatat e Bashkimit Evropian;

Duke konsideruar se mirëfunksionimi i tregjeve kërkon gjithëpërfshirjen e aktorëve dhe faktorëve të tregut për t’i bërë ata konkurrues dhe të hapur, me synim mirëqenien e konsumatorit;

Për veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2023 konstaton se:

Janë monitoruar 15 tregje nga të cilat katër nuk kanë kaluar në procedura hetimore, dy kanë kaluar në procedurë hetimore, gjashtë janë në zbatim të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës gjatë viteve 2022 dhe 2023 dhe tre janë monitorime në vazhdim; si dhe janë realizuar 8 procedura hetimore në tregjet sensitive dhe me impakt të drejtpërdrejtë në mirëmbajtjen e konsumatorit.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë kërkon që Autoriteti i Konkurrencës për vitin 2024, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Autoriteti i Konkurrencës duhet të vijojë të përforcojë zbatimin e rregullave të konkurrencës, me qëllim që të ndihmojë në sigurimin e një tregu më të drejtë dhe konkurrues në Shqipëri, duke mbrojtur interesat e konsumatorëve dhe duke nxitur një mjedis të shëndetshëm të biznesit, me qëllim:

a) monitorimin e ndërmarrjeve që operojnë në industrinë e turizmit;

b) sigurimin e një konkurrence efektive në tregun e shërbimeve bankare digjitale nëpërmjet monitorimit të tarifave dhe komisioneve të shërbimeve bankare;

c) sigurimin e një konkurrence efektive duke vijuar monitorimin e tregut të sigurimeve;

ç) sigurimin e një tregu të drejtë dhe konkurrues për produkte të shportës, që nuk kanë qenë objekt hetimi në 5 vjetët e fundit, si dhe

d) të vijojë me procedurat e monitorimit dhe hetimit në tregun e shërbimit spitalor privat dhe tregun e çimentos në përputhje me rezolutën e vitit 2022.



2. Të hartohet një raportim i detajuar për përmbushjen e rekomandimeve të rezolutave të Kuvendit për të siguruar transparencë më të madhe dhe vlerësim më të saktë të përmbushjes së rekomandimeve.

3. Të sigurohet që procedurat hetimore dhe monitorimet të përfundojnë në kohë të arsyeshme, me qëllim zgjidhjen e problematikave pa humbur aktualiteti, për çështje që kanë një ndikim në mirëqenien e konsumatorit.

4. Të rritet bashkëpunimi ndërinstitucional me në fokus Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe Komisionin e Prokurimit Publik për të siguruar përmbushjen e rekomandimeve të dhëna dhe për të adresuar çështjet e konkurrencës në mënyrë më efektive. Të reflektohet gjendja e zbatimit të rekomandimeve në Platformën Ndërinstitucionale Online.

5. Të krijohet një sistem i menaxhimit të informacionit që të përmirësojë qasjen dhe përdorimin e të dhënave në mënyrë efektive dhe efikase. Të krijohet një sistem për trajtimin e ankesave të konsumatorëve dhe biznesit lidhur me praktikant antikonkurrense dhe për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

6. Të fillojë puna për hartimin e një dokumenti strategjik afatgjatë “Politika e Konkurrencës” për monitorimin e tregjeve kryesore dhe të një plani veprimi me indikatorë të qartë e të matshëm.

7. Të rritet transparenca dhe llogaridhënia në veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës përmes publikimit të raporteve periodike, analizave të detajuara, statistikave të përditësuara në formate miqësore për publikun, njoftimeve të qarta dhe vendimeve të mirargumentuara.

8. Të vijojë përafrimi i kuadrit nënligjor me standardet dhe praktikant e Bashkimit Evropian, të ketë një rol proaktiv në advokacinë e konkurrencës dhe vijimin e trajnimit të stafit të ri dhe atij ekzistues.

Kuvendi u kërkon organeve ekzekutive të të gjitha niveleve të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës:

Duke zbatuar detyrimin për të kërkuar paraprakisht vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projektakt normativ që ka si objekt ose pasojë dhënien e të drejtave ekskluzive ose kufizime sasiore apo cilësore të konkurrencës në tregje ose sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe veçanërisht për kontratat koncesionare.

Duke kërkuar bashkëpunim me qëllim përmbushjen e plotë dhe në kohë të rekomandimeve të Autoritetit të Konkurrencës.

Për konsultime në procesin e përgatitjes dhe miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 25.7.2024.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2023

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar angazhimin e Bankës së Shqipërisë për zbatimin e misionit kryesor të saj, arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, si dhe të objektivave dhe detyrimeve të tjera ligjore të saj;

Duke vlerësuar rolin e Bankës së Shqipërisë në promovimin e stabilitetit financiar të vendit, në zhvillimin e tregjeve financiare dhe të infrastrukturës së pagesave, si dhe në krijimin e parakushteve për rritjen e qëndrueshme të ekonomisë;

Duke vlerësuar pavarësinë institucionale të Bankës së Shqipërisë, si dhe detyrimin për zbatimin dhe raportimin e rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i Shqipërisë;

Vlerëson veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2023, për përmbushjen e funksioneve të saj dhe të objektivave strategjike afatmesëm, në këto drejtime:

Zhvillimit të mëtejshëm të kapaciteteve analizuese, parashikuese dhe kërkimore, duke ndihmuar në përmirësimin e hartimit të politikës monetare.

Hartimit dhe miratimit të Strategjisë së Gjellbër Afatmesme 2023–2025 “Për administrimin dhe mbikëqyrjen e rreziqeve financiare të lidhura me klimën në sektorin financiar”, e cila synon të integrojë në mënyrë sistematike dhe të qartë rreziqet klimatike në dimensionet e mbikëqyrjes që Banka e Shqipërisë kryen për zhvillimet makroekonomike dhe financiare të vendit, bazuar në praktikant më të mira dhe në përputhje me Planin e Veprimit të Komisionit të BE-së.



Përditësimi të kuadrit rregullator në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve përmes miratimit të ligjit për llogarinë e pagesave në shërbimet bazike, nëpërmjet të cilit do t'i sigurohet e drejta çdo konsumatori për të pasur akses në shërbimet bazë të llogarisë së pagesës, pa kosto ose me kosto të përballueshme.

Miratimit të ndryshimeve rregullatore që lidhen me kredinë konsumatore dhe hipotekare, llogaritjen e normave fikse të interesit në tregun ndërbankar të parasë, licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së SHKK-së dhe unioneve të tyre.

Administrimit në mënyrë të kujdesshme të kërcënimeve kibernetike të vazhdueshme dhe intensifikimit të ndërveprimit veçanërisht me sektorin bankar dhe autoritetet rregulluese në procesin e inspektimeve.

Angazhimit në procesin e anëtarësimit të vendit në BE, në cilësinë e drejtuesit të kapitujve 4 dhe 17 të progresraportit, si dhe përmbushjes së të gjitha detyrimeve financiare dhe raportuese me Bankën Botërore dhe FMN-në.

Monitorimit sa i takon rrezikut të kredisë, rrezikut të likuiditetit, atij operacional, etj., nëpërmjet realizimit të 8 ekzaminimeve në vend, nga të cilat 4 ekzaminime të plota në banka (2 banka sistemike dhe 2 banka josistemike), 3 në subjekte financiare jobanka dhe 1 në shoqëritë e kursim kreditit.

Vijimit të inspektimeve veçanërisht për çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit duke realizuar një numër total prej 61 inspektimesh, nga të cilat 50 inspektime në zyrat e këmbimit valutor dhe 11 inspektime të tjera në banka dhe subjekte financiare jobanka.

Monitorimit të procesit të administrimit të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, i cili në fund të vitit arriti në rreth 4.5 miliardë lekë, duke përbërë rreth 56% të nivelit të synuar për vitin 2027 dhe rritjes së nivelit të automatizimit të tij për të gjitha bankat që operojnë në tregun vendas.

Sigurimin e funksionimit të 3 infrastrukturave kryesore për procesimin e pagesave ndërbankare dhe një për shlyerjen e titujve, ku në sistemin AIPS u shlye një volum prej 152.6 mijë transaksionesh, në sistemin AIPS EURO 249 mijë transaksione, me një rritje nga viti 2022 në vlerë me 24% dhe në numër transaksionesh me 60%, në sistemin AECH 1.38 milionë transaksione, duke shënuar rritje me 12.4%, në krahasim me vitin 2022.

Arritjen e të gjithë objektivave të përcaktuar në Strategjinë e Pagesave me Vlerë të Vogël 2018-2023, si dhe zgjerimin e përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave. Gjithashtu, për vitin 2023 numri i pagesave në total u rrit me 25.5%, ndërsa vlera e pagesave u rrit me 27.1%, vetëm pagesat *home banking* janë rritur me 22% në numër transaksionesh dhe me 28% në vlerë transaksionesh.

Akomodimin e kërkesës për para fizike në ekonomi, si dhe përfundimin e emetimit të plotë të serisë së re të kartëmonedhave. Në fund të vitit rezultuan rreth 156 milionë copë kartëmonedha në qarkullim, me vlerë 401 miliardë lekë.

Administrimin e rezervës valutore në përputhje me politikën e administrimit, ku rezultoi se rezerva valutore është rritur me rreth 89 milionë euro përgjatë gjithë vitit.

Harmonizimin e statistikave me *acquis communautaire*, intensifikimin e punës kërkimore në mbështetje të vendimmarrjes dhe rritjes së transparencës, edukimin dhe komunikimin e vazhdueshëm me publikun përmes botimeve të rregullta për politikën monetare, stabilitetin financiar dhe mbikëqyrjen bankare, si dhe përmbushjen e detyrimit për të ofruar transparencë në lidhje me veprimtarinë e Bankës.

Kuvendi kërkon që Banka e Shqipërisë për vitin 2024 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të mirëmbajë dhe të zhvillojë më tej modelet e parashikimit të politikës monetare për të kuptuar dhe parashikuar në mënyrë të përshtatshme dhe në kohë trendet e zhvillimit të vendit dhe për të reaguar në kohën dhe në masën e duhur ndaj tyre.

2. Të vazhdojë bashkërendimin e politikës monetare me politikën fiskale dhe masat makroprudenciale, në interes të rritjes së sinergjive të politikave të brendshme ekonomike dhe në mbështetje të procesit të integritetit evropian.

3. Të përditësojë bazën rregullatore në funksion të nxitjes së stabilitetit financiar dhe moslënies së hapësirave të parregulluara që mund të krijojnë problematika në të ardhmen.

4. Të nxisë zhvillimin e tregjeve të brendshme financiare dhe konvergencës graduale të tyre me standardet e BE-së.

5. Të intensifikojë përpjekjet në identifikimin, monitorimin dhe administrimin e rreziqeve që u vijnë institucioneve financiare bankare dhe jobankare nga ndryshimet klimatike nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të një plani të detajuar veprimi,



si dhe të mbështesë institucionet financiare për krijimin e një infrastrukture të dhënash që masin/vlerësojnë këtë rrezik.

6. Të monitorojë në vazhdimësi treguesin e kapitalizimit të sektorit bankar dhe të marrë në kohë masa që ky tregues të jetë në nivele të mjaftueshme për të përballuar rreziqet e aktivitetit dhe për të mundësuar një rritje të shëndetshme të kreditimit.

7. Të monitorojë në vazhdimësi tregun e këmbimeve valutore dhe të reagojë në kohën e duhur ndaj çrregullimeve potenciale në funksionimin e këtyre tregjeve.

8. Të prioritzojë veprimet për anëtarësimin sa më parë të vendit në Tregun Unik të Pagesave në Euro, si pjesë e rëndësishme e angazhimit në drejtim të procesit të integritetit evropian, që do të sjellë përfitime për ekonominë, si dhe të nxisë zhvillimin e projektit Instant Payment.

9. Të vazhdojë zbatimin e masave të ndërmarra në kuadër të paketës së De-euroizimit, si instrumente të nevojshme për zbutjen e rreziqeve potenciale që vijnë nga luhatjet e kursit të këmbimit dhe të bashkërendojë punën me institucionet e tjera publike, të cilat janë pjesë e kësaj strategjie.

10. Të kujdeset për zbatimin e plotë të ligjit nr. 100/2023 “Për llogarinë e pagesave në shërbimet bazike”, nëpërmjet miratimit të të gjitha akteve nënligjore brenda afateve të përcaktuara, si dhe sensibilizimit të publikut të gjerë për përfitimin e shërbimeve bankare me kosto të ulëta, dhe të intensifikojë përpjekjet për kryerjen e transaksioneve të pagesave elektronike përmes kartave elektronike apo formave të tjera të pagesave jo në para fizike.

11. Të harmonizojë në vazhdimësi praktikën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme me zhvillimet në legjislacionin e BE-së, si dhe të vijojë bashkëpunimin me autoritetet përgjegjëse evropiane në funksion të shkëmbimit të informacionit të nevojshëm për ndërhyrjen e jashtëzakonshme.

12. Të mirëmbajë planet e vijimësisë dhe të reagimit ndaj rreziqeve kibernetike, mbështetur në standardet ndërkombëtare dhe në praktikën më të mira për mbrojtjen kibernetike.

13. Të monitorojë me kujdes përqendrimin në rritje të kreditimit të lidhur me sektorin e pasurive të paluajtshme, si dhe të nxisë zbatimin e plotë nga bankat të rregullores “Për raportimin e të dhënave, identifikimin dhe monitorimin e treguesve mbi kredidhënien dhe investimet për prona të paluajtshme”. Rritjen e fokusit në pasojat potenciale

për stabilitetin financiar me identifikimin e hershëm të risqeve, që mund ta cenojnë shëndetin e sektorit bankar.

14. Të vazhdojë përafrimin e kuadrit mbikëqyrës me legjislacionin evropian për sa i takon rrezikut operacional, rrezikut të teknologjisë së informacionit e komunikimit dhe rrezikut kibernetik, si dhe të rrisë vigjilencën mbikëqyrëse ndaj këtyre rreziqeve.

15. Të angazhohet në hartimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore, nën asistencën e institucioneve ndërkombëtare, për mbrojtjen e konsumatorit në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka, rritje e transparencës në tregun financiar, si dhe përfshirjen në aktet ligjore të ndryshimeve rregullative të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë.

16. Të sigurojë implementimin brenda vitit 2024 të Open Banking, PSD2 (*Payment Service Directive EU*), si dhe mundësimin për shtimin e opsioneve për transferim parash dhe pagesat bankare me qëllim uljen e kostove në çdo transaksion.

17. Të vazhdojë procesin e mbikëqyrjes të bazuar në rrezik, si për sektorin bankar, ashtu edhe për institucionet financiare jobankare, të udhëhequr nga parimi i proporcionalitetit në mënyrë që të sigurohet rregullimi në përputhje me risqet që mund të ofrojnë një segment tregu në raport me tregun dhe një institucion financiar në raport me institucionet e tjera të të njëjtit segment.

18. Të rrisë fokusin e saj në zhvillimin e kapaciteteve të kërkimit dhe analizimit të fenomeneve ekonomike me fokus të veçantë zhvillimet në kursin e këmbimit dhe risqeve që mund të prodhojë situata të ndryshme për ekonominë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 25.7.2024.



VENDIM

Nr. 479, datë 24.7.2024

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË
METODOLOGJISË DHE STANDARDET
TEKNIKE PËR PËRDORIMIN E
INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 39, të ligjit nr. 43/2023, “Për qeverisjen elektronike”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit të metodologjisë dhe standardet teknike për përdorimin e inteligjencës artificiale në Republikën e Shqipërisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ministrinë dhe institucionet e tjera publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku**METODOLOGJIA DHE STANDARDET
TEKNIKE TË PËRDORIMIT TË
TEKNOLOGJISË SË INTELIGJENCËS
ARTIFICIALE NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË****Hyrje**

Kjo metodologji është konceptuar dhe hartuar duke u bazuar në praktikat dhe standardet më të mira të fushës, ndër të cilat mund të përmenden ato të përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Standardeve dhe Teknologjisë (NIST), publikimi IA RMF 1.0¹, OECD², Bashkimi Evropian (BE), të cilat theksojnë rëndësinë që ka dokumentimi dhe vlerësimi i ndikimit që kanë në sistemet e informacionit ndryshimet e propozuara mbi proceset operacionale, infrastrukturat teknologjike,

personelin dhe përdoruesit e sistemeve, që bazohen në teknologjinë e inteligjencës artificiale etj.

Në kornizën e zhvillimit të sistemeve të inteligjencës artificiale (IA), një metodologji e qartë dhe e strukturuar shërben për implementimin me sukses të saj. Metodologjitë tradicionale përfshijnë hulumtimin dhe zhvillimin e një sistemi, duke përdorur teknika të njohura, si programimi i strukturuar dhe inxhinierimi i *software*-ve. Në kontrast, metodologjia e inteligjencës artificiale përdor mënyra të avancuara të mësimit dhe modelimit për të maturuar sistemet kompjuterike. Sistemet IA përdorin mënyra të avancuara të modelimit për të trajtuar informacionin dhe marrëdhënie komplekse në mes të të dhënave.

Më gjithatë, ka disa kufizime: të dhënat duhet të etiketohen dhe trajtohen me kujdes para se të procesohen nga sistemi.

Pra, të dhënat duhet t'i jepen të mirëtrajtuara sistemeve me IA dhe të etiketuara me kujdes për të parandaluar sjellje të papritura dhe të paparashikueshme.

Metodologjia e IA-së është dinamike dhe mund të përshtatet në mjedisin e saj për të zëvendësuar modele dhe marrëdhënie, duke shfrytëzuar njohuritë e veta. Kjo u mundëson sistemeve IA aftësinë për të adaptuar ndryshimet, duke rritur performancën e tyre me kohën. Ndërkohë që metodologjia tradicionale është statike dhe kërkon një plan të qartë paraprak, IA-ja është dinamike dhe mund të përshtatet në mjedisin e saj.

KREU I

QËLLIMI DHE OBJEKTI

1. Kjo metodologji është e planifikuar dhe strukturuar në qasjen e një politike makromenaxhuese dhe makroorientuese për implementimin e teknologjive dhe të zgjidhjeve të reja të inteligjencës artificiale në Republikën e Shqipërisë, veçanërisht atyre që prekin institucionet publike nën varësinë e Këshillit të Ministrave.

2. Metodologjia siguron një udhëzues të qartë dhe efektiv për përcaktimin e veprimeve dhe të masave që do të ndërmerren për të garantuar një implementim të suksesshëm dhe të sigurt të teknologjive të reja të IA-së.

¹ <https://csrr.nist.gov/pubs/sp/800/53/r5/final>

² <https://legalinstruments.oecd.org/en/instruments/oecd-legal-0449>



3. Objekti i një metodologjie për implementimin e inteligjencës artificiale (IA) është të ofrojë një qasje sistematike dhe të strukturuar për zhvillimin, zbatimin dhe menaxhimin e teknologjive të IA-së.

4. Përcaktimin e hapave dhe të proceseve specifike që duhen ndjekur për të garantuar një implementim të suksesshëm dhe efektiv.

KREU II STANDARDET

1. Standardet teknike në zhvillimin e inteligjencës artificiale

Standardet teknike për IA-në në këtë dokument referohen si kritere dhe specifikime që kanë për qëllim të sigurojnë besueshmërinë, interoperabilitetin dhe përdorimin etik të teknologjive të inteligjencës artificiale.

1.1. Disa aspekte kyçe të mbuluara nga standardet teknike për IA-në janë:

A. Menaxhimi i riskut³: Ky standard ofron kritere për identifikimin dhe menaxhimin e riskut të lidhura me teknologjitë e inteligjencës artificiale. Këto standarde teknike ofrojnë korniza specifike për zbatimin e praktikave të menaxhimit të riskut në fushat ku përfshihen teknologjia dhe inteligjenca artificiale.

Politikat, proceset, procedurat dhe praktikat në institucionet publike lidhur me përcaktimin, matjen dhe menaxhimin e riskut të inteligjencës artificiale janë të mirëpërcaktuara, transparente dhe të zbatuara në mënyrë efektive. Është shumë e rëndësishme që kërkesat ligjore dhe nënligjore që lidhen me inteligjencën artificiale të kuptohen, të menaxhohen dhe të dokumentohen në mënyrën e duhur.

Veprimet që rekomandohen për të realizuar të përcaktuar sa më sipër janë:

a) Në çdo planifikim dhe implementim që do të kryhet apo do të parashikohet për t'u kryer kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme të jenë specifike për industrinë, sektorin dhe qëllimin e biznesit, si dhe të kenë të përfshirë kontekstin e aplikimit të sistemit të inteligjencës artificiale të implementuar;

b) Plani për menaxhimin e riskut dhe veprimet e kryera në funksion të sistemit duhet të jenë në përputhje me përcaktimet ligjore të zbatueshme;

c) Të hartohen dhe të miradministrohen politika për trajnimin (dhe ritrajnimin), pilotimin për punonjësit e institucioneve publike, por edhe për personelin e bizneseve private apo operatorëve që do të zhvillojnë sisteme apo mjete të inteligjencës artificiale lidhur me elemente të rëndësishme të bazës ligjore dhe nënligjore në fuqi, të cilat mund të ndikojnë në dizejnimin dhe zhvillimin e aktiviteteve apo mjeteve/sistemeve që lidhen me IA-në;

ç) Klasifikimi i sistemeve IA të ndara në 4 kategori, sipas nivelit të riskut:

I. Rrezik i papranueshëm: Kjo kategori përfshin sistemet e IA-së që shkelin në thelb vlerat dhe të drejtat themelore të BE-së. Shembujt përfshijnë sistemet e vlerësimit social që gjykojnë individët dhe manipulojnë IA, të krijuar për të mashtruar ose dëmtuar njerëzit.

II. Rrezik i lartë: Sistemet IA të identifikuar si me rrezik të lartë përfshijnë teknologjinë IA të përdorur në:

- Infrastruktura kritike (p.sh. transport), që mund të rrezikojë jetën dhe shëndetin e qytetarëve;
- Trajnim arsimor ose profesional, që mund të përcaktojë qasjen në arsim dhe karrierë;
- Komponentët e sigurisë së produkteve (p.sh. kirurgji me asistencë robotike);
- Punësim dhe menaxhim të punonjësve;
- Shërbime private dhe publike thelbësore;
- Zbatimi i ligjit;
- Menaxhimi i migracionit, azilit dhe kontrollit kufitar;
- Administrimi i drejtësisë dhe proceseve demokratike.

III. Rrezik i kufizuar: Këto sisteme të IA-së paraqesin kërcënime minimale, por ende kërkojnë njëfarë niveli të ndërgjegjësimit të përdoruesit. Për shembull, kur përdoren sisteme IA, si *chatbot*-et, njerëzit duhet të jenë të vetëdijshëm që po ndërveprojnë me një makinë.

IV. Rrezik minimal ose asnjë rrezik: Kjo kategori përfshin sistemet e IA-së me praktikisht asnjë rrezik për sigurinë, privatësinë ose të drejtat. Përfshirja e IA-së në aplikacione si videolejër, filtrat e postës elektronike dhe sisteme të ngjashme.

B. Karakteristikat e besueshmërisë mbi inteligjencën artificiale duhet të jenë të integruara me politikat, proceset dhe procedurat e institucioneve publike apo bizneseve private. Politikat e

³ https://airc.nist.gov/AI-RMF_Knowledge_Base/Playbook



menaxhimit të riskut të inteligjencës artificiale në këta të fundit duhet të jenë të projektuara:

a) për të përcaktuar termat dhe konceptet kyçe lidhur me sistemet e inteligjencës artificiale dhe shtrirjen e synuar të qëllimeve dhe përdorimeve të tyre;

b) për të lidhur menaxhimin e inteligjencës artificiale me menaxhimin e brendshëm organizativ ekzistues dhe kontrollet e riskut;

c) përputhje me politikat e menaxhimit të riskut të IA-së, me politikat dhe praktikatat e menaxhimit të të dhënave, në veçanti menaxhimit të të dhënave sensitive;

ç) detajuar standarde për dizajnin eksperimental, cilësinë e të dhënave dhe trajnimin e sistemeve të IA-së;

d) detajuar proceset e testimit dhe validimit të sistemeve;

dh) detajuar dhe testuar planet e përgjigjes ndaj incidenteve;

e) verifikuar se politikat formale të menaxhimit të riskut të inteligjencës artificiale përputhen me bazën ligjore ekzistuese, dhe me praktikatat më të mira ndërkombëtare të fushës;

ë) verifikuar se politikat e menaxhimit të riskut të inteligjencës artificiale përfshijnë sistemet që mund të jenë të implementuar aktualisht. C. Procesi i menaxhimit të riskut dhe rezultatet e tij duhet të administrohen nëpërmjet politikave dhe procedurave transparente, si dhe kontroleve të tjera bazuar në prioritetet e institucioneve publike në Republikën e Shqipërisë.

Veprimet që rekomandohen për të realizuar të përcaktuara sa më sipër janë:

a) hartimi dhe rishikimi rregullisht i politikave të dokumentimit që, midis të tjerave, adresojnë informacionin lidhur me:

i. informacion mbi palët e interesit të IA-së;

ii. zbatimin dhe përdorimin e IA-së;

iii. risqet potenciale dhe ndikimin e mundshëm;

iv. kushtet paraprake dhe kufizimet;

v. metodologjinë algoritmike;

vi. planet për monitorimin dhe menaxhimin e ndryshimeve.

2. Standardet që do të zbatohen gjatë ciklit jetësor të sistemeve të IA-së:

Sistemet e inteligjencës artificiale kanë potencialin të sjellin shumë avantazhe për shoqërinë. Për këtë arsye, kriteret janë ndarë në katër fusha kyçe, brenda ciklit të zhvillimit të sistemit të

inteligjencës artificiale: dizenjimi i sigurt, zhvillimi i sigurt, implementimi i sigurt dhe operimi e mirëmbajtja e sigurve. Këto elemente ndihmojnë në zvogëlimin e riskut të përgjithshëm për procesin e zhvillimit të sistemit të inteligjencës artificiale në institucionet publike në Republikën e Shqipërisë.

A. Dizenjimi i sigurt: Përfshin kuptimin e riskut dhe modelimin e kërcënimeve, si dhe temat specifike për t'u konsideruar në dizajnin e sistemit dhe modelit.

1. Elementet e dizenjimit të sigurt:

i. Ndërgjegjësimi i gjithë stafit të institucioneve publike mbi kërcënimet dhe riskun;

ii. Modelimi i mbrojtjes nga kërcënimet për sistemin;

iii. Në dizajnim të përfshihet funksionimi optimal, siguria dhe performanca e sistemit;

iv. Përfshirja e avantazheve dhe kompromentimeve të sigurisë kur zgjidhet sistemi i IA-së për sistemin.

B. Zhvillimi i sigurt: Kriteret që aplikohen në fazën e zhvillimit gjatë ciklit jetësor të sistemit të inteligjencës artificiale, përfshijnë sigurinë e zinxhirit të furnizimit, dokumentacionin dhe menaxhimin e aseteve.

1. Elementet e zhvillimit të sigurt:

i. të sigurohet ai që quhet “zinxhiri i furnizimit”;

ii. të identifikohen, monitorohen dhe mbrohen asetet që disponohen;

iii. të dokumentohen të dhënat dhe modelet e IA-së.

C. Implementimi i sigurt: Kriteret që aplikohen në fazën e implementimit gjatë ciklit jetësor të zhvillimit të sistemit të inteligjencës artificiale përfshijnë, mbrojtjes e infrastrukturës dhe sistemeve IA nga kompromentimet, kërcënimet ose humbjet, zhvillimin e proceseve të menaxhimit të incidenteve etj.

1. Elementet e implementimit të sigurt:

i. duhet të merren masa për sigurimin e infrastrukturës;

ii. duhet të zhvillohen dhe testohen procedura të menaxhimit të incidenteve;

iii. përdorimi i sistemeve të IA-së duhet të jetë sa më i thjeshtuar për përdoruesin fundor;

iv. duhet të kryhet vlerësimi i ndikimit në mbrojtjen e të dhënave.



Ç. Operimi dhe mirëmbajtja e sigurt⁴: Kriteret që aplikohen në fazën e operimit dhe mirëmbajtjes gjatë ciklit jetësor të zhvillimit të sistemit të inteligjencës artificiale.

1. Elementet e operimit dhe mirëmbajtjes së sigurt:

- i. të monitorohet vazhdimisht sjellja e sistemit;
- ii. të monitorohen gjurmët e hyrjeve në sistem;
- iii. sistemet e IA-së duhet të mbahen në çdo kohë të përditësuara;
- iv. të mblidhen të dhëna dhe të përdoren si “mësime të nxjerra”;
- v. trajtimi i sistemit përtej ciklit jetësor të tij (arkivim, asgjësim).

D. Testimi i produkteve dhe performancës: institucioni duhet të sigurojë testimet e nevojshme për përcaktimin e pragut të saktësisë të sistemit të IA-së.

DH. Ndërfaqja dhe rrjetëzimi: institucioni duhet të sigurohet që produktet dhe sistemet IA të mund të punojnë së bashku, duke rritur shtrirjen dhe përdorimin e tyre pa shpërdorim.⁵

E. Integriteti: sigurimi i saktësisë dhe plotësisë së informacionit dhe metodave të përpunimit.

Ë. Burimet e të dhënave: në një sistem IA, të dhënat mund të merren nga disa burime, duke përfshirë sensorë (të tilla si kamerat CCTV, telefonat inteligjentë ose pajisjet mjekësore) dhe asetet digjitale (të tilla si të dhënat nga platformat e tregtimit, ekstraktet e dokumenteve ose skedarët e regjistrimit). Të dhënat mund të jenë në shumë forma të ndryshme, duke përfshirë tekstin, imazhet, videon e audion dhe mund të jenë të strukturuar ose të pastrukturuar. Të dhënat mund të jenë të disponueshme nga burime të hapura, për shembull në internet ose me burime të mbyllur, si ato komerciale ose private, në atë masë që është e nevojshme dhe proporcionale për realizimin e qëllimit dhe kur subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij ose në çdo rast tjetër që parashikon legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Të dhënat mund të merren nga bota reale, ose sintetike.

Grupet e të dhënave që përdoren për trajnimin e sistemeve IA mund të jenë shumë të mëdha dhe shpesh vijnë nga burime të shumta të shpërndara,

duke krijuar grup të dhënash “trajnuës”. Asnjë kategori apo burim i të dhënave nuk është plotësisht imun ndaj risqeve të sigurisë prandaj ky dokument përcakton se në çdo rast duhet të tregohet vëmendje e shtuar që në zhvillimin dhe implementimin e sistemeve të IA-së të garantohet maksimalisht integriteti i të dhënave.

F. “Kurimi” i të dhënave: faza e kurimit ose e përpunimit përfshin një numër hapash të grumbullimit dhe transformimit, duke përfshirë ruajtjen e të dhënave, parapërpunimin, pasurimin e seteve të të dhënave dhe etiketimin.

G. Trajnimi dhe testimi i sistemeve IA: gjatë trajnimit, parametrat e modelit përshtaten në mënyrë që të arrihet një performancë më e saktë dhe kjo përsëritet derisa të arrihet një nivel i pranueshëm saktësie.

Të dhënat e trajnimit, validimit dhe testimit të sistemit duhet të jenë të përshtatshme, gjithëpërfshirëse, pa gabime dhe të plota. Duhet të kenë vetitë e duhura statistikore, ku përshihen sipas nevojës, personat apo grupet e personave, për të cilët sistemi IA do të përdoret. Të dhënat duhen trajtuar sipas:

- a) zgjidhjes përkatëse të projektimit të të dhënave;
- b) grumbullimit të të dhënave;
- c) përgatitja e procesimit, si: etiketimi, pastrimi, pasurimi dhe grumbullimi;
- ç) vlerësimi paraprak për sasinë dhe përshtatshmërinë e grupit të të dhënave të nevojitura;
- d) ekzaminimi për anësi të të dhënave;
- dh) identifikimi i çdo boshllëku ose mangësie të mundshme të të dhënave dhe si mund të adresohen ato boshllëqe dhe mangësi.⁶

GJ. Ambienti i pastër kibernetik: integrimi i sigurisë kibernetike në të gjitha hapat e ciklit jetësor të IA-së është shumë i rëndësishëm; disa elemente bazë të sigurisë janë, janë si më poshtë:

- sulmet kibernetike;
- përditësimi i niveleve të rregullimit të sistemit;
- çelësa dhe fjalëkalimeve të mbrojtura;
- kontrole të forta aksesit;
- plan reagimi ndaj incidenteve kibernetike.

H. Zinxhiri i furnizimit: përveç parimeve të gjera të higjienës kibernetike të mësipërme, poseduesi dhe përdoruesit e sistemit IA duhet të

⁴ <https://www.ncsc.gov.uk/files/Guidelines-for-secure-AI-system-development.pdf>

⁵ <https://aistandardshub.org/resource/main-training-page-example/2-different-types-of-standards/>

⁶ <https://artificialintelligenceact.eu/wp-content/uploads/2024/02/ALA-Trilogue-Coreper.pdf>



aplikojnë, gjithashtu, zinxhirin e furnizimit të burimeve që shërbejnë për funksionimin e këtij sistemi.

3. Standardet etike në zhvillimin e inteligjencës artificiale⁷

A. Përputhshmëria dhe minimizimi i dëmeve: përdorimi i sistemeve të inteligjencës artificiale nuk duhet të tejkalojë atë që është e nevojshme për të arritur një qëllim të ligjshëm.

B. Siguria: dëmtimet (risqet e sigurisë), si dhe vulnerabilitetet ndaj sulmeve të evitohen dhe adresohen nga aktorët e inteligjencës artificiale.

C. Të drejtat për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave: privatësia të mbrohet dhe të promovohet gjatë gjithë ciklit të inteligjencës artificiale nëpërmjet strukturave të përshtatshme për mbrojtjen e të dhënave. Përdorimi i sistemeve të inteligjencës artificiale në Republikën e Shqipërisë duhet të jenë konform dhe të zbatojë rregullat dhe parimet e parashikuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ç. Qeverisja dhe bashkëpunimi: pjesëmarrja e të interesuarve të ndryshëm është e nevojshme për qasje përfshirëse në qeverisjen e inteligjencës artificiale.

D. Përgjegjësia dhe llogaridhënia: sistemet e inteligjencës artificiale të jenë të auditueshme dhe të gjurmueshme nëpërmjet mekanizmeve të mbikëqyrjes, vlerësimit të ndikimit, auditimit dhe mekanizmeve të kujdesit të duhur për të evituar konflikte me normat e të drejtave të njeriut dhe kërcënime ndaj mirëqenies mjedisore.

DH. Transparenca dhe shpjegueshmëria: Zhvillimi etik i sistemeve të inteligjencës artificiale varet nga transparenca dhe shpjegueshmëria e tyre. Niveli i këtyre të dyjave të jetë i përshtatshëm për kontekstin.

E. Mbikëqyrja njerëzore dhe vendosmëria: institucionet të sigurojnë që sistemet e inteligjencës artificiale nuk zëvendësojnë përgjegjësinë dhe llogaridhënien përfundimtare njerëzore.

Ë. Ndërgjegjësimi: edukimit gjithëpërfshirës, aftësimit digjital dhe trajnimit në përdorimin etik të inteligjencës artificiale, si dhe publikimit në media.

F. Drejtësia dhe mosdiskriminimi: avantazhet e inteligjencës artificiale janë të arritshme për të gjithë, janë të drejta dhe mosdiskriminuese.

KREU III PARIMET⁸

Në një epokë ku teknologjia po avancon me shpejtësi dhe intelijenca artificiale po bëhet një pjesë e pandarë e jetës së përditshme të qytetarëve, është e rëndësishme të kemi udhëzime dhe rregulla të qarta që të sigurojmë përdorimin etik dhe drejtë të kësaj teknologjie të fuqishme. Për këtë arsye, duhet të hartohen parimet e inteligjencës artificiale, që synojnë të rregullojnë përdorimin e IA-së në mënyrë etike dhe të drejtë.

1. Parimet e vlerave

Parimi 1.1: Rritja e qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe mirëqenia e qytetarëve

Ky parim thekson potencialin e inteligjencës artificiale për të kontribuar në rritjen dhe prosperitetin e përgjithshëm, për të avancuar objektivat e zhvillimit kombëtar dhe global.

Ky parim njeh se udhëzimi i zhvillimit dhe përdorimit të inteligjencës artificiale drejt mirëqenies dhe rezultateve të favorshme për njerëzit dhe vendin është një prioritet. Intelijenca artificiale e besueshme luan një rol të rëndësishëm në avancimin e rritjes inkluzive, zhvillimin e qëndrueshëm të mirëqenies dhe në objektivat e zhvillimit kombëtar. Ndër të tjera, në arritjen e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në fusha, si arsimi, shëndetësia, transporti, bujqësia, mjedisi dhe qytetet e qëndrueshme.

Ky parim, gjithashtu, njeh se sistemet e inteligjencës artificiale mund të konsolidojnë paragjykimet ekzistuese dhe të kenë një ndikim të ndryshëm në popullatat me risk më të lartë për t'u paragjykuar, si minoritetet etnike, gratë, personat me aftësi ndryshe, fëmijët, të moshuarit dhe ata me arsim më të ulët.

Parimi 1.2: Vlerat e orientuara nga njeriu dhe drejtësia

Sistemet e inteligjencës artificiale duhet të jenë të projektuar në mënyrë që të respektojnë sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut, vlerat demokratike dhe diversitetin dhe duhet të përfshijnë mbrojtjet e duhura për të siguruar një shoqëri të drejtë dhe të ndershme.

Aktorët e IA-së duhet të respektojnë sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe vlerat demokratike gjatë

⁷ <https://www.unesco.org/en/artificial-intelligence/recommendation-ethics>

⁸ <https://oecd.ai/en/ai-principles>



gjithë ciklit jetësor të sistemit të IA-së. Këto vlera përfshijnë lirinë, dinjitetin dhe autonominë, privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave, të drejtat e qytetarëve, pronësinë intelektuale dhe të drejtat tregtare, mosdiskriminimin dhe barazinë, diversitetin, drejtësinë shoqërore dhe të drejtat ligjore të punës. Për këtë qëllim, aktorët e IA-së duhet të zbatojnë mekanizma dhe mbrojtje, të garantojnë më çdo rast mundësinë për vendimmarrje njerëzore dhe të përshtaten sipas kontekstit të sektorit ku ato zbatohen ose funksionojnë.

Duke i qëndruar besnik vlerave të përbashkëta demokratike, ky parim do të ndihmojë në forcimin e besimit të publikut në IA dhe do të garantojë përdorimi i IA-së për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe për të reduktuar diskriminimin ose rezultatet tjera të padrejta dhe/ose të pabarabarta.

Ky parim, gjithashtu, njeh rolin e masave, si dhe vlerësimeve të ndikimit të të drejtave të njeriut, vendimmarrjes njerëzore (pra, “njeriu mbi çdo gjë”), kodeve të sjelljes etike ose shënimeve dhe certifikatave, të cilat synojnë të promovojnë vlerat e orientuara nga njeriu dhe drejtësinë.

Parimi 1.3: Transparenca dhe shpjegueshmëria

Ky parim ka të bëjë me transparencën dhe dhënien e informacionit në lidhje me sistemet e IA-së për të siguruar që përdoruesit të interpretojnë të dhënat e prodhuara të saj, si dhe të kuptojnë kur janë duke komunikuar me sistemet IA dhe të kenë mundësinë të “sfidojnë” rezultatet.

Aktorët e inteligjencës artificiale duhet të angazhohen në transparencë dhe përgjegjshmëri në lidhje me sistemet e inteligjencës artificiale. Për këtë qëllim, ata duhet të sigurojnë informacion të kuptueshëm, të përshtatshëm për kontekstin ku ato zbatohen dhe në përputhje me zhvillimet më të fundit të teknologjisë:

- për të nxitur një kuptim të përgjithshëm të sistemeve të IA-së;
- për të bërë përdoruesit e interesuar të kenë vetëdije për ndërveprimet e tyre me sistemet e IA-së, përfshirë edhe në vendin e punës;
- për të mundësuar ata që preken nga një sistem IA të kuptojnë rezultatin; dhe
- për të mundësuar ata që preken negativisht nga një sistem IA të sfidojnë rezultatin e tij, bazuar në informacion të qartë dhe të lehtë perceptueshëm

mbi faktorët dhe logjikën që shërbyen si bazë për parashikimin, rekomandimin ose vendimin.

Parimi 1.4: Qëndrueshmëria, siguria dhe mbrojtja

Sistemet e IA-së duhet të funksionojnë në një mënyrë të qëndrueshme, të sigurt dhe të mbrojtur gjatë gjithë jetëgjatësisë së tyre dhe rreziqet potenciale duhet që vazhdimisht të vlerësohen dhe menaxhohen.

Sistemet e IA-së duhet të jenë të qëndrueshme, të sigurta dhe të mbrojtura gjatë gjithë ciklit të tyre të jetës, duke parashikuar që në kushte të përdorimit normal, keqpërdorimit ose kushteve të tjera jo të përshtatshme, ato funksionojnë në mënyrë adekuate dhe nuk sjellin rrezik të papërballueshëm për sigurinë.

Aktorët e IA-së duhet të aplikojnë, në bazë të rolit të tyre, situatës dhe aftësisë së tyre për të vepruar, një qasje sistematike të menaxhimit të rrezikut për çdo fazë të ciklit të sistemit të IA-së në një bazë të vazhdueshme për të adresuar rreziqet lidhur me sistemet e IA-së, duke përfshirë privatësinë, sigurinë digjitale dhe mbrojtjen.

Ky parim, gjithashtu, përcakton se sistemet e IA-së nuk duhet të sjellin rrezik të papërballueshëm për sigurinë, përfshirë sigurinë fizike, në kushte të përdorimit normal ose keqpërdorimit gjatë gjithë ciklit të tyre të jetës.

Aktorët e IA-së mund të përdorin një qasje të menaxhimit të rrezikut për të identifikuar dhe mbrojtur nga keqpërdorimi i parashikueshëm, si dhe nga rreziqet e lidhura me përdorimin e sistemeve të IA-së për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë projektuar fillimisht. Çështjet e qëndrueshmërisë, sigurisë dhe mbrojtjes së IA-së janë të lidhura për të mbajtur sistemet e IA-së të qëndrueshme, të sigurta dhe të mbrojtura. Ato zbatohen në dy principe:

1. Gjurmimi, analiza dhe hetimi i mëtejshëm; dhe
2. Aplikimi i një qasjeje të menaxhimit të rrezikut.

Ashtu sikurse shpjegueshmëria (shih parimin 1.3), gjurmimi mund të ndihmojë analizën dhe hetimin e rezultateve të një sistemi IA dhe është një mënyrë për të promovuar përgjegjshmërinë. Gjurmimi ndryshon nga shpjegueshmëria në faktin se fokusi është në mbajtjen e regjistrave të tipareve të të dhënave, si metadata, burimet e të dhënave dhe pastrimi i të dhënave, por jo domosdoshmërisht të dhënat vetë. Në këtë mënyrë, gjurmimi mund të ndihmojë në kuptimin e rezultateve, në paranda-



limin e gabimeve të ardhshme dhe në përmirësimin e besueshmërisë së sistemit të IA-së.

Qasja e menaxhimit të rrezikut:

Një qasje e menaxhimit të rrezikut do të aplikohet gjatë gjithë ciklit të sistemit të IA-së për të ndihmuar në identifikimin, vlerësimin, përdorimin e prioriteteve dhe zbutjen e rreziqeve potenciale, që mund të ndikojnë negativisht në sjelljen dhe rezultatet e një sistemi.

Kufizime⁹:

a) vendosja në treg e një sistemi IA, i cili përdor teknika autonome të cilat manipulative ose teknika mashtruese dhe që synojnë efektin e ndryshimit të sjelljes së individëve, duke i dëmtuar gjykimin për një vendimarrje të informuar dhe duke i shkaktuar dëm të konsiderueshëm.

b) vendosja në treg ose vënia në shërbim ose përdorimi i një sistemi IA, që shfrytëzon ndonjë nga dobësitë e individëve, për shkak të moshës së tyre, paaftësisë ose një situatë specifike sociale ose ekonomike, me qëllim ose efekt të shtrembërimit material të sjelljes që i përket këtyre individëve, e cila mund të shkaktojë dëm të konsiderueshëm tek ata ose të tjerët.

c) vendosja në treg ose vënia në shërbim e sistemit IA për qëllim specifik, duke përdorur karakteristika fizike të individëve për të kategorizuar këta individë sipas racës, gjinisë, opinionet politike, besimin fetar, jetës seksuale ose orientimit seksual.

ç) vendosja në treg ose vënia në shërbim ose përdorimi i sistemeve të IA-së për vlerësimin ose klasifikimin e individëve për një periudhë të caktuar të kohës, bazuar në sjelljen e tyre shoqërore ose personale të njohura ose karakteristika të personalitetit të tyre, të cilat çojnë në:

i. trajtimin e dëmshëm ose të pafavorshëm të individëve në aspektin social, që nuk kanë lidhje me të dhënat, janë generuar ose mbledhur fillimisht;

ii. trajtimin e dëmshëm ose të pafavorshëm të individëve në mënyrë të pajustificuar ose në disproporcion me sjelljen e tyre shoqërore.

Parimi 1.5: Përgjegjshmëria

Institucionet publike, organizatat, bizneset dhe individët që zhvillojnë, implementojnë ose operojnë sisteme IA duhet të mbajnë përgjegjësi për funksionimin e tyre të duhur në përputhje me parimet e kësaj metodologjie, bazën ligjore përkatëse dhe vlerat njerëzore e shoqërore.

Aktorët e IA-së duhet të jenë përgjegjës për funksionimin e duhur të sistemeve të IA-së dhe për respektimin e parimeve të mësipërme, bazuar në rolin e tyre, situatën dhe përgjegjshmërinë për zhvillimet më të fundit të teknologjisë.

Në këtë rast “përgjegjësia” ka të bëjë me prirjen që institucionet publike, bizneset, organizatat ose individët do të sigurojnë funksionimin e duhur, gjatë gjithë jetëgjatësisë së tyre, të sistemeve IA që ata projektuan, zhvilluan, operuan ose implementuan, në përputhje me rolin e tyre dhe kornizat ligjore të zbatueshme, dhe për t’i dëshmuar këto gjëra nëpërmjet veprimeve dhe proceseve të tyre të vendimarrjes (për shembull, duke ofruar dokumentacion mbi vendimet kyçe gjatë ciklit të sistemit të IA-së ose duke lejuar auditimin kur është i arsyetueshëm).

2. Parimet organizative dhe teknike

Parimi 2.1: Investimi në hulumtimin dhe zhvillimin e inteligjencës artificiale (IA)

Do të konsiderohen investimet publike afatgjata dhe investimet private në hulumtim dhe zhvillim, duke përfshirë përpjekjet ndërdisiplinore për të nxitur inovacionin në fushën e inteligjencës artificiale të besueshme, duke u fokusuar në sfidat teknike dhe në çështjet sociale, ligjore dhe etike të lidhura me inteligjencën artificiale dhe çështjet e politikave. Gjithashtu, do të konsiderohen investimet publike dhe inkurajohen investimet private në të dhënat e hapura, duke respektuar privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave, për të mbështetur një mjedis për hulumtim dhe zhvillim në fushën e inteligjencës artificiale, që zbaton parimet etike dhe përmirëson interoperabilitetin dhe përdorimin e standardeve.

Zbulimet shkencore të mundësuar nga intelijenca artificiale mund të ndihmojnë në zgjidhjen e sfidave shoqërore dhe të krijojnë industri të reja në mënyrë të plotë. Këto mundësi theksojnë rëndësinë e kërkimit bazik dhe të konsiderimit të horizonteve të gjata kohore në politikën e kërkimit. Ky lloj investimi është i domosdoshëm për të shtyrë dhe përcaktuar inovacionin e inteligjencës artificiale të besueshme dhe për të siguruar rezultate të dobishme për të gjithë, veçanërisht për zonat që kanë vend për përmirësim në aspektin e investimeve të drejtuara nga kërkesa e tregut. Kërkimi në fushën e inteligjencës artificiale përfshin studime mbi

⁹ <https://artificialintelligenceact.eu/documents/>



aplikacionet e inteligjencës artificiale, si: procesimi i gjuhës natyrore; teknikat për mësimin e sistemeve të inteligjencës artificiale, si rrjetet neurale; optimizimi, në veçanti për të reduktuar sasinë e të dhënave të nevojshme për zhvillimin e inteligjencës artificiale, siç është parimi i mbledhjes së të dhënave dhe studimet që adresojnë konsideratat shoqërore, si transparenca dhe shpjegueshmëria, si dhe teknologjitë për të mbrojtur integritetin e të dhënave.

Përveç kësaj, për shkak të rëndësisë së të dhënave për ciklin e jetës së sistemeve të inteligjencës artificiale, një element kyç në sigurimin e hulumtimit të mëtejshëm dhe më të mirë të inteligjencës artificiale është disponueshmëria e seteve të të dhënave të hapura, të arritshme dhe të përfaqësueshme që nuk kompromentojnë privatesinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe të konsumatorëve, të drejtat e pronësisë intelektuale dhe të drejtat e tjera të rëndësishme. Veçanërisht, ndërsa është e pamundur të arrihet një mjedis krejtësisht “me të dhëna etike”, duke ofruar (dhe duke dhënë incentiva) për grupe të dhënash që janë përfaqësuese dhe të disponueshme publikisht, qeveria mund të ndihmojë në zvogëlimin e rreziqeve të përmbajtjeve joetike, të padobishme në sistemet e inteligjencës artificiale.

Parimi 2.2: Nxitja e një ekosistemi digjital për inteligjencën artificiale

Ky lloj ekosistemi përfshin në mënyrë të veçantë teknologjitë digjitale dhe infrastrukturën, si dhe mekanizmat për ndarjen e njohurive të inteligjencës artificiale, sipas nevojës. Në këtë kontekst, aktorët e IA-së duhet të marrin në konsideratë promovimin e mekanizmave, siç janë “*data trusts*”, për të mbështetur ndarjen e të dhënave në mënyrë të sigurt, të drejtë, ligjore dhe etike.

Zhvillimi i inteligjencës artificiale të besueshme kërkon një ekosistem lehtësues.

Teknologjitë digjitale dhe infrastruktura e nevojshme përfshijnë qasjen në rrjetet dhe shërbimet e internetit të shpejtësisë së lartë, fuqinë e kompjuterizimit dhe ruajtjen e të dhënave – si dhe teknologjitë që gjenerojnë të dhëna si interneti i gjërave (IoT). Gjithashtu, janë të nevojshme mekanizmat e përshtatshëm për ndarjen e njohurive të inteligjencës artificiale, duke përfshirë të dhënat, kodin, algoritmet, modelet, studimet dhe njohuritë, për të kuptuar dhe marrë pjesë në ciklin e jetës së sistemit të inteligjencës artificiale. Këto mekanizma

duhet të respektojnë privatesinë, pronën intelektuale dhe të drejtat e tjera. Mjetet e ardhura nga burime të hapura për menaxhimin dhe përdorimin e inteligjencës artificiale, të cilat lejojnë përhapjen e teknologjisë së inteligjencës artificiale dhe gjetjen e zgjidhjeve të *software*-ve, përmes të ashtuquajturit “*crowdsourcing*”, luajnë një rol kyç në zhvillimin e inteligjencës artificiale.

Parimi 2.3: Krijimi i një mjedisi politik lehtësues për inteligjencën artificiale

Ky rekomandim përqendrohet në mjedisin politik që mundëson inovacionin në fushën e inteligjencës artificiale, pra kornizat institucionale, politike dhe ligjore. Duke marrë parasysh ritmin e shpejtë të zhvillimeve në fushën e inteligjencës artificiale, krijimi i një mjedisi politik që është fleksibël aq sa të mund të ndjekë zhvillimet dhe të promovojë inovacionin, por që mbetet i sigurt dhe siguron mbrojtjen ligjore është një sfidë e rëndësishme. Në nxitjen e përdorimit të inteligjencës artificiale duhet të ndiqet një qasje që është orientuar drejt njeriut.

Aktorët e IA-së duhet të promovojë një mjedis politik që mbështet një kalim të shpejtë nga faza e kërkimit dhe e zhvillimit në fazën e implementimit dhe të operimit të sistemeve të besueshme të inteligjencës artificiale. Për këtë qëllim, do të merret parasysh përdorimi i pilotimit për të ofruar një mjedis të kontrolluar, ku sistemet e inteligjencës artificiale mund të testohen dhe, sipas nevojës, të shtrihen në masë më të madhe.

Qasja e kornizave politike dhe rregullative, si dhe mekanizmat e vlerësimit të tyre që aplikohen në sistemet e inteligjencës artificiale për të nxitur inovacionin dhe konkurrencën në fushën e inteligjencës artificiale të besueshme duhet të jenë objekt përmirësimi dhe përshtatjeje të vazhdueshme.

Theksohet roli i eksperimentimit si një mjet për të krijuar mjedise të kontrolluara dhe transparente, në të cilat sistemet e inteligjencës artificiale mund të testohen dhe në të cilat modelet e biznesit të bazuar në inteligjencën artificiale që mund të promovojnë zgjidhje për sfidat kombëtare mund të zhvillohen. Eksperimentet politike mund të operojnë në “mënyrë *start-up*”, ku eksperimentet janë të implementuara, të vlerësuara dhe të modifikohen e pastaj shtrihen ose zvogëlohen apo ndërpriten, në varësi të rezultateve të testit.

**Parimi 2.4: Ndërtimi i kapacitetit njerëzor dhe përgatitja për transformimin e tregut të punës**

Do të jetë në fokus kryesor fuqizimi i njerëzve për të përdorur dhe për të ndërvepruar efektivisht me sistemet e inteligjencës artificiale nëpër shumëllojshmëri aplikimesh, duke përfshirë pajisjen e tyre me shkathtësitë dhe njohuritë e nevojshme.

Inteligjenca artificiale do të ndryshojë natyrën e shumë aspekteve të jetës, duke u përhapur nëpër sektorë. Kjo është veçanërisht e vërtetë në kontekstin e punës, punësimit dhe vendit të punës – ku inteligjenca artificiale do të përfundojë me rolin e njeriut në disa detyra, do t'i zëvendësojë ato në detyra të tjera dhe do të krijojë lloje të reja të punës dhe organizimit të punës.

Kjo përfshin aftësitë e nevojshme të praktikantëve të inteligjencës artificiale (të cilat aktualisht mungojnë) dhe ato që nevojiten për punonjësit e tjerë (si mjekët etj.) për të marrë përfitim nga inteligjenca artificiale në fushat e tyre të ekspertizës, në mënyrë që IA-ja të shtojë aftësitë njerëzore. Paralelisht, politikat e zhvillimit të aftësive do të duhet të përqendrohen në aspektet e veçanta humane të nevojshme për të shfrytëzuar sistemet e inteligjencës artificiale, si vlerësimi, mendimi krijues e kritik dhe komunikimi.

Gjithashtu, ndryshimet e drejtuara nga inteligjenca artificiale në tregun e punës mund të kërkojnë përshtatjen ose pranimin e standardeve të punës dhe të marrëveshjeve midis drejtuesve dhe punonjësve, kur është e aplikueshme, për të reflektuar këto ndryshime, adresuar sfidat e mundshme për barazi, diversitet dhe drejtësi (siç paraqiten, për shembull, nga mbledhja dhe procesimi i të dhënave) dhe për të përforcuar vendet e punës të besueshme, të sigurta dhe produktive. Kjo mund të arrihet përmes një kombinimi rregullimi, dialogut social dhe bisedave kolektive. Është e rëndësishme të lejohet fleksibiliteti në vendin e punës duke ruajtur autonominë dhe cilësinë e punës për punëtorët.

Parimi 2.5: Bashkëpunimi ndërkombëtar për inteligjencën artificiale të besueshme

Palët e interesuara duhet të bashkëpunojnë aktivisht për të avancuar këto parime dhe për të përparuar në menaxhimin e përgjegjshëm të inteligjencës artificiale të besueshme.

Bashkëpunimi ndërkombëtar përfshin përparimin dhe përhapjen e implementimit të këtyre parimeve dhe politikave me të gjitha vendet partnere dhe jo vetëm, duke përfshirë vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim, si dhe vendet më pak të zhvilluara, dhe me palët e tjera të interesuara.

Bashkëpunimi ndërkombëtar mund të përdorë forume ndërkombëtare dhe rajonale për të ndarë njohuritë mbi inteligjencën artificiale në mënyrë që të ndërtohet një ekspertizë e gjerë mbi këtë fushë; për të zhvilluar standarde teknike për inteligjencën artificiale që janë ndërveprues dhe të besueshëm; dhe për të zhvilluar, përhapur dhe përdorur parametra matës për të vlerësuar performancën e sistemeve të inteligjencës artificiale, si: saktësia, efikasiteti, përparimi i qëllimeve shoqërore, drejtësisë dhe qëndrueshmërisë. Bashkëpunimi ndërkombëtar, gjithashtu, mund të kontribuojë në përpunimin e sasive të mëdha të të dhënave mbi parimin e besueshmërisë, duke ruajtur sigurinë, privatësinë, pronën intelektuale, të drejtat e njeriut, vlerat demokratike dhe që janë të rëndësishme për inovacionin e inteligjencës artificiale.

KREU IV SFIDAT DHE RISQET

1. Vlefshmëria dhe besueshmëria¹⁰: Që sistemet e IA-së të jenë të besueshme, ato shpesh duhet t'i përgjigjen një sërë kriteresh që kanë vlerë për palët e interesuara.

Vlefshmëria është “konfirmimi, nëpërmjet ofrimit të provave objektive, se kërkesat për një përdorim apo aplikim specifik të synuar janë përmbushur”. Implementimi i sistemeve të IA-së që janë të pasaktë, jo të besueshëm ose të ndërtuar në mënyrë jo të duhur për të mbrojtur të dhënat, rrit risqet e sistemeve të IA-së dhe redukton besueshmërinë. Besueshmëria përcaktohet në të njëjtin standard si “aftësia e një artikulli për të performuar”, siç kërkohet, pa dështim, për një interval kohor të caktuar, në kushte të dhëna.

Matjet e saktësisë duhet të shoqërohen gjithmonë me grupe testesh të përcaktuara qartë dhe realiste, që janë përfaqësuese të kushteve të përdorimit të parashikuar që pritet të ndodhë në kushte reale dhe detaje rreth metodologjisë së

¹⁰ <https://nvlpubs.nist.gov/nistpubs/LA/NIST.LA.100-1.pdf>



testimit, këto duhet të përfshihen në dokumentacionin përkatës.

Matjet e saktësisë mund të përfshijnë ndarjen e rezultateve për segmente të ndryshme të të dhënave.

Grupet e testimit teknik duke përdorur praktikat më të mira të analizës së performancës duhet të jenë të mirëpërcaktuara në çdo fazë të implementimi dhe përditësimi dhe në fazën e mirëmbajtjes së sistemeve IA.

Vlefshmëria dhe besueshmëria për sistemet e inteligjencës artificiale të implementuara shpesh vlerësohen nga testimi ose monitorimi i vazhdueshëm, që konfirmon se një sistem po funksionon, siç është parashikuar dhe ndërtuar që të funksionojë dhe, gjithashtu, në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Përpjekjet për menaxhimin e rrezikut të IA-së duhet të kenë prioritet minimizimin e ndikimeve të mundshme negative dhe mund të kenë nevojë të përfshijnë ndërhyrjen njerëzore në rastet kur sistemi i IA-së nuk mund të zbulojë ose korrigjojë automatikisht gabimet e tij.

Qëndrueshmëria ose përgjithësimi përkufizohet, si: “aftësia e një sistemi për të ruajtur nivelin e tij të performancës në rrethana të ndryshme”. Qëndrueshmëria është një qëllim për funksionalitetin e duhur të sistemit në një grup të gjerë kushtesh dhe rrethanash, duke përfshirë përdorime të sistemeve të IA-së të parashikuara që në fillim të dizenjimit të tij. Qëndrueshmëria kërkon jo vetëm që sistemi të funksionojë saktësisht, siç funksionon në përdorimet e parashikuara, por, gjithashtu, duhet të funksionojë në mënyrë të tillë që të minimizojnë efektet negative të mundshme për njerëzit nëse funksionon në një mjedis të parashikuar që në dizenjimin e sistemit.

Besueshmëria ka për qëllim korrektësinë e përgjithshme të funksionimit të sistemit IA-së në kushtet e përdorimit të pritshëm për një periudhë të caktuar kohe, duke përfshirë të gjithë jetëgjatësinë e sistemit¹¹. Saktësia dhe qëndrueshmëria kontribuojnë në vlefshmërinë dhe besueshmërinë e sistemeve të IA-së dhe mund të jenë në tension me njëri-tjetrin në sistemet e IA-së. Saktësia përkufizohet nga ISO/IEC TS 5723:2022, si: “afërsi e rezultateve të vëzhgimeve, llogaritjeve ose vlerësimeve me vlerat e vërteta ose vlerat e pranura si të vërteta”.

Qasjet që rrisin besueshmërinë e IA-së mund të zvogëlojnë risqet negative të IA-së. Në këtë metodologji përcaktohen karakteristikat të besueshme të IA-së, si më poshtë:

- të vlefshme dhe të besueshme;
- të sigurta dhe elastike;
- të përgjegjshme dhe transparente;
- të shpjegueshme dhe të interpretueshme;
- të përmirësuara nga privatësia;
- të drejta.

Karakteristikat e besueshmërisë janë të lidhura ngushtë me sjelljen sociale dhe organizative, grupet e të dhënave të përdorura nga sistemet e IA-së, përzgjedhjen e modeleve dhe algoritmeve të IA-së dhe vendimet e marra nga ata që i ndërtojnë ato.

Krijimi i sistemeve IA-së të besueshme kërkon balancimin e secilës prej këtyre karakteristikave, bazuar në kontekstin e përdorimit të sistemit të IA-së. Ndërsa të gjitha karakteristikat janë attribute të sistemit socioteknik, llogaridhënia dhe transparenca lidhen, gjithashtu, me proceset dhe aktivitetet e brendshme të një sistemi IA dhe mjedisin e tij të jashtëm. Neglizhenca e këtyre karakteristikave mund të rrisë probabilitetin dhe ndikimin e pasojave të mundshme negative.

Gjykimi njerëzor duhet të përdoret kur vendoset për elementet matës specifike, që lidhen me karakteristikat e besueshmërisë së IA dhe limitet e pranueshme të pragut për ato elemente.

2. Siguria dhe elasticiteti: sistemet e IA-së nuk duhet “në kushte të përcaktuara”, të çojnë në rezultate në të cilën jeta, shëndeti, prona ose mjedisi i njeriut është i rrezikuar.

A. Funksionimi i sigurt i sistemeve të IA-së përmirësohet nëpërmjet:

- praktikave të përgjegjshme të projektimit, zhvillimit dhe implementimit;
- informacion të qartë për implementuesit mbi përdorimin e përgjegjshëm të sistemit;
- vendimmarrje e përgjegjshme nga implementuesit dhe përdoruesit fundorë;
- shpjegimet dhe dokumentacioni i risqeve bazuar në dëshmi të matshme të incidenteve.

Llojet e ndryshme të risqeve të sigurisë mund të kërkojnë qasje të përshtatura të menaxhimit të riskut bazuar në kontekstin dhe nivelin e kritikalitetit të tyre. Risqet e sigurisë të nivelit të lartë që mund të shkaktojnë lëndime serioze kërkojnë prioritizimin

¹¹ Page 13 NIST LA 100-1 LA RMF 1.0



më urgjent dhe procesim më të plotë të menaxhimit të rrezikut.¹²

Qasjet e menaxhimit të rrezikut të sigurisë së IA-së duhet të ndjekin udhëzimet për sigurinë në fusha të tilla, si transporti, kujdesi shëndetësor dhe fusha të tjera të rëndësishme të jetës shoqërore dhe ekonomike, të cilat përputhen me bazën ligjore në fuqi dhe me udhëzimet ose standardet më të mira ndërkombëtare të sektorit.

Sistemet e IA-së, si dhe ekosistemet në të cilat ato vendosen, mund të thuhet se janë elastike nëse mund t'i rezistojnë ngjarjeve të padëshiruara të papritura ose ndryshimeve të papritura në mjedisin ku ato funksionojnë ose në mënyrën e përdorimit të tyre ose nëse mund të ruajnë funksionet dhe strukturën e tyre përballë problemeve të brendshme. Shqetësimet e zakonshme të sigurisë kanë të bëjnë me sulmet kibernetike, dëmtimin e të dhënave, dëmtimin e pronës intelektuale etj.

Sistemet e IA-së duhet të ruajnë konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë përmes mekanizmave mbrojtës që parandalojnë aksesin dhe përdorimin e paautorizuar që të konsiderohen të sigurt. Siguria dhe qëndrueshmëria janë karakteristika të lidhura, por të dallueshme. Ndërsa elasticiteti është aftësia për t'u rikthyer në funksionin normal pas një ngjarjeje të padëshiruar dhe të papritur.

Siguria përfshin elasticitetin, por gjithashtu përfshin protokolle për të shmangur, mbrojtur, për t'u përgjigjur ose për t'u rikuperuar nga sulmet.

3. Përgjegjshmëria dhe transparencia: Inteligjenca artificiale e besueshme varet nga përgjegjësia.

Llogaridhënia presupozon transparencë. Transparenca pasqyron shkallën në të cilën informacioni për një sistem IA dhe rezultatet e tij është i disponueshëm për institucionet, bizneset dhe qytetarët që ndërveprojnë me një sistem të tillë. Transparenca kuptimplote siguron akses në nivelet e duhura të informacionit, bazuar në fazën e ciklit jetësor të IA-së dhe të përshtatur me rolin ose njohuritë e aktorëve ose individëve të IA-së, që ndërveprojnë ose përdorin sistemin e IA-së. Duke promovuar nivele më të larta transparence rrjedhimisht rritet besimi në sistemet e IA-së. Shtrirja e kësaj karakteristike varet nga mënyra e

konceptimit dhe dizenjimit të sistemit përpara implementimit të tij.

Transparenca është shpesh e nevojshme për korrigjimin e veprimit në lidhje me rezultatet e sistemit të IA-së që janë të pasakta ose çojnë në ndikime negative. Transparenca duhet të marrë në konsideratë ndërveprimin njeri-IA.¹³

Roli i aktorëve të IA-së duhet të merret parasysh kur kërkohet llogaridhënie për rezultatet e sistemeve të IA-së. Marrëdhënia midis riskut dhe llogaridhënies që lidhet me IA dhe sistemet teknologjike ndryshon gjerësisht sipas konteksteve kulturore, ligjore, sektoriale dhe shoqërore. Kur pasojat janë të rënda, si për shembull, kur jeta dhe liria janë në rrezik, zhvilluesit dhe implementuesit e IA-së duhet të konsiderojnë rregullimin proporcional dhe proaktiv të praktikave të tyre të transparencës dhe llogaridhënies.

Zbatimi i praktikave organizative dhe strukturore për reduktimin e dëmtimeve të mundshme, menaxhimin e riskut, do të ndihmojë në përdorimin e sistemeve në mënyrë më të përgjegjshme. Masat për të rritur transparencën dhe llogaridhënien do të marrin në konsideratë ndikimin e këtyre përpjekjeve në njësinë zbatuese. Mjetet e transparencës janë të gjitha elementet manuale ose automatike, të cilat si pjesë integrale e një sistemi IA ose si pjesë e dokumentimit të këtij të fundit, garantojnë që të gjithë përdoruesit e sistemit të jenë të vetëdijshëm për llojin e të dhënave që përpunohen, mënyrën sesi përpunohen dhe mekanizmat që përdoren për të gjeneruar rezultatet. Këto mjete implementohen nga zhvilluesit e sistemeve IA, të cilët mund të zhvillojnë sisteme të IA-së në interes të tyre ose për përdorim nga palë të treta të cilat mund të jenë subjekte publike ose private. Zhvilluesit e sistemeve IA janë të gjithë personat fizikë ose juridikë, publikë apo privatë që nisur si rezultat i një kërkesë apo procedure ose me iniciativën e tyre ndërtojnë (zhvillojnë) një sistem të IA-së.

Zhvilluesit janë një nga aktorët e të ciklit jetësor të sistemeve të IA-së. Ndërkohë, që në tërësi aktorët janë të gjithë subjektet që në një fazë të ciklit jetësor të sistemeve IA ndërveprojnë, ndërtojnë, zhvillojnë apo përdorin këto sisteme.

4. Fokusimi drejt privatësisë: Privatësia u referohet normave dhe praktikave që ndihmojnë në ruajtjen e autonomisë, identitetit dhe dinjitetit

¹² Page 14 NIST LA 100-1 LA RMF 1.0.

¹³ Page 15 NIST LA 100-1 LA RMF 1.0.



njerëzor. Këto norma dhe praktika zakonisht trajtojnë ndërhyrjet e paautorizuara, marrjen e aprovimit të individëve për të dhënë pëlqimin për aksesin ose kontrollin e aspekteve të identitetit të tyre (p.sh., trupi, të dhënat, reputacioni).

Vlerat e privatesisë si anonimiteti, konfidencialiteti dhe kontrolli në përgjithësi duhet të udhëheqin zgjedhjet për hartimin, zhvillimin dhe vendosjen e sistemit të IA-së. Risqet e lidhura me privatesinë mund të ndikojnë në sigurinë dhe paragjykimet. Sistemet e IA-së mund të paraqesin gjithashtu risqe të reja për privatesinë, duke lejuar identifikimin e individëve përmes informacioneve, të cilët më parë ishin private.

KREU V UDHËZIME

Këto udhëzime synojnë të maksimizojnë përfitimet e IA-së, të minimizojnë rrezikun dhe të sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kjo metodologji përcakton qartë se përgjegjësia kryesore për sistemet e IA-së do të jetë tek ato subjekte publike apo private që financojnë, që zhvillojnë dhe që implementojnë këto sisteme.¹⁴

E drejta për transparencë. Të gjithë individët kanë të drejtë të informohen nëse sistemi që ata kanë në përdorim ka të implementuar inteligjencën artificiale. Gjithashtu, në rastin e gjenerimit ose të ndryshimit të të dhënave, të cilat ngjasojnë me persona, objekte vende ose entitete ose evente të tjera, dhe për përdoruesin ngjasojnë si të vërteta apo autentike, duhet të informojnë që përmbajtja është e gjeneruar apo manipuluar artificialisht.¹⁵

E drejta për vendimarrje njerëzore. Të gjithë individët kanë të drejtën e një vendimi përfundimtar të bërë nga një person human, pavarësisht sugjerimit të bërë nga sistemi i IA-së.

Vlerësimi dhe detyrimi i përgjegjshmërisë. Një sistem IA duhet të implementohet vetëm pas një vlerësimi adekuat të qëllimit dhe objektivave të tij, përfitimeve të tij, si dhe risqeve të tij.

Detyrimet e saktësisë, besueshmërisë dhe vlefshmërisë. Sistemi IA duhet të sigurojë saktësinë, besueshmërinë dhe vlefshmërinë e vendimeve të propozuara.

Detyrimi i fikjes. Subjekti që ka krijuar një sistem IA ka një detyrim afirmativ për të fikur

sistemin, nëse kontrolli njerëzor i sistemit nuk është më i mundur.

KREU VI MONITORIMI I IMPLEMENTIMIT TË INTELIGJENCËS ARTIFICIALE

Ky monitorim synon të sigurojë një vlerësim të hollësishëm të përputhjes së politikave kombëtare të inteligjencës artificiale (IA) me standardet ndërkombëtare të propozuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian, OECD-ja dhe ato që mund të miratohen në të ardhmen, si dhe organizma të tjerë në të cilët bën pjesë Republika e Shqipërisë. Procesi i monitorimit do të kryhet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), ministrinë dhe institucionet e tjera përgjegjëse.

Monitorimi konsiston në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave përkatëse mbi performancën e sistemeve të IA-së gjatë gjithë jetëgjatësisë, duke siguruar përshtatje të vazhdueshme me kërkesat rregullatore, në përputhje dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Plani i monitorimit, i detajuar në dokumentacionin teknik, do të hartohet me dispozita dhe elemente specifike, në përputhje me përcaktimet në rregullat e Bashkimit Evropian mbi IA-në.

Ofruesit e sistemeve IA mund të integrojnë elemente të këtij plani në sistemet ekzistuese në rrethana të caktuara për të minimizuar dyfishimin dhe ngarkesat, për sa kohë që ruhet një nivel ekuivalent mbrojtjeje.

Metodologjia e IA-së do të monitorohet nga grupi i punës i ngritur nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, me urdhër të drejtorit të përgjithshëm.

Procesi i monitorimit do të jetë i përshtatshëm dhe i rregullt, me vlerësime periodike dhe vjetore që do të shqyrtojnë progresin dhe sfidat në zbatimin e politikave të IA-së. Kjo përbën një angazhim të vazhdueshëm për sigurimin e zbatimit të përshtatshëm dhe të suksesshëm të politikës së inteligjencës artificiale në Shqipëri, duke ndjekur standardet dhe udhëzimet e ofruara nga organizmat ndërkombëtarë.

¹⁴ <https://thepublicvoice.org/LA-universal-guidelines/>

¹⁵ <https://artificialintelligenceact.eu/wp-content/uploads/2024/02/ALA-Trilogue-Coreper.pdf>



URDHËR

Nr. 554, datë 22.7.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PESTËS SË
RUMINANTËVE TË VEGJËL TË
SHFAQUR NË SHTETIN E GREQISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nga i gjithë territori i Republikës së Greqisë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit të ruminantë të vegjël dhe ruminantë të vegjël të egër;

b) materialit biologjik dhe embrioneve të pa shoqëruara me test diagnostik PCR të rezultuar negativ, i bashkëlidhur certifikata shëndetësore veterinare, të kryer 21 ditë para mbledhjes së tyre;

c) mishit dhe produkteve të mishit të patrajtuar termikisht minimalisht me një temperaturë 70°C për të paktën 30 minuta;

d) qumështit dhe produkteve të qumështit të patrajuara termikisht minimalisht me një temperaturë 72°C për 15 sekonda (temperaturë e lartë me pasterizim me kohë të shkurtër HTST) e pa aplikuar 2 herë;

e) miellit të mishit dhe miellit të gjakut, kockave pa dhjam, thundrave, kthetrave dhe brirëve të patrajuara termikisht, minimalisht me një temperaturë 70°C për të paktën 30 minuta;

f) leshit, flokëve të cilët nuk kanë pësuar trajtimet e mëposhtme:

i. larje industriale, e cila konsiston në zhytjen e leshit në një sërë banjash me ujë, sapun dhe hidroksid natriumi (sode) ose hidroksid kaliumi (potasium);

ii. depilimi kimik me anë të gëlqeres së shuar ose sulfurit të natriumit;

iii. tymosje me formaldehyd në një dhomë të mbyllur hermetikisht për të paktën 24 orë;

iv. pastrim industrial i cili konsiston në zhytjen e leshit në një detergjent të tretshëm në ujë të mbajtur në 60–70°C;

v. ruajtja e leshit në 4°C për katër muaj, 18°C për katër javë ose 37°C për tetë ditë;

g) lëkurës së papërpunuar dhe lëkurën e ruminantëve të vegjël të pa trajtuar për të paktën 28 ditë me kripë (NaCl) që përmban 2% karbonat natriumi (Na₂CO₃);

h) trofeve të gjuetisë dhe preparateve të destinuara për muze nga ruminantët e vegjël të papërpunuara, të pathara plotësisht dhe që kanë gjurmë të lëkurëve, mishit ose tendinave ose janë të pa dezinfektuar në mënyrë adekuate;

i) produkteve me origjinë shtazore për përdorim farmaceutik ose kirurgjikal, të kafshëve të llojit ruminantë të vegjël që nuk janë përpunuar për të siguruar shkatërrimin e virusit të pestës së ruminantëve të vegjël.

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve të vegjël, ruminantëve të vegjël të egër, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe produkteve të mishit, qumështit dhe produkteve të qumështit, miellit të mishit dhe miellit të gjakut, kockave pa dhjam, thundrave, kthetrave dhe brirëve, leshit, flokëve, lëkurës së papërpunuar dhe lëkurës së ruminantëve të vegjël, trofeve të gjuetisë dhe preparateve të destinuara për muze nga ruminantët e vegjël, produkteve me origjinë shtazore për përdorim farmaceutik ose kirurgjikal, të kafshëve të llojit ruminantë të vegjël.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

**URDHËR****Nr. 555, datë 22.7.2024****PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PESTËS SË
RUMINANTËVE TË VEGJËL TË
SHFAQUR NË SHTETIN E RUMANISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nga i gjithë territori i Republikës së Rumanisë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit të ruminantë të vegjël dhe ruminantëve të vegjël të egër;

b) materialit biologjik dhe embrioneve të pa shoqëruara me test diagnostik PCR të rezultuar negativ, i bashkëlidhur certifikata shëndetësore veterinare, të kryer 21 ditë para mbledhjes së tyre;

c) mishit dhe produkteve të mishit të patrajtuar termikisht, minimalisht me një temperaturë 70°C për të paktën 30 minuta;

d) qumështit dhe produkteve të qumështit të patrajuara termikisht, minimalisht me një temperaturë 72°C për 15 sekonda (temperaturë e lartë me pasterizim me kohë të shkurtër HTST) e pa aplikuar 2 herë;

e) miellit të mishit dhe miellit të gjakut, kockave pa dhjam, thundrave, kthetrave dhe brirëve të patrajuara termikisht, minimalisht me një temperaturë 70°C për të paktën 30 minuta;

f) leshit, flokëve të cilët nuk kanë pësuar trajtimet e mëposhtme:

i. larje industriale, e cila konsiston në zhytjen e leshit në një sërë banjash me ujë, sapun dhe hidroksid natriumi (sode) ose hidroksid kaliumi (potasium);

ii. depilimi kimik me anë të gëlqeres së shuar ose sulfurit të natriumit;

iii. tymosje me formaldehyd në një dhomë të mbyllur hermetikisht për të paktën 24 orë;

iv. pastrim industrial i cili konsiston në zhytjen e leshit në një detergjent të tretshëm në ujë të mbajtur në 60-70°C;

v. ruajtja e leshit në 4°C për katër muaj, 18°C për katër javë ose 37°C për tetë ditë.

g) lëkurës së papërpunuar dhe lëkurën e ruminantëve të vegjël të pa trajtuar për të paktën 28 ditë me kripë (NaCl) që përmban 2% karbonat natriumi (Na₂CO₃);

h) trofeve të gjuetisë dhe preparateve të destinuara për muze nga ruminantët e vegjël të papërpunuara, të pathara plotësisht dhe që kanë gjurmë të lëkurëve, mishit ose tendinave ose janë të padezinfektuar në mënyrë adekuate;

i) produkteve me origjinë shtazore për përdorim farmaceutik ose kirurgjikal, të kafshëve të llojit ruminantë të vegjël që nuk janë përpunuar për të siguruar shkatërrimin e virusit të pestës së ruminantëve të vegjël.

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të ruminantë të vegjël, ruminantë të vegjël të egër, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe produkteve të mishit, qumështit dhe produkteve të qumështit, miellit të mishit dhe miellit të gjakut, kockave pa dhjam, thundra, kthetrave dhe brirëve, leshit, flokëve, lëkurës së papërpunuar dhe lëkurës së ruminantëve të vegjël, trofeve të gjuetisë dhe preparateve të destinuara për muze nga ruminantët e vegjël, produkteve me origjinë shtazore për përdorim farmaceutik ose kirurgjikal, të kafshëve të llojit ruminantë të vegjël.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj**

**URDHËR****Nr. 556, datë 22.7.2024****PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PESTËS SË
RUMINANTËVE TË VEGJËL TË
SHFAQUR NË SHTETIN E TURQISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nga i gjithë territori i Republikës së Turqisë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve të vegjël dhe ruminantëve të vegjël të egër;

b) materialit biologjik dhe embrioneve të pashoqëruara me test diagnostik PCR të rezultuar negativ, i bashkëlidhur certifikata shëndetësore veterinare, të kryer 21 ditë para mbledhjes së tyre;

c) mishit dhe produkteve të mishit të patrajtuar termikisht minimalisht me një temperaturë 70°C për të paktën 30 minuta;

d) qumështit dhe produkteve të qumështit të pa trajtuara termikisht minimalisht me një temperaturë 72°C për 15 sekonda (temperaturë e lartë me pasterizim me kohë të shkurtër HTST) e pa aplikuar 2 herë;

e) miellit të mishit dhe miellit të gjakut, kockave pa dhjam, thundrave, kthetrave dhe brirëve të patrajtuara termikisht, minimalisht me një temperaturë 70°C për të paktën 30 minuta;

f) leshit, flokëve të cilët nuk kanë pësuar trajtimet e mëposhtme:

i. larje industriale, e cila konsiston në zhytjen e leshit në një sërë banjash me ujë, sapun dhe hidroksid natriumi (sode) ose hidroksid kaliumi (potasium);

ii. depilimi kimik me anë të gëlqeres së shuar ose sulfurit të natriumit;

iii. tymosje me formaldehyd në një dhomë të mbyllur hermetikisht për të paktën 24 orë;

iv. pastrim industrial i cili konsiston në zhytjen e leshit në një detergjent të tretshëm në ujë të mbajtur në 60–70°C;

v. ruajtja e leshit në 4°C për katër muaj, 18°C për katër javë ose 37°C për tetë ditë;

g) lëkurës së papërpunuar dhe lëkurës së ruminantëve të vegjël të pa trajtuar për të paktën 28 ditë me kripë (NaCl) që përmban 2% karbonat natriumi (Na₂CO₃);

h) trofeve të gjuetisë dhe preparateve të destinuara për muze nga ruminantët e vegjël të papërpunuara, të pathara plotësisht dhe që nuk kanë asnjë gjurmë të lëkurëve, mishit ose tendinave ose janë të padezinfektuar në mënyrë adekuate;

i) produkteve me origjinë shtazore për përdorim farmaceutik ose kirurgjikal, të kafshëve të llojit ruminantë të vegjël që nuk janë përpunuar për të siguruar shkatërrimin e virusit të pestës së ruminantëve të vegjël.

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të ruminantë të vegjël, ruminantë të vegjël të egër, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe produkteve të mishit, qumështit dhe produkteve të qumështit, miellit të mishit dhe miellit të gjakut, kockave pa dhjam, thundrave, kthetrave dhe brirëve, leshit, flokëve, lëkurës së papërpunuar dhe lëkurës së ruminantëve të vegjël, trofeve të gjuetisë dhe preparateve të destinuara për muze nga ruminantët e vegjël, produkteve me origjinë shtazore për përdorim farmaceutik ose kirurgjikal, të kafshëve të llojit ruminantë të vegjël.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj**



VENDIM

Nr. 50, datë 20.6.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Sandër Beci	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 20.6.2024
mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të
dokumenteve çështjen nr. 62 (A) 2023, që u përket:

KËRKUES: Anastas Risto, përfaqësuar nga
avokatët Arjan Salati dhe Genci Çifligu, me prokurë
të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Mehmet
Lamko, përfaqësuar nga avokat Arben Llapi.

Igli Maçi, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-
2152 (281), datë 3.5.2023, të Kolegjit Civil të
Gjykatës së Lartë, si i papajtuësëm me Kushtetutën
e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131, pika 1,
shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të
Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*);
neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e
Njeriut dhe Protokollin nr. 1 i saj; ligji nr. 8577, datë
10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e
Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,
i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori
në shqyrtim pretendimet e kërkesit Anastas Risto, i
cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e
subjektit të interesuar, Mehmet Lamko (*subjekt i
interesuar*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës,
konstatoi mungesën e parashtrimeve të subjektit
tjetër të interesuar, Igli Maçi, si dhe diskutoi çështjen
në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Anastas Risto (*kërkuesi*) ka lidhur me
subjektin e interesuar, Mehmet Lamko, (*sipërmarrës*)
kontratën e sipërmarrjes nr. 1758 rep., nr. 161 kol.,
datë 27.9.1999, për një apartament me sipërfaqe 134
m², pjesë e një pallati 8-katësh, ndërtimi i të cilit do
të fillonte më datë 1.9.1999 dhe do të përfundonte
më datë 2.4.2001. Vlera e apartamentit së bashku me
një garazh ishte 3.300.000 lekë dhe pagesa do të
bëhej e ndarë në katër këste.

2. Subjekti i interesuar e ka ndërtuar pallatin pa
marrë leje nga organet kompetente dhe ndërtimi ka
përfunduar në vitin 2004, vit në të cilin kërkuesi
rezulton se ka filluar ta përdorë atë. Subjekti i
interesuar ka pretenduar se kërkuesi nuk e ka shlyer
këstin e fundit (në shumën 1.300.000 lekë), si dhe ka
zënë një mjedis me sipërfaqe 42 m² (garazh) jashtë
kushteve kontraktuale, të cilin ia ka dhënë me qira
një personi të tretë, subjektit të interesuar, Igli Maçi.

3. Në këto rrethana, subjekti i interesuar i është
drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me
padi me objekt detyrimin e kërkesit për të shlyer
detyrimet që rridhnin nga kontrata e sipërmarrjes nr.
1758 rep., nr. 161 kol., datë 27.9.1999, pjesën e
papaguar për shitjen e shtëpisë (këstin e tretë) dhe
lirimin e sipërfaqes 20 m² të zënë jashtë kushteve
kontraktuale, si dhe detyrimin për të kthyer vlerat e
përfituara pa të drejtë, si dhe lirimin e mjedisit prej
42 m², për të cilin i padituri/kërkuesi kishte lidhur
kontratë qiraje me personin e tretë në gjykim,
subjektin e interesuar Igli Maçi.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me
vendimin nr. 8328, datë 16.7.2013, ka vendosur
pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë, duke detyruar
kërkuesin të lironte sipërfaqen 42 m², garazh në katin
përdhe në pallatin e ndërtuar nga subjekti i
interesuar, si dhe të kthente shumën 1.200.000 lekë
të përfutur në mënyrë të padrejtë nga dhënia me qira
e garazhit. Rrëzimin për pjesën tjetër të kërimit, për
pagimin e kështit të fundit, pasi paditësi nuk kishte
përbushur detyrimet që rridhnin nga kontrata e
sipërmarrjes nr. 1758 rep., nr. 161 kol., datë
27.9.1999. Për sa kohë që paditësi/subjekti i
interesuar, nuk kishte përbushur detyrimin
kryesor që kishte të bënte me ligjshmërinë e
ndërtimit të tij, nuk mund të kërkonte përbushjen



e detyrimit nga i padituri/kërkuesi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin edhe për kërkimin për lirim të sipërfaqes 20 m², pasi nuk u provua se kërkuesi kishte marrë 20 m² jashtë kushteve kontraktuale dhe pretendimet për këtë sipërfaqe mbetën të paprovuara me prova shkresore gjatë gjykimit. Nga përmbajtja e vendimit të gjykatës së shkallës së parë rezulton se banorët e pallatit të ndërtuar nga subjekti i interesuar, në të cilin banonte edhe kërkuesi, i janë drejtuar me shkresë Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave dhe Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) për të legalizuar ndërtimin pa leje dhe nga formulari i vetëdeklarimit të datës 14.11.2016 nuk rezultonte që kërkuesi të kishte garazh për të legalizuar, por nga lista rezultonte se ai kishte vetëm një apartament që kërkonte ta legalizonte.

5. Pas ankimit të paraqitur më datë 24.7.2013 nga kërkuesi, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 3539, datë 27.10.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 8328, datë 16.7.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për pjesën e rrëzimit të padisë dhe ndryshimin e vendimit për pjesën tjetër, duke vendosur rrëzimin e padisë për kërkimin e lirit të sipërfaqes 42 m², si dhe pagimin e fryteve civile nga përdorimi i sendit. Gjykata e Apelit Tiranë ka arsyetuar se paditësi/ subjekti i interesuar Mehmet Lamko, nuk ka arritur të provojë qenien pronar të sipërfaqes 42 m², kërkim për të cilin ka përdorur si bazë ligjore nenin 296 të Kodit Civil (KC), padinë e kërkimit të sendit (padinë e rivendikimit).

6. Subjekti i interesuar, Mehmet Lamko, më datë 14.11.2014 ka ushtruar rekurs. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në seancën gjyqësore të zhvilluar në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-2152 (281), datë 3.5.2023, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 3539, datë 27.10.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 8328, datë 16.7.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

7. Kërkuesi, më datë 19.12.2023, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Kolegji i Gjykatës më datë 19.3.2024 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

8. Më datë 22.2.2024, një nga gjyqtarët kushtetues ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i

çështjes, për shkak se ka qenë pjesë e trupit gjykues në Gjykatën e Apelit Tiranë. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e datës 27.2.2024, ka vendosur pranimin e kërkesës.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar:

9.1 *E drejta për t'u dëgjuar, mbrojtur, parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka njoftuar kërkuesit rekursin e paraqitur nga subjekti i interesuar. Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit gjyqësor vetëm mbi bazën e pretendimeve të paditësit, subjektit të interesuar të parashtruara në rekurs, pa dëgjuar dhe shqyrtuar pretendimet e kërkuesit, duke e vendosur në pozitë të pafavorshme në raport me palën tjetër. Gjykata e Lartë ka shkelur rregullat procedurale, pasi nuk ka njoftuar zhvillimin e seancës gjyqësore në asnjë nga format e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile (KPC), edhe pse Gjykata e Lartë i kishte të gjitha të dhënat e kërkuesit ose mbrojtësit të tij. Në këtë mënyrë, kërkuesi, duke mos u njoftuar për zhvillimin e gjykimit të çështjes së tij në seancë gjyqësore, është vënë në pamundësi për të paraqitur pretendimet e tij për çështjen.

9.2 *E drejta e pronësisë e lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke shfuqizuar vendimin e gjykatës së apelit dhe duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, ka bërë interpretim arbitrar të ligjit material dhe procedural, nëpërmjet të cilit i ka cenuar kërkuesit të drejtën substanciale të pronës, duke favorizuar subjektin e interesuar dhe urdhëruar kërkuesin të kthente një mjedis për të cilin subjekti i interesuar nuk figuronte të ishte pronar. Subjekti i interesuar nuk ka paraqitur titullin e pronësisë për pronën e pretenduar dhe njëkohësisht nuk ekziston asnjë veprim juridik për fitimin e së drejtës së pronësisë. Gjykata e shkallës së parë pa verifikuar legjitimitetin e paditësit ka arritur në konkluzion për pranimin e padisë, duke arsyetuar se kërkuesi mban sendin në mënyrë të paligjshme. Paditësi/subjekti i interesuar ka paraqitur një padi rivendikimi dhe ka pasur barrën e provës për të provuar të drejtën e pronësisë, veçanërisht mënyrën e fitimit të saj dhe Gjykata e Lartë nuk ka verifikuar



ekzistencën e vlefshmërisë së titullit të pronësisë dhe as nëse ekzistonte një i tillë.

10. **Subjekti i interesuar, Mehmet Lamko**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

10.1 Pretendimi *për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar, mbrojtur, si dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit* është i pabazuar, pasi gjatë gjykimit të çështjes si në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit palët kanë qenë të pranishme, duke paraqitur argumente dhe prova. Në këto kushte, pretendimi se Gjykata e Lartë ka vendosur mbi bazën e provave të paraqitura vetëm nga një palë nuk qëndron. Për gjykimin e çështjes në dhomën e këshillimit, tashmë Gjykata ka një qëndrim të konsoliduar.

10.2 Pretendimi *për cenimin e së drejtës së pronësisë është i pabazuar*, pasi kërkuesi nuk e ka blerë garazhin dhe kjo është provuar me një sërë dokumentesh shkresore, si: konfirmimi nga njësia bashkiake i datës 27.11.2014, me të cilin provohet fakti se shtetasi B.V. (përfaqësues i subjektit të interesuar) ka paraqitur vetëdeklarimin për legalizimin e pallatit dhe referuar listës së banorëve që kanë blerë pasuri në atë objekt, emri i kërkuetit është shënuar vetëm te pjesa e apartamenteve, por jo në pjesën e mjediseve të shërbimit. Në përfundim të procesit të legalizimit dhe regjistrimit të objektit në tërësi, subjekti interesuar ka lidhur pranë noterit kontratat e shitjes me secilin nga porositësit, duke përfshirë edhe kërkuetin, me të cilin ka lidhur kontratën nr. 2123 rep., nr. 712 kol., datë 2.4.2021 për shitjen e apartamentit me sipërfaqe 158.50 m², me çmimin total prej 3.300.000 lekësh, që, bazuar në përmbajtjen e kontratës, është pranuar nga kërkuesi se është likuiduar prej vitit 2000 dhe palët nuk kanë asnjë pretendim juridikofinanciar ndaj njëri-tjetrit. Aktualisht të gjitha apartamentet dhe njësitë e shërbimit rezultojnë në pronësi të personave të tretë. Subjekti i interesuar, me kontratën nr. 2348 rep., nr. 1059 kol., datë 4.8.2020, i ka shitur shtetasit Igli Maçi njësinë garazh (objekt i mosmarrëveshjes civile). Kontrata është regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe certifikata e pronësisë është në emër të shtetasit Igli Maçi dhe bashkëshortes së tij. Për sa kohë që pretendimet e palëve janë rregulluar nëpërmjet akteve noteriale dhe pasuria objekt gjykimi rezulton në emër të subjektit të interesuar Igli Maçi, kërkuesi nuk ka më të drejta të ligjshme për pronën për të mbrojtur në rrugë gjyqësore.

11. **Subjekti i interesuar, Igli Maçi**, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, megjithëse është njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuetit

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

13. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, sepse është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

14. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 12, datë 24.5.2022; nr. 5, datë 22.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Rregulli i shterimit të mjeteve juridike nënkupton jo vetëm që kërkuesi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme, përpara se t'i drejtohet Gjykatës, por edhe që të gjitha pretendimet (shkaqet) që ngre në këtë



Gjykatë, t'i ketë paraqitur më parë në të gjitha instancat e zakonshme gjyqësore, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 38, datë 12.7.2023; nr. 33, datë 1.11.2021; nr. 8, datë 19.3.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ai e plotëson këtë kriter, pasi nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

16. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, duke iu referuar shkresës nr. 443/1 prot., datë 29.1.2024 të Gjykatës së Lartë, e cila ka informuar Gjykatën se vendimi nr. 00-2023-2152 (281), datë 3.5.2023, është publikuar në faqen zyrtare të kësaj gjykate më datë 19.10.2023, datë në të cilën palët mund ta dispononin atë, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë më 19.12.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

17. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Civil të Gjykatës së Lartë i ka cenuar të drejtën për t'u dëgjuar, mbrojtur dhe parimin e barazisë së armëve e kontradiktoritetit, si dhe të drejtën e pronësisë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

18. Gjykata vëren se pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar, mbrojtur dhe të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në Gjykatën e Lartë kërkuesi e ka parashtruar në dy drejtime: i) për mosnjoftimin e rekursit të paraqitur nga subjekti i interesuar, duke mos i krijuar mundësi për të paraqitur pretendimet e tij për çështjen; ii) për mosnjoftimin e datës së seancës gjyqësore me asnjë nga format e njoftimit të parashikuara nga KPC-ja.

19. Në lidhje me pretendimin për mosnjoftimin e rekursit, Gjykata vëren se është parashtruar në përmbajtjen e ankimit kushtetues individual të datës 19.12.2023. Nga përmbajtja e dosjes gjyqësore është konstatuar se Gjykata e Lartë ia ka njoftuar rekursin kërkuesit dhe dëftesa e komunikimit është nënshkruar nga vetë ai. Në këto rrethana, kërkuesit i është kërkuar të japë shpjegime lidhur me

nënshkrimin e dëftesës së komunikimit të rekursit. Në vijim të njoftimit, Gjykata ka konstatuar se kërkuesi nuk ka dhënë asnjë shpjegim për nënshkrimin e dëftesës së njoftimit të rekursit, si dhe nuk e ka përsëritur pretendimin në parashtrimet shtesë të paraqitura prej tij. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ai ka marrë dijeni rregullisht për rekursin dhe se fakti që çështja është gjykuar në dhomën e këshillimit, nuk e ka penguar për të parashtruar argumentet e tij nëpërmjet kundërrekursit.

20. Gjithashtu, edhe për pretendimin se Gjykata e Lartë ka shkelur rregullat procedurale duke mos e njoftuar për zhvillimin e seancës në asnjë nga format e parashikuara nga KPC-ja, nga përmbajtja e dosjes gjyqësore rezulton se Gjykata e Lartë e ka realizuar njoftimin për ditën, orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues, duke e afishuar si në këndin e njoftimeve në mjediset fizike, ashtu edhe në faqen elektronike të saj. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar e mbrojtur dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit për shkak të mosnjoftimit të rekursit dhe të datës së seancës gjyqësore, është haptazi i papabuar.

21. Për pretendimet e tjera, për cenimin e së drejtës së pronësisë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se argumentet lidhen me procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj kërkuesit, çmon ta analizojë çështjen e paraqitur në këndvështrim të neneve 41 dhe 42 të Kushtetutës, sipas të cilave prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Në vijim, Gjykata, për të arritur në përfundimin nëse është cenuar e drejta e pronësisë, do të vlerësojë pretendimet në drejtim të respektimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, i cili hyn në juridiksionin dhe kompetencën e Gjykatës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor

22. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka bërë interpretim arbitrar të ligjit material dhe procedural, nëpërmjet të cilit i ka cenuar kërkuesit të drejtën substanciale të pronës, duke favorizuar subjektin e interesuar dhe duke urdhëruar kërkuesin të kthejë një mjedis për të cilin subjekti i interesuar nuk është pronar.



23. Subjekti i interesuar Mehmet Lamko, ka prapësuar se kërkuesi nuk e ka blerë garazhin dhe kjo provohet pasi pas përfundimit të procedurave të legalizimit, ai, me kontratën nr. 2123 rep., nr. 712 kol., datë 2.4.2021, ka blerë vetëm apartamentin me sipërfaqe 158.50 m², ndërsa njësia garazh i është shitur subjektit tjetër të interesuar Igli Maçi. Edhe gjatë procedurës për legalizimin e ndërtesës emri i kërkuesit është shënuar vetëm te pjesa e apartamenteve, por jo në pjesën e mjediseve të shërbimit.

24. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Me arsyetimin, gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive (*shih vendimet nr. 9, datë 27.2.2024; nr. 12, datë 15.3.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 8328, datë 16.7.2013, ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë të subjektit të interesuar, Mehmet Lamko, duke detyruar kërkuesin të lirojë sipërfaqen 42 m² (garazh në katin përdhe) në pallatin e ndërtuar nga subjekti i interesuar Mehmet Lamko dhe të kthejë shumën 1.200.000 lekë të përfutur në mënyrë të padrejtë nga dhënia me qira e garazhit, sipas kontratave të qirasë të lidhura në vitin 2006 dhe në vitin 2012; rrëzimin për pjesën tjetër të kërimit për pagimin e kështit të fundit, pasi paditësi/subjekti i interesuar, nuk kishte përmbushur detyrimet që rridhnin nga kontrata e sipërmarrjes nr. 1758 rep., nr. 161 kol., datë 27.9.1999. Për sa kohë që paditësi/subjekti i interesuar, nuk ka përmbushur detyrimin kryesor që ka të bëjë me ligjshmërinë e ndërtimit të tij, nuk mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga i padituri/kërkuesi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin edhe për kërkimin për lirim të sipërfaqes 20 m², pasi nuk u provua që kërkuesi e kishte poseduar këtë sipërfaqe.

26. Pas ankimit të paraqitur më datë 24.7.2013 nga kërkuesi në Gjykatën e Apelit Tiranë, kjo e fundit, me vendimin nr. 3539, datë 27.10.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 8328, datë 16.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

për pjesën e rrëzimit të padisë dhe ndryshimin e vendimit për pjesën tjetër, duke vendosur rrëzimin e padisë edhe për kërkimin për lirim të sipërfaqes 42 m² dhe pagimin e fryteve civile nga përdorimi i sendit. Gjykata e Apelit Tiranë ka arsyetuar se paditësi/ subjekti i interesuar, Mehmet Lamko, nuk ka arritur të provojë qenien pronar të sipërfaqes 42 m², kërkim për të cilin ka përdorur si bazë ligjore nenin 296 të KC-së, padinë e kërimit të sendit (padinë e rivendikimit).

27. Në vijim, pas rekursit të ushtruar nga subjekti i interesuar, Mehmet Lamko, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-2152 (281), datë 3.5.2023, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 3539, datë 27.10.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 8328, datë 16.7.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

28. Gjykata vëren se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se ka vend për ndryshimin e vendimit të gjykatës së apelit për sa i përket kërimit të paditësit/shtetasit Mehmet Lamko, për detyrimin e kërkuesit/palës së paditur për të kthyer garazhin me sipërfaqe 42 m², për rrjedhojë edhe vlerat e përfutura nga dhënia me qira të këtij mjedisi personit të tretë/subjektit të interesuar Igli Maçi. Ky kolegji ka arsyetuar se paditësi është ndërtues i të gjithë godinës, në të cilën banon edhe kërkuesi dhe ka detyrimin ligjor që të përgatisë dokumentacionin ligjor edhe për këtë mjedis ndihmës në pallat. Ndërtimi ka qenë pa leje dhe është bërë nga paditësi me investimin e tij dhe në bazë të nenit 32/a të KC-së ka interes të ligjshëm, pasi në cilësinë e investitorit i është drejtuar ALUIZNI-it për të legalizuar ndërtimin e pallatit. Kolegji ka parashtruar se kërkuesi ka lidhur kontratë sipërmarrjeje me paditësin, duke e njohur atë si ndërtuesin e pallatit dhe fakti që ndërtimi ka qenë pa leje nuk mund të legjitimojë të paditurin/kërkuesin të shfrytëzojë dhe të nxjerrë të ardhura nga sipërfaqe ndërtimi që nuk i takojnë. Kolegji ka vijuar në arsyetim se përderisa objekti është në proces legalizimi dhe objekti gëzon pritshmëri të ligjshme për t'u ligjëruar si ndërtim, për rrjedhojë, paditësi, si investitor i ndërtimit pa leje legjitimohet të marrë në dorëzim pasurinë në përputhje me ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" (*ligji nr. 9482/2006*) dhe se i padituri/kërkuesi ka qenë posedues me keqbesim



dhe nga viti 2006 ka vjelë nga prona objekt i mosmarrëveshjes të ardhura nga personat e tretë.

29. Gjykata ka pohuar në mënyrë konstante se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.5.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë standardet e mësipërme kushtetuese në raport me faktet e çështjes në shqyrtim, vlerëson se, në thelb, pretendimi i kërkuarit ka të bëjë me interpretimin e dispozitave të KC-së dhe të ligjit nr. 9482/2006 për zgjidhjen e mosmarrëveshjes civile. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë, brenda kompetencave kushtetuese të saj si gjykatë ligji, ka interpretuar ligjin dhe interpretimi konkret nuk rezulton të jetë haptazi i paarsyeshëm ose që të bjerë ndesh me konceptin e gjykimit të drejtë. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar. Në kushtet kur ndaj kërkuarit nuk ka pasur shkelje të së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe pretendimi i tij për cenimin e së drejtës së pronësisë është i pabazuar.

31. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, është i pabazuar, ndaj dhe kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “Y”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe

funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 20.6.2024.

Shpallur, më 23.7.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahim, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Marjana Semini

Anëtar kundër: Sandër Beci

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen që i përket kërkuarit Anastas Risto me objekt: “*Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-2152 (281), datë 3.5.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtuësëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*”, jam kundër qëndrimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës, pasi vlerësoj se ajo duhej të ishte pranuar. Për rrjedhojë, në vijim, në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000 që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese, do të parashtoj argumentet që mbështesin qëndrimin tim si gjyqtar në pakicë.

2. Në mënyrë të përmbledhur, nga rrethanat e çështjes rezulton se ndërmjet kërkuarit dhe subjektit të interesuar, Mehmet Lamko, është nënshkruar një kontratë sipërmarrjeje për një apartament me sipërfaqe 134 m². Pallati është ndërtuar nga subjekti i interesuar pa marrë leje nga organet kompetente dhe ndërtimi ka përfunduar në vitin 2004, ndërkohë që në kontratën e sipërmarrjes ishte parashikuar të përfundonte në vitin 2001. Subjekti i interesuar, duke pretenduar se kërkuari nuk ka shlyer këstin e fundit, si dhe ka zënë një mjedis me sipërfaqe 42 m² (garazh) jashtë kushteve kontraktuale, të cilën ia ka dhënë me qira një personi të tretë, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi rivendikimi. Objekti i kërimit ishte detyrimi i kërkuarit për të shlyer detyrimet që rridhnin nga



kontrata e sipërmarrjes, konkretisht pagesën e pjesës së papaguar për shitjen e apartamentit, lirim e sipërfaqes së zënë jashtë kushteve kontraktuale dhe kthimin e shumave të përfituara nga dhënia me qira e garazhit.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë së subjektit të interesuar, Mehmet Lamko, duke e detyruar kërkuuesin të lirojë sipërfaqen 42 m² në pallatin e ndërtuar nga subjekti i interesuar; të kthejë shumën 1.200.000 lekë të përfituara në mënyrë të padrejtë nga dhënia me qira e garazhit; rrëzimin e saj për pjesën e kërimit për pagimin e kështit të fundit të apartamentit, pasi subjekti i interesuar (paditësi) nuk kishte përmbushur detyrimet që rridhnin nga kontrata e sipërmarrjes. Sipas gjykatës së rrethit kontrata e sipërmarrjes nuk përfshinte edhe garazhin. Kërkuesi nuk i është drejtuar për legalizimin e tij ALUIZNI-it dhe nuk ka arritur të provojë pronësinë e tij për garazhin. Ndërsa subjekti i interesuar ka interes të ligjshëm, pasi i është drejtuar ALUIZNI-it për të legalizuar ndërtimin.

4. Pas ankimit të paraqitur nga kërkuesi, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për pjesën e rrëzimit të padisë dhe ndryshimin e vendimit për pjesën tjetër, duke vendosur rrëzimin e padisë edhe për kërkimin për lirim e sipërfaqes 42 m², si dhe pagimin e fryteve civile nga përdorimi i sendit. Gjykata e Apelit Tiranë ka arsyetuar se subjekti i interesuar, Mehmet Lamko, nuk ka arritur të provojë qenien pronar të sipërfaqes 42 m², kërkim për të cilin ka përdorur si mjet ligjor padinë e kërimit të sendit (padia e rivendikimit) të parashikuar në nenin 296 të KC-së.

5. Pas rekursit të ushtruar nga subjekti i interesuar, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në mënyrë të përmbledhur, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se nga palët është pranuar se ndërtimi pa leje është bërë nga subjekti i interesuar me investimin e tij. Sipas Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 32/a të KC-së subjekti i interesuar ka interes të ligjshëm, pasi ai në cilësinë e investitorit i është drejtuar ALUIZNI-it për të legalizuar ndërtimin e pallatit. Kërkuesi ka lidhur kontratë sipërmarrjeje me paditësin duke e njohur atë si ndërtuesin e pallatit.

Fakti që ndërtimi ka qenë pa leje nuk mund të legjitimohet kërkuuesin të shfrytëzojë dhe të nxjerrë të ardhura nga sipërfaqe ndërtimi që nuk i takojnë. Kolegji ka vijuar në arsyetim se përderisa objekti është në proces legalizimi dhe gëzon pritshmëri të ligjshme për t'u ligjësuar si ndërtim, për rrjedhojë, subjekti i interesuar si investitor i ndërtimit pa leje legjitimohet të marrë në dorëzim pasurinë në përputhje me ligjin nr. 9482/2006 dhe se kërkuesi ka qenë posedues me keqbesim dhe ka përfituar nga prona objekt i mosmarrëveshjes të ardhura nga personat e tretë (*shih paragrafin 19 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

6. Në këto rrethana, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankimin kushtetues individual, duke pretenduar cenimin e së drejtës së pronës si pasojë e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit për shkak të interpretimit arbitrar të bërë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Shumica, duke vlerësuar pretendimin për cenimin e së drejtës së pronës në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit, ka arritur në përfundimin se Gjykata e Lartë nuk e ka cenuar këtë standard. Nga faktet e çështjes në shqyrtim, shumica, duke vlerësuar se, në thelb, pretendimi i kërkuetit ka të bëjë me interpretimin e dispozitave të KC-së dhe të ligjit nr. 9482/2006 për zgjidhjen e mosmarrëveshjes civile, ka konkluduar se Gjykata e Lartë brenda kompetencave kushtetuese të saj si gjykatë ligji ka interpretuar ligjin dhe interpretimi konkret nuk rezulton të jetë haptazi i paarsyeshëm ose që bie ndesh me konceptin e gjykimit të drejtë. Prandaj, ajo ka çmuar se pretendimi i kërkuetit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor e, për rrjedhojë, edhe për cenimin e së drejtës së pronës, është i pabazuar (*shih paragrafin 30 të vendimit*).

7. Në ndryshim nga shumica, vlerësoj se pretendimi i kërkuetit për cenimin e së drejtës së pronës si pasojë e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit për shkak të interpretimit arbitrar të bërë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është i bazuar.

8. Sikurse thekson edhe shumica në jurisprudencën kushtetuese, Gjykata ka theksuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në



kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.5.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në çështjen konkrete, nga faktet e evidentuara më sipër, konstatohet se procesi gjyqësor i kundërshtuar me ankimin kushtetues individual është vënë në lëvizje nga subjekti i interesuar nëpërmjet një padie rivendikimi, sipas nenit 296 të KC-së, si padia kryesore për mbrojtjen e pronësisë, me anë të së cilës pronari ka kërkuar kthimin e sendit të vetë nga personi që e mbante atë pa shkak juridik. Për këtë lloj padie, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 5/2011 janë shprehur se njohja e pronësisë është kusht i domosdoshëm për pranimin e kërimit të sendit. Gjykata e shkallës së parë edhe pse analizon faktin se kërkuesi nuk ka provuar pronësinë tij për sipërfaqen prej 42 m², në lidhje me qenien ose jo pronar të subjektit të interesuar, ndalet vetëm në analizën e interesit të ligjshëm të tij nisur nga fakti se ai i është drejtuar për legalizimin e objektit ALUIZNI-it. Në këtë mënyrë gjykata e rrethit anashkalon kushtin e domosdoshëm për padinë e rivendikimit, atë të njohjes së pronësisë dhe jo të interesit të ligjshëm të paditësit. Ndërkohë, ndryshe nga ajo, gjykata e apelit, duke analizuar nëse në rastin konkret plotësoheshin kushtet e padisë së rivendikimit, ka arritur në përfundimin se subjekti i interesuar nuk e përmbushte këtë kriter. Edhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me arsyetimin e tij, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, edhe pse në dukje u ka dhënë përgjigje shkaqe të ngritura në rekurs, nuk ka analizuar në drejtim të zbatimit të ligjit material, se përse paditësi/subjekti i interesuar duhej të konsiderohej si pronar i sipërfaqes prej 42 m², në funksion të mjetit ligjor të përdorur, padisë së kërimit të sendit (padia e rivendikimit).

10. Në vlerësimin tim si gjyqtar në pakicë, në rastin konkret, Gjykata e Lartë duhej të arsyetonte për vlefshmërinë e titullit të pronësisë, pra nëse subjekti i interesuar legjitimohej për të ngritur padinë mbështetur në nenit 296 KC-së. Në kushtet kur nga

subjekti i interesuar gjatë gjykimit të çështjes nuk kishte paraqitur ndonjë akt për të provuar pronësinë e tij, qëndrimi i Gjykatës së Lartë që barazon interesin e ligjshëm për shkak të kërkesës për legalizimin e objektit me qenien pronar të tij, nuk përputhet me qëllimin e nenit 42 të Kushtetutës në drejtim të garantimit të së drejtës së pronës nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor.

11. Në këto kushte, në mendimin tim, në kontekst të rrethanave të rastit konkret, vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke u mjaftuar vetëm me analizën e interesit të ligjshëm të palës ndërgjyqëse që vë në lëvizje gjykatat e juridiksionit të zakonshëm me padi rivendikimi, pa i dhënë përgjigje të arsyetuar kushtit të domosdoshëm për ngritjen e asaj padie, qenies pronar të paditësit, të çon në përfundimin se zbatimi i ligjit material nga ajo gjykatë është haptazi i paarsyeshëm, duke ka cenuar të drejtën e pronës së kërkuarit.

12. Në përfundim, në zbatim të standardeve të vendosura nga jurisprudenca e Gjykatës dhe fakteve të natyrës kushtetuese, vlerësoj se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së pronës për shkak të arsyetimit arbitrar të vendimit Gjykatës së Lartë është i bazuar.

Anëtar: Sandër Beci

UDHËZIM

Nr. 1318, datë 18.7.2024

MODELI DHE MËNYRA E PLOTËSIMIT TË DOKUMENTACIONIT TEKNIK

Në mbështetje të nenit 28, germa “ç”, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; germës “c”, pika 2, e nenit 9 të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”; ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; neneve 17 dhe 69, pika 9 të tij, dhe pikës 22, kreu IV të VKM-së nr. 1178, datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje”,

UDHËZOJ:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i modeleve dhe mënyra e plotësimit të dokumenta-



cionit teknik që hartohet nga drejtoritë vendore të ASHK-së, sipas përditësimit në terren, gjatë realizimit të procedurave administrative të legalizimit të ndërtimeve pa leje në funksion të vendimmarjes së këtij procesi.

2. Në këtë udhëzim termat në vijim, kanë këtë kuptim:

a) “**Akt evidentimi në terren**”, sipas kuptimit të dhënë në germën “b”, të pikës 2, të kreut I të VKM-së nr. 1178, datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje”.

b) “**Funksion i ndërtimit pa leje**”, sipas kuptimit të dhënë në pikën 4, të nenit 4, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”.

c) “**Genplan**” është dokumenti teknik që hartohet, i cili pasqyron gjendjen e përditësuar të ndërtimit pa leje dhe parcelës ndërtimore në bazë të verifikimit të kryer në terren.

ç) “**Hartë vektoriale**” është harta bazë e prodhuar nga fotografimi ajror, mbi të cilën pasqyrohen matjet e kryera nga matjet në terren. Ky produkt përditësohet vazhdimisht sipas gjendjes ndërtimore të përditësuar në format elektronik dhe në *hard copy*.

d) “**Legalizim**”, sipas kuptimit të dhënë në pikën 9, të nenit 4, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”.

dh) “**Ndërtim pa leje**”, sipas kuptimit të dhënë në pikën 12, të nenit 4, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”.

e) “**Planimetri**” është dokumenti teknik që hartohet, i cili pasqyron gjendjen e përditësuar të ndërtimit pa leje të detajuar, sipas përmasave të çdo kati të objektit informal, sipas evidentimit në terren të gjendjes ndërtimore. Ky dokument ruhet në format digjital dhe *hard copy*.

f) “**Skicë fushore**”, sipas kuptimit të dhënë në germën “a”, të pikës 2, të kreut I, të VKM-së nr. 1178, datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje”.

3. Dokumentet teknik, genplan dhe planimetri objekti i këtij udhëzimi plotësohen, miratohen, arkivohen dhe lëshohen nga drejtoria vendore e ASHK-së në format digjital, si dokument elektronik,

bashkëlidhur vendimit të legalizimit të ndërtimit pa leje.

4. Dokumentet teknik (genplan dhe planimetri) që hartohen nga drejtoria vendore e ASHK-së gjatë procedurës administrative, administrohen dhe ruhen në praktikën dokumentare të vendimmarjes së legalizimit të ndërtimit pa leje, në përputhje me legjislacionin për arkivat.

II. PROCEDURA PËR HARTIMIN E DOKUMENTACIONIT TEKNIK

5. Drejtoritë vendore të ASHK-së, ose subjekti i autorizuar (sipas pikës 20 të VKM-së nr. 1178, datë 24.12.2020), gjatë procesit të evidentimit në terren të gjendjes ndërtimore të objektit pa leje, bazuar në hartën vektoriale të përfutur nga fotografimi ajror digjital, kryejnë matjet për plotësimin e aktit të evidentimit në terren dhe matje të tjera shtesë për hartimin e genplanit dhe planimetrisë. Matjet kryhen në mënyrë që të plotësojnë saktësinë e shkallës së hartës, si dhe kushtet teknike të përcaktuara në standardet e manualeve tekniko gjeodezike.

6. Matjet për hartimin e aktit të evidentimit në terren, në përgjithësi kryhen në vijueshmëri territoriale, bazuar në ndarjen e blloqeve/zonave kadastrale.

7. Të dhënat e ndërtimit pa leje të evidentuara, fillimisht shënohen në skicën fushore, e cila duhet të paraqesë qartë:

a) ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij;

b) përmasat e të gjitha elementeve (gjatësitë e kufizimeve të parcelës ndërtimore, përmasat e objektit, largësitë nga objekti të kufizimi i pronës, largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve);

c) funksionin e objektit;

d) hyrjen për në objekt;

dh) numri i kateve.

Skica fushore përpilohet manualisht në mënyrë të tillë, që të jetë e lexueshme, pa deformime, shmangie apo korrigjime të vijave.

8. Në skicën fushore shënohen:

a) emri, atësia, mbiemri dhe adresa e poseduesit;

b) emri, mbiemri dhe nënshkrimi i hartuesit; dhe

c) data e hartimit të saj.

Skica fushore nënshkruhet nga specialistët që kryen matjet në terren dhe është pjesë dokumentare e praktikës së legalizimit.

9. Në përfundim të matjeve në terren, specialistët e drejtorisë vendore të ASHK-së, ose subjektit të



autorizuar, pasqyrojnë në hartën vektoriale këto të dhëna dhe hartojnë materialet grafike si vijon:

- a) hartën vektoriale të përditësuar me ndërtimet pa leje;
- b) genplanin në shkallën (1:500, 1:1000, 1:2500);
- c) planimetritë në shkallën 1:100).

Këto dokumente prodhohen në formë digjitale dhe *hard copy* për efekt arkivimi.

III. MODELI I PARAQITJES SË GENPLANIT DHE STRUKTURA KOMPETENTE NË DREJTORINË VENDORE TË ASHK-SË PËR HARTIMIN E TIJ

10. Modeli i paraqitjes së genplanit është sipas modelit 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe hartohet në shkallën 1:500. Genplani hartohet në bazë të:

- a) të dhënave të aktit të evidentimit në terren dhe skicës fushore, shoqëruar me matjet në mënyrë të tillë që të mos ketë shmangie lineare më të madhe se $0.2 \text{ m/m} * SH$ (emëruesi i shkallës që hartohet genplani). P.sh. në shkallën 1:500 është 10 cm;
- b) informacionit mbi gjendjen juridike të pronësisë sipas regjistrave kadastrale ose dokumentacionit të pronësisë, të administruar në arkivin e DVASHK-së;
- c) rregullave mbi sipërfaqen e parcelës ndërtimore, të parashikuara në nenin 22, pika 3, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”.

Genplani hartohet dhe printohet në 3 (tri) kopje.

11. Genplani përbëhet nga pesë rubrika, që plotësohen sipas shembullit të paraqitur në modelin 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe kanë përmbajtje si vijon:

- a) **Në rubrikën e parë** përcaktohen:
 - i. drejtoria e vendore e ASHK-së, kompetente për legalizimin e ndërtimit pa leje;
 - ii. qarku në territorin e të cilit ngrihet ndërtimi pa leje;
 - iii. bashkia në territorin e të cilës ngrihet ndërtimi pa leje;
 - iv. zona kadastrale;
 - v. adresa e pasurisë (rruga etj.);
 - vi. indeksi i hartës;
 - vii. shkalla e përdorur në hartimin e gen-planit, e cila është 1:500;
 - viii. data e hartimit të gen-planit.
- b) **Rubrika e dytë** përmban këto të dhëna:
 - i. numrin unik (INDEX) të identifikimit, të marrë nga baza e të dhënave;

- ii. numrin e aplikimit për legalizim (formularit/kërkesës/deklaratës për përfshirje në procedurat e legalizimit);

- iii. numrin e pasurisë, bazuar në hartën ekzistuese kadastrale dhe në bashkëpunim me sektorin që administron regjistrin;

- iv. sipërfaqen e përgjithshme të parcelës ndërtimore (m^2);

- v. shënimi nëse prona ku ka gjurmën objekti informal është në pronësi të shtetit, të vetë poseduesit ose e një pronari tjetër;

- vi. sipërfaqen e bazës (gjurmës) së ndërtimit pa leje;

- vii. emrin, atësinë dhe mbiemrin e poseduesit të objektit pa leje.

c) Në rubrikën e tretë paraqitet plan-vendosja e objektit dhe e parcelës ndërtimore, si pjesë e hartës vektoriale të përditësuar të territorit. Elementet përbërëse të saj janë:

- i. katër koordinatat (sipas sistemit referues gjeodezik shqiptar KRGJSH) e fragmentit hartografik, në të cilin përfshihet parcela ndërtimore e objektit;

- ii. shenja orientuese e veriut (në anën e majtë lart);

- iii. plan-vendosja e objektit dhe kufijtë e parcelës ndërtimore, së bashku me ngrehinat funksionale, të pozicionuara në qendër të rubrikës;

- iv. hyrja në objekt dhe shenja lidhëse e objektit me parcelën ndërtimore;

- v. numri i pasurisë së ndërtimit dhe parcelës që legalizohet dhe numri i pasurive kufitare;

- vi. numri i kateve të objektit që legalizohet.

Për shtesat informale në ndërtime me leje, në këtë rubrikë do të paraqitet gjurma e ndërtimit ekzistues dhe gjurma e objektit shtesë. Këto dy sipërfaqe duhet të jenë të dallueshme nga njëra-tjetra.

ç) Në rubrikën e katërt paraqiten pasuritë kufitare me numrat përkatës, si dhe legjenda e genplanit, duke respektuar modelin me shenjat konvencionale që janë dhënë.

d) Rubrika e pestë përmban gjeneralitetet dhe nënshkrimet e specialistëve dhe përgjegjësve të Sektorit të Legalizimit, Çështjeve të Pronësisë dhe Proceseve Hartografike dhe të drejtorit të DVASHK-së, së bashku me vulën përkatëse. Në rastet e subjekteve të autorizuar, këto rubrika, do të plotësohen nga punonjësit/përfaqësuesit e këtyre subjekteve, të cilët mbajnë përgjegjësi për të dhënat



e pasqyruara në zbatim të dispozitave procedurale ligjore në fuqi.

12. Struktura kompetente në drejtoritë vendore të ASHK-së, për hartimin e genplanit, është përgjithësisht Sektori i Legalizimit, në raste të caktuara, do të jetë struktura e ngarkuar nga drejtori për kryerjen e kësaj procedure. Kjo strukturë është përgjegjëse për pozicionimin e saktë të ndërtimit informal dhe të parcelës ndërtimore, për saktësinë e përmasave, sipas të dhënave të aktit të evidentimit në terren, si dhe janë përgjegjës për evidentimin nëse ndërtimi përfshihet në fushën e zbatimit të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, në përputhje me nenet 17, pika 1, dhe 69, pika 9, të tij. Për këto të dhëna konkretisht është përgjegjës specialisti inxhinier në këtë sektor që është i ngarkuar për të kryer këto procedura. Gjithashtu, kjo strukturë është përgjegjëse për verifikimin dhe plotësimin e kriterëve të legalizimit të objekteve pa leje, procedurave dhe dokumentacionit për kualifikimin e ndërtimeve informale në zbatim të seksionit 1, të kreut III, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH” dhe të VKM-së nr. 1040/2020, “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit ...”. Për këto të dhëna konkretisht është përgjegjës specialisti përkatës në këtë sektor që është i ngarkuar për të kryer këto procedura.

Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit dhe Drejtori i DVASHK-së, mbajnë përgjegjësi sipas dispozitave të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Në rastin e subjekteve të autorizuar, sipas pikës 20, të VKM-së nr. 1178, datë 24.12.2020, përgjegjës për saktësinë e pasqyrimin të të dhënave të mësipërme, janë punonjësit/përfaqësuesit e subjektit privat të licencuar. Kjo përgjegjësi përcaktohet në kontratën e lidhur nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës me këto subjekte në përputhje me legjislacionin në fuqi.

13. Drejtoria përgjegjëse për procesin e legalizimit dhe drejtoria përgjegjëse për hartat pranë Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së, asistojnë drejtoritë vendore, në procesin e përgatitjes së genplaneve, duke vendosur në dispozicion çdo informacion dhe dokumentacion hartografik që disponojnë.

Ky informacion do të përdoret nga grupet e punës të ASHK-së dhe nga subjektet e autorizuar, për përditësimin në terren të pasurive që legalizohen.

IV. MODELI I PARAQITJES SË PLANIMETRISË SË OBJEKTIT DHE STRUKTURA KOMPETENTE NË DREJTORINË VENDORE TË ASHK-së PËR HARTIMIN E SAJ

14. Modeli i paraqitjes së planimetrisë së objektit është sipas modelit 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Planimetria e çdo kati hartohet në shkallën 1:100, në format A4/A3 (në qendër vendoset emërtimi i katit) dhe përbëhet nga katër rubrika:

i. Rubrika e parë përmban paraqitjen grafike të planimetrisë së katit përkatës me:

1. dimensionet totale dhe të pjesshme të objektit;
2. dimensionet e brendshme;
3. sipërfaqen e katit, të shtesës ose të ndarjeve funksionale.

Në rastin e një godine me më shumë se një funksion (banesë dhe funksion social-ekonomik), sipërfaqet e tyre duhet të paraqiten grafikisht të dallueshme nga njëra-tjetra.

ii. Në rubrikën e dytë paraqitet:

1. numri i fletës;
2. shkalla e planimetrisë.

iii. Në rubrikën e tretë jepen:

1. të dhënat e objektit;
2. emërtimi i fletës;
3. emri, atësia dhe mbiemri i poseduesit të objektit;
4. numri i dosjes së vetëdeklarimit;
5. data e hartimit të planimetrisë.

iv. Rubrika e katërt përmban:

1. Drejtorinë vendore të ASHK-së, gjeneralitet dhe nënshkrimi i drejtorit, si dhe vula.
2. Gjeneralitetet e specialistit që punon planimetrinë dhe përgjegjësit të Sektorit të Legalizimit, me nënshkrimet përkatëse.
3. Gjeneralitetet e specialistit i cili ka kryer azhurnimin në terren.

15. Planimetritë, do të hartohen në një nga programet inxhinierike.

16. Shkrimi i përdorur në të gjithë materialet grafike të jetë *Times New Roman*.

17. Struktura kompetente në drejtoritë vendore të ASHK-së, për hartimin e genplanit, është përgjithësisht Sektori i Legalizimit, në raste të caktuara, do të jetë struktura e ngarkuar nga drejtori për kryerjen e kësaj procedure. Për këto të dhëna konkretisht është përgjegjës specialisti inxhinier



përkatës në këtë sektor që është i ngarkuar për të kryer këto procedura.


V. PËRPUNIMI I HARTËS VEKTORIALE

18. Gjatë përpunimit të hartës vektoriale, të gjitha të dhënat strukturoren, sipas shtresave (*layer*) të paraqitura, si më poshtë:

Status	Name	On	Freeze	Lock	Color	Linetype	Lineweight	Transparency
✓	0	☹	☼	🔒	white	Continuous	Default	0
☞	01_KUFI PRONE	☹	☼	🔒	152	Continuous	Default	0
☞	02_KUFI_PRONE_NDERTESE	☹	☼	🔒	210	Continuous	Default	0
☞	03_NDERTESE	☹	☼	🔒	cyan	Continuous	Default	0
☞	04_SHENJA_LIDHESE	☹	☼	🔒	white	Continuous	Default	0
☞	05_NR_PASURIE	☹	☼	🔒	32	Continuous	Default	0
☞	06_NR_VETEDOKLARIMI	☹	☼	🔒	191	Continuous	Default	0
☞	07_HYRJE_NE_OBJEKT	☹	☼	🔒	blue	Continuous	Default	0
☞	08_NR_UNIK	☹	☼	🔒	100	Continuous	Default	0

01_KUFI_PRONE	Në këtë <i>Layer</i> futen kufijtë e parcelës ndërtimore. Në rastin kur si kufi parcele shërben njëra anë e rrugës, ngjyra e atij kufiri ndryshohet në të gjelbër
02_KUFI_PRONE_NDERTESE	Në rastin kur si kufi i parcelës ndërtimore shërben muri i një ndërtese, vija që përfaqëson edhe ndarjen si kufi parcele, por edhe si mur i një ndërtese vendoset në këtë <i>Layer</i>
03_NDERTESE	Kur ndërtesa gjendet brenda kontureve të parcelës ndërtimore, vija që përfaqëson ndërtesën vendoset në këtë <i>Layer</i>
04_SHENJA_LIDHESE	Për të identifikuar që ndërtesa është e lidhur me parcelën vendoset një shenjë lidhëse midis (~) parcelës ndërtimore dhe ndërtesës
05_NR_PASURIE	Në këtë <i>Layer</i> vendoset (tekst) numri i pasurisë sipas ZVRPP-së
06_NR_VETEDOKLARIMI	Në këtë <i>Layer</i> vendoset (tekst) numri i protokollit i aplikimit për legalizim
07_HYRJA_NE_OBJEKT	Në këtë <i>Layer</i> vendoset në formë pike pozicioni i kahjes së hyrjes në objekt. (Kjo nevojitet së tepërmi për të bërë analiza gjatë periudhës së studimeve urbanistike.)
08_NR_UNIK	Në këtë <i>Layer</i> vendoset numri unik i dosjes i gjeneruar nga baza digjitale e të dhënave

Më poshtë, paraqitet një shembull i cili tregon vendosjen në *layer*-at përkatës të elementeve të parcelës ndërtimore.



1.1 Paraqitja e konturit të jashtëm të planimetrisë në hartën vektoriale



Një element i hartës vektoriale është edhe gjurma e objektit të ndërtuar brenda parcelës ndërtimore.

Gjatë përpunimit të hartës vektoriale duhet pasur parasysh që gjurma e objektit të jetë identike me atë të planimetrisë së katit përdhës.

VI. MËNYRA E ADMINISTRIMIT DHE RUAJTJES SË DOKUMENTACIONIT TEKNIK

19. Hartimi i gen-planit do të bëhet në mënyrë automatike, bazuar në procedurat teknike të cilat mundësojnë integrimin e të dhënave vektoriale, në programin e hartuar për nxjerrjen e produktit.

20. Për azhurnimin e hartës vektoriale përdoren kryesisht programe inxhinierike. Harta vektoriale duhet të përpunohet, duke u bazuar në matjet e kryera, ose në hartën vektoriale të hartuar nga subjektet e autorizuar sipas pikës 20, të VKM nr. 1178/2020, “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje”.

21. Në rastet kur për objektet informale, drejtoria vendore e ASHK-së, miraton vendimin për legalizimin e ndërtimit pa leje, në zbatim të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH” dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të kreut III, seksioni 1, të këtij ligji, materiali digjital hartografik, përcillet pranë sektorit përkatës të drejtorisë vendore të ASHK-së, që ka në

fushë përgjegjësie veprimtarie të saj regjistrimin e këtij vendimi.

22. Materialet grafike (genplan dhe planimetri) printohen në tri kopje dhe ruhen në format digjital (CD). Drejtoritë vendore të ASHK-së, përcjellin në Drejtorinë e Përgjithshme në variantin digjital, hartën e përditësuar të objekteve informale, përditësojnë çdo muaj.

VII. RUAJTJA E TË DHËNAVE PLOTËSUESE

23. Për çdo parcelë ndërtimore do të krijohet një bazë të dhënash plotësuese, të grumbulluara në një tabelë *Excel*-i (sipas tabelës nr. 3 bashkëlidhur). Këto të dhëna do të lidhen në mënyrë automatike me parcelën ndërtimore respektive.

VIII. DISPOZITA TË FUNDIT

24. Udhëzimi i drejtorit të përgjithshëm nr. 30, datë 15.1.2016, “Për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së dokumentacionit teknik (genplan, planimetri)”, i ndryshuar, shfuqizohet.

25. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Dallëndyshe Bici



GENPLAN

DREJTORIA E ASHK :	_____	NUMRI UNIK (INDEKS):	06_____
QARKU:	_____	NR. I APLIKIMIT:	1
BASHKIA:	_____	NR. PASURISË:	9/310
ZONA KADASTRALE:	1234	SIPËRFAQE E PARCELËS NDËRTIMORE =	66.8
ADRESA E PASURISË:	_____	PR. SHTET = PO PR. E TË TRETËVE = JO PR. TË VET = JO	
INDEKSI I HARTËS:	A-11	SIPËRFAQE E BAZËS SË NDËRTIMIT =	47.5
SHKALLA:	1:500	POSEDUESI:	_____
DATA:	_____	emër	atesia mbiemër

x= 514947.25
y= 4433526.93

KRGJSH

x= 515037.25
y= 4433526.93


x= 514947.25
y= 4433461.09

x= 515037.25
y= 4433461.09

KUFITARËT:		Legjenda	
VERI	Nr.Pas 9/55		HYRJA NE OBJEKT
JUG	Nr.Pas 9/183		OBJEKTI
LINDJE	Nr.Pas 9/209		KUFI PARCELE
PERENDIM	Nr.Pas 9/56		
SEKTORI I LEGALIZIMIT:			
SPECIALIST	_____	SPECIALIST	_____
PËRGJEGJËS	_____		
DREJTOR / PËRFAQËSUES I SUBJEKTIT: _____			
emër		mbiemër	nënshkrimi



PLANIMETRIA E KATIT PERDHE



Sip. ndertimi 115.6 m²
Sip.banimi 115.6 m²

 ASHK AGJENCIA SHQIPTARE E KADASTRIT	Objekti: GODINE BANIMI 1 KAT		DREJTORIA VENDORE GJIROKASTËR DREJTORI :	nënshkrimi: Vula:
	Emertimi i fletes: PLANIMETRIA E KATIT PERDHE		Përgjegjësi i sektorit të Legalizimit:	nënshkrimi:
	Poseduesi:		Ing.	nënshkrimi:
	Nr. fletes: A - 1/1	Nr. dosjes vetdeklarimit :	Data:	punoi:
Shkalla: 1 : 100				



Nr. rendor	Nr. i aplikimit	Emri (i personit për të cilin është bërë vetëdeklarimi)	Atësia (e personit për të cilin është bërë vetëdeklarimi)	Mbiemri (i personit për të cilin është bërë vetëdeklarimi)	Data e vetëdeklarimit (dd/mm/yyyy)	Sip. e parcelës ndërtimore	Sipërfaqet			Nr. kateve	Funksioni/qëllimi			Kualifikohet (Po/Jo)	Data e identifikimit në terren (dd/mm/yyyy)	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Nomenklatura	Plan rregullues (PO/JO)	Shënime të ndryshme	Kufitaret				Parcelat kufi				Hartoi			Nr. unik	Nr. unik në dosje
							Sip. me kalim pronësie	Sip. është	Baza		Banesë	Funksion social-ekonomik	E kombinuar								Veri	Jug	Lindje	Perëndim	Veri	Jug	Lindje	Perëndim	Emër	Atësi	Mbiemër		
1	2	3	4	5	6	7	8		9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	21	24	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38
1																																	
2																																	
3																																	
4																																	
5																																	
6																																	
7																																	
8																																	
9																																	
10																																	
11																																	
12																																	
13																																	
14																																	



UDHËZIM

Nr. 1320, datë 18.7.2024

**PËR MIRATIMIN E
DOKUMENTACIONIT HARTOGRAFIK
QË HARTOHET PËR OBJEKTET PA
TITULL PRONËSIE, TRUALLIT TË
TYRE FUNKSIONAL DHE TË
OBORREVE NË PËRDORIM**

Në mbështetje të nenit 28 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; nenit 9 të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”; të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”, si dhe në zbatim të pikës 53, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 827, datë 30.9.2020, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme të pronësisë të objekteve pa titull pronësie, trojeve të tyre funksionale dhe oborreve në përdorim”,

UDHËZOJ:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë modelin dhe përmbajtjen e dokumentacionit hartografik që hartohet nga drejtoria vendore e ASHK-së, për objektet pa titull pronësie dhe trojeve të tyre funksionale, si dhe të oborreve në përdorim, në përfundim të procedurës administrative të kalimit të pronësisë, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 34, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”, dhe në VKM-në nr. 827, datë 30.9.2020, të ligjit nr. 20/2020, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme të pronësisë të objekteve pa titull pronësie, trojeve të tyre funksionale dhe oborreve në përdorim”.

2. Në këtë udhëzim termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “**Genplan**” është dokumenti teknik që hartohet nga ASHK-ja, në përputhje me standardet teknike, i cili pasqyron pozicionin gjeografik, kufijtë dhe përmasat e objektit dhe truallit funksional të tij, apo oborrit në përdorim, pas evidentimit faktik dhe matjeve në terren.

b) “**Planimetri**” është dokumenti teknik që hartohet, i cili pasqyron gjendjen e përditësuar të objektit të detajuar sipas përmasave të çdo kati, sipas evidentimit në terren të gjendjes ndërtimore.

**II. MODELI DHE PËRMBAJTJA E
GENPLANIT DHE PLANIMETRISË QË
HARTOHET PËR OBJEKTET PA TITULL
PRONËSIE, TRUALLIT TË TYRE FUNKSIONAL
APO OBORREVE NË PËRDORIM**

3. Modeli i paraqitjes së genplanit është sipas anekseve 1 dhe 2, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi. Ai i bashkëlidhet në çdo rast vendimit për pranimin e kërkesës për kalimin e pronësisë së objektit pa titull dhe truallit funksional të tij, apo oborrit në përdorim, që lëshon drejtoria vendore e ASHK-së. Ai hartohet e miratohet në format digjital, dhe një kopje e printuar ruhet në përputhje me legjislacionin për arkivat. Genplani ka në përmbajtje rubrikat me të dhënat si vijon:

a) **Në rubrikën e parë** përcaktohen:

i. Drejtoria e vendore e ASHK-së, kompetente për kryerjen e procedurës sipas VKM-së nr. 827/2020;

ii. qarku në territorin e të cilit ndodhet objekti pa titull, truall funksional/oborri në përdorim;

iii. bashkia në territorin e të cilës ndodhet objekti pa titull, truall funksional/oborri në përdorim;

iv. zona kadastrale;

v. adresa e pasurisë (rruga etj.);

vi. indeksi i hartës;

vii. shkalla e përdorur në hartimin e genplanit, e cila është 1:500;

viii. data e hartimit të genplanit.

b) **Rubrika e dytë** përmban këto të dhëna:

i. numrin unik (INDEX) të identifikimit, të marrë nga baza e të dhënave;

ii. numrin e aplikimit për kërkesën për kalimin e pronësisë për objektin pa titull, truallin funksional/oborrin në përdorim;

iii. numrin e pasurisë, bazuar në hartën ekzistuese kadastrale dhe në bashkëpunim me sektorin që administron regjistrin;

iv. sipërfaqen e përgjithshme të truallit funksional/oborrit në përdorim.(m²);

v. shënimi nëse prona ku ka gjurmën objekti, truall funksional/oborri në përdorim është në pronësi të shtetit, të vet poseduesit ose e një pronari tjetër;

vi. sipërfaqen e bazës (gjurmës) së ndërtimit;

vii. emrin, atësinë dhe mbiemrin e poseduesit të objektit.

c) **Në rubrikën e tretë** paraqitet plan-vendosja e objektit dhe e truallit funksional/oborrit në



përdorim, si pjesë e hartës vektoriale të përditësuar të territorit. Elementet përbërëse të saj janë:

i. katër koordinatat (sipas sistemit referues gjeodezik shqiptar KRGJSH) e fragmentit hartografik, në të cilin përfshihet parcela e truallit funksional/oborrit në përdorim;

ii. shenja orientuese e veriut (në anën e majtë lart);

iii. plan-vendosja e objektit dhe kufijtë e parcelës së truallit funksional/oborrit në përdorim;

iv. hyrja në objekt dhe shenja lidhëse e objektit me parcelën truallit funksional/oborrit në përdorim;

v. numri i pasurisë së ndërtimit dhe parcelës që do të kryhet kalimi i pronësisë dhe numri i pasurive kufitare;

vi. numri i kateve të objektit për të cilin kalohet pronësia.

ç) **Në rubrikën e katërt** paraqiten pasuritë kufitare me numrat përkatës, si dhe legjenda e genplanit, duke respektuar modelin me shenjat konvencionale që janë dhënë.

d) **Rubrika e pestë** përmban gjeneralitetet dhe nënshkrimet e specialistëve dhe përgjegjësit të sektorit të zbatimit të procedurave të VKM-së nr. 827/2020 dhe të drejtorit të drejtorisë vendore të ASHK-së, së bashku me vulën përkatëse.

4. Modeli i paraqitjes së planimetrisë së objektit është sipas aneksit 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Planimetria e çdo kati hartohet në shkallën 1:100, në format A4/A3 (në qendër vendoset emërtimi i katit). Ajo i bashkëlidhet në çdo rast vendimit për pranimin e kërkesës për kalimin e pronësisë së objektit pa titull pronësie dhe truallit funksional të tij që lëshon drejtoria vendore e ASHK-së. Ai hartohet e miratohet në format digjital, dhe një kopje e printuar ruhet në përputhje me legjislacionin për arkivat. Planimetria ka në përmbajtje të saj rubrikat me të dhënat si vijon:

a) **Rubrika e parë** përmban paraqitjen grafike të planimetrisë së katit përkatës me:

i. dimensionet totale dhe të pjesshme të objektit;

ii. dimensionet e brendshme;

b) **Në rubrikën e dytë** paraqitet:

i. numri i fletës;

ii. shkalla e planimetrisë.

c) **Në rubrikën e tretë** jepen:

i. të dhënat e objektit;

ii. emërtimi i fletës;

iii. emri, atësia dhe mbiemri i poseduesit të objektit;

iv. numri i dosjes së kërkesës;

v. data e hartimit të planimetrisë.

ç) **Rubrika e katërt** përmban:

i. Drejtorinë Vendore të ASHK-së, gjeneralitetet dhe nënshkrimi i drejtorit si dhe vula.

ii. Gjeneralitetet e specialistit që punon planimetrinë dhe përgjegjësit të sektorit të zbatimit të procedurave të VKM-së nr. 827/2020, me nënshkrimet përkatëse.

iii. Gjeneralitetet e specialistit i cili ka kryer azhurnimin në terren.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

5. Udhëzimi i drejtorit të përgjithshëm nr. 1791, datë 26.11.2018, “Për zbatimin e VKM-së nr. 442, datë 18.7.2018, “Për përcaktimin e procedurës së kalimit e të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri në 10.8.1991 dhe të truallit funksional të tyre”, shfuqizohet.

6. Ngarkohen drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Dallëndyshe Bici




GENPLAN

Aneks 1

DREJTORIA E ASHK : _____ QARKU: _____ BASHKIA: _____ ZONA KADASTRALE: 1234 ADRESA E PASURISË: _____ INDEKSI I HARTËS: A-11 SHKALLA: 1:500 DATA: _____	NUMRI UNIK (INDEKS): 06 _____ NR. I APLIKIMIT: 1 NR. PASURISË: 9/310 SIPËRFAQE E TRUALLIT FUNKSIONAL = 66.8 PR. SHTET = PO PR. E TË TRETËVE = JO PR. TË VET = JO SIPËRFAQE E BAZËS SË OBJEKTIT = 47.5 POSEDUESI: _____ emëratesiambiemër
--	---

x= 514947.25
y= 4433526.93**KRGJSH**x= 515037.25
y= 4433526.93




x= 514947.25
y= 4433461.09**Legjenda**x= 515037.25
y= 4433461.09

KUFITARËT: VERI Nr.Pas 9/55 JUG Nr.Pas 9/183 LINDJE Nr.Pas 9/209 PERENDIM Nr.Pas 9/56	HYRJA NE OBJEKT OBJEKTI KUFI I TRUALLIT FUNKSIONAL
SEKTORI I ZBATIMIT TE PROCEDURAVE TE VKM 827/2020:	
SPECIALIST _____	SPECIALIST _____
PËRGJEGJËS _____	
DREJTOR / PËRFAQËSUES I SUBJEKTIT: _____ emërmbiemërnënshkrimi	



PLANIMETRIA E KATIT PERDHE



Sip. ndertimi 115.6 m²

 ASHK AGJENCIA SHQIPTARE E KARTIMTRES	Objekti: GODINE BANIMI 1 KAT		DREJTORIA VENDORE GJIRKASTËR DREJTORI :	nënshkrimi: Vula:
	Emertimi i fletes: PLANIMETRIA E KATIT PERDHE		Përgjegjësi i sektorit: Ing.	nënshkrimi:
	Poseduesi:		punoi:	nënshkrimi:
	Nr. fletes: A - 1/1	Nr. dosjes vetdeklarimit :	Data:	
Shkalla: 1 : 100				

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 296 lekë

